



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 87

Tiranë – E premte, 24 prill 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 17.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rrugët paralele me hekurudhën nga kthesa e Kamzës deri tek stacioni hekurudhor në Kashar–loti I”..... 8059
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 17.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tunelit të Llogarasë”..... 8062
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 17.4.2026	Për deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, dhe miratimin e zonifikimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tij..... 8063
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 17.4.2026	Për deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të Parkut Arkeologjik Orikum, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tij dhe për një ndryshim në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave..... 8073
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 17.4.2026	Për miratimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve..... 8079
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 10.4.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011, “Për pajisjen e drejtuesve të mjeteve rrugore të kategorive C1, C, C1E, D1, D, D1E dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, i ndryshuar”..... 8110
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 17.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5056, datë 18.12.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 8112
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 86, datë 27.3.2026	Mbi një ndryshim në “Rregulloren e lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019”..... 8119

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 27.3.2026	Mbi miratimin e riemërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së propozuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a.....	8121
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 9.4.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	8123
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 9.4.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8124
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 9.4.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 mw.....	8125
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 9.4.2026	Mbi heqjen e licencës së shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.....	8126
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 9.4.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.....	8128
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 12, datë 22.4.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	8129
	Kërkesë për shpalljen e zhdukjes së shtetasit Ernest Matosha.....	8130

**VENDIM****Nr. 276, datë 17.4.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RRUGËT PARALELE ME
HEKURUDHËN NGA KTHESA E
KAMZËS DERI TEK STACIONI
HEKURUDHOR NË KASHAR–LOTI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rrugët paralele me hekurudhën nga kthesa e Kamzës deri tek stacioni hekurudhor në Kashar–loti I”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 634 311 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 634 311 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Rurale 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Rurale 2, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçiu**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“RRUGËT PARALELE ME HEKURUDHËN NGA K'THESA E KAMZËS DERI TEK STACIONI HEKURUDHOR NË KASHAR–LOTI 1”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)										Vlerësimet për shpronësim										Shënime (kuftizime hipotekore, barrë mbi pasurinë)
														“Trrall”			“Ndërtesë”			“Arë”			Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Trrall” (m²)	“Ndërtesë” (m²)	“Arë” (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Myftar	Rrahman	Beshiraj	Mëzeq	2679	23/1	Arë	5000.00			5000	3	131							423.2	448	189594	189,593.60	
2	Hil Hile	Vas Çun	Zefi Zefi	Mëzeq	2679	23/8	Arë	1000.00			1000.00	8	159							154.1	448	69036.8	69,036.80	
3	Nevruz	Edip	Rustani	Mëzeq	2679	24/12	Arë	400.00			400.00	9	4							48.3	448	21638.4	21,638.40	
4	Allaman	Edip	Rustani	Mëzeq	2679	24/13	Trrall	400.00	400.00	128.00		9	5	66.4	4242	281,668.80							281,668.80	
5	Iron	Ethem	Rustani	Mëzeq	2679	24/14	Arë	375.00			375.00	9	6							101.4	448	45427.2	45,427.20	
6	Sokol	Veseli	Osmani	Mëzeq	2679	24/15	Trrall	330.00	330.00	81.00		9	7	81.9	4242	347,419.80							347,419.80	
7	Petrit Petrit	Arif Fuat	Osmani Osmani	Mëzeq	2679	24/16	Arë	330.00			330.00	9	8							50.5	448	22624	22,624.00	
8	Deli	Shaban	Krasniqi	Mëzeq	2679	24/17	Arë	987.00			987.00	9	9							148.3	448	66438.4	66,438.40	
9	Dionis Dorian Ferit Genti Maliq Mynefe Natasha	Kujtim Neshe Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Demir	Jazaj Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha Bablusha	Mëzeq	2679	25/14	Arë	7400.00			7400.00	9	92							460	448	206080	206,080.00	
10	Gjyle Hysen	Shahin Vath	Labi Labi	Mëzeq	2679	36/23	Arë	126.00			126.00	10	141							42.1	448	18860.8	18,860.80	
11	Ornela Esteban Ahmet Rehana	Petrit Safet Benisha Benisha Benisha Benisha	Benisha Benisha Benisha Benisha Benisha Benisha	Mëzeq	2679	36/24	Arë	128.00			128.00	10	142							42.3	448	18950.4	18,950.40	
12	Isuf	Dine	Benisha	Mëzeq	2679	36/74	Arë	100.00			100.00	12	19							31.2	448	13977.6	13,977.60	D. Në favor të Fondit Besa sh.a. vl. 700.000 lekë k.hip. 3789/1669, datë 5.8.2019 kontratë/ deklarata notoriale për vendosje hipoteke vendoset sekuestro konservative me shkresën nr. 2596 prot., nr. 1122 dosje, datë 20.3.2023, përmbartues Jonida Ujkashi, mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë për të cilën nuk kemi dokumentacion apo informacion. Kontrata nr. 3789 rep., nr. 1669 kol., datë 5.8.2019. E. Kartela u përditësua me kërkesën nr. 9036, datë 5.11.2013. Kartela u përmirësua/përditësua me ref. 00017717.54
13	Xhaver Hekuran	Maliq	Muka Daci	Mëzeq	2679	36/75	Arë	200.00			200.00	12	20							63.8	448	28582.4	28,582.40	
14	Bujar	Ali	Dervishi	Mëzeq	2679	36/185	Arë	86.00			86.00	14	83							25.6	448	11468.8	11,468.80	
15	Fran Vjollca	Pal Nikoll	Muca Muca	Mëzeq	2679	36/98	Arë	660.00			660.00	14	82							218	448	97664	97,664.00	



16	Preng Martine	Gjok Gjin	Pjetri Pjetri	Mëzez	2679	36/148	Arë	200.00			200.00	31	102						52.9	448	23699.2	23,699.20	
17	Gjin	Gjok	Pjetri	Mëzez	2679	36/149	Arë	300.00			300.00	31	103						80.3	448	35974.4	35,974.40	
18	Gjin	Gjok	Pjetri	Mëzez	2679	36/150	Arë	300.00			300.00	31	104						76.8	448	34406.4	34,406.40	
19	Ferd	Marash	Prebibaj	Mëzez	2679	36/25	Arë	500.00			500.00	10	143						125	448	56000	56,000.00	
20	Farie	Rrahman	Halilaj	Mëzez	2679	36/18	Arë	400.00			400.00	9	183						100	448	44800	44,800.00	
Vlera totale												148.3							1666.5			1,634,311	

**VENDIM****Nr. 278, datë 17.4.2026****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
TUNELIT TË LLOGARASË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tunelit të Llogarasë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “kullotë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 791 165.6 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 791 165.6 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar e të dërguar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR “NDËRTIMI I TUNELIT TË LLOGARASË”

Nr	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)			Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë								Adresa e pronarëve	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “kullotë”			Vlera		
							total e	Sip.	Çmimi	Vlera	Sip.	Çmimi	Vlera	totale		
							(m²)	(m²)	(lek/m²)	(lek)	(m²)	(lek/m²)	(lek)	(lek)		
1	PRENJO		HALILI	1568	214	Arë	709	522	204	106,488.00				106,488.00	Dukat	
2	PRENJO		HALILI	1568	211	Arë	2052	522.4	204	106,569.60				106,569.60	Dukat	
3	PRENJO		HALILI	1568	215	Arë	720	571	204	116,484.00				116,484.00	Dukat	
4	PRENJO		HALILI	1568	217	Arë	1631	69.5	204	14,178.00				14,178.00	Dukat	
5	ISMAIL	HASAN	HALILI	1568	21/203/6	Kullotë	6320				869.5	241	209,549.50	209,549.50	Tiranë	
6	ALBAN	HASAN	HALILI	1568	21/203/7	Kullotë	6320				881.2	241	212,369.20	212,369.20	Tiranë	
7	ILIR	HARIZ	HALILI	1568	21/203/5	Kullotë	1546 4				4255. 3	241	1,025,527.30	1,025,527.30	Tiranë	
Vlera totale										343,719.60			1,447,446.00	1,791,165.60		

VENDIM Nr. 282, datë 17.4.2026

PËR DEKLARIMIN “PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME” TË PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS DHE KLOS, DHE MIRATIMIN E ZONIFIKIMIT E TË PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TIJ

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të shkronjave “a” e “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, dhe miratimin e zonifikimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tij.

2. Miratimin e zonifikimit, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën” dhe aktet nënligjore në fuqi.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në vendim dhe në rregullore, fjala “Bylis” hiqet;

b) Harta e Parkut Arkeologjik “Bylis”, bashkëlidhur vendimit, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Njësia e Administrimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, Bashkia Mallakastër dhe institucionet e organet e tjera të trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E PARKUT
ARKEOLOGJIK BYLIS DHE KLOS

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Objektivat kryesorë të këtij plani janë:

a) ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike e të peizazhit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos;



b) administrimi i Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Hapësira territoriale në mbrojtje përfshin:

a) qytetin antik të Bylisit, i cili, për nga vlerat kulturore dhe historike që mbart, përbën një nga qendrat më të mëdha ilire dhe një nga sitet arkeologjike më të rëndësishme në Shqipëri. Qyteti ndodhet në territorin e fshatit Hekal, Njësia Administrative Hekal, Bashkia Mallakastër;

b) qytetin antik të Nikajës (Klos), i cili, për nga rëndësia historike, konsiderohet qyteti i dytë më i rëndësishëm brenda Koinonit të Bylinëve. Qyteti ndodhet në territorin e fshatit Klos, Bashkia Mallakastër.

KREU II

RUAJTJA DHE MBROJTJA E PASURISË KULTURORE

SEKSIONI 1

NDËRHYRJET E LEJUARA NË PARKUN ARKEOLOGJIK BYLIS DHE KLOS

Në Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos lejohen vetëm këto veprimtari:

1. Mirëmbajtja, konservimi dhe restaurimi i strukturave arkeologjike në Park, të cilat kryhen sipas procedurës, si më poshtë vijon:

a) Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e strukturave arkeologjike në Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në bashkëpunim me NJAKPA-në, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar “për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale” dhe miratohen në KKTKM.

b) Zbatimi i punimeve të mirëmbajtjes e të konservimit kryhet nga NJAKPA-ja ose/dhe subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara ose subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese dhe i rrjeteve inxhinierike në Park kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja.

Projektet për rikonstruksionin e rrugëve ekzistuese dhe për të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik brenda Parkut hartohen nga persona fizikë ose juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke mos cenuar pasuritë kulturore të nëntokës.

Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen, në përputhje me ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Rikonstruksioni, rindërtimi ose ritrajtimi i godinave ekzistuese, si më poshtë vijon:

a) Projektet për rikonstruksionin, rindërtimin dhe ritrajtimin e godinave ekzistuese brenda Parkut hartohen dhe realizohen, duke respektuar kushtin e mosndryshimit të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës;

b) Mbikëqyrja e punimeve realizohet nga specialistët e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Vendosja e konstruksioneve të lehta dhe të përkohshme (me strukturë druri, xhami, plastike ose metali), për nevoja funksionale të parkut, si: informimi publik, shërbimet ndihmëse etj., si më poshtë vijon:

a) Projektet hartohen nga Parku Arkeologjik Bylis dhe Klos, IKTK-ja, DRTK-ja dhe/ose nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen nga KKTKM-ja, duke respektuar këto kushte:

i. lartësi maksimale 1 kat;

ii. të jenë të çmontueshme;

iii. nuk duhet të dëmtojnë nëntokën, peizazhin dhe duhet të respektojnë kërkesat e sigurisë dhe aksesueshmërisë;

b) Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

5. Kryerja e testimeve arkeologjike, që nuk cenon shtresat arkeologjike, të tilla si: sondazhe, hulumtime parandaluese ose të shpëtimit, sipas vendimeve të KKTKM-së, në funksion të



ndërhyrjeve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij seksioni:

a) Fillimi i punimeve bëhet pas lidhjes së aktmarrëveshjes ndërmjet IKTK-së, zhvilluesit dhe subjektit të licencuar për veprimtari arkeologjike;

b) Zbatimi i punimeve, monitorimi dhe mbikëqyrja arkeologjike kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike.

6. Zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja, pasi ato janë miratuar fillimisht nga organet teknike, këshillat shkencorë, bordet ose departamentet përgjegjëse të institucioneve të specializuara që kryejnë kërkime arkeologjike, si dhe dhënies së opinionit të NJAKPA-së, lidhur me periudhën e kryerjes së kësaj veprimtarie.

7. Projektet kërkimore-shkencore realizohen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike, të cilat janë përgjegjëse për:

a) marrjen e lejeve përkatëse në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;

b) kryerjen e hulumtimeve arkeologjike, në përputhje me vendimin e KKTKM-së, sipas llojit të lejes së dhënë;

c) zbatimin e të gjitha masave të sigurisë për ruajtjen e mbrojtjen e pasurisë kulturore, personave dhe mjedisit.

SEKSIONI 2

MONITORIMI I NJAKPA-së

1. NJAKPA-ja ndjek në mënyrë të vazhdueshme procesin e të gjitha ndërhyrjeve, nga faza e hartimit dhe e miratimit të projektit deri në zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve.

2. NJAKPA-ja ndjek procedurat për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve të nevojshme për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse, përfshirë ato që lidhen me ndikimin në mjedis dhe natyrë.

3. Për të gjitha ndërhyrjet në parkun arkeologjik gjatë fazës së zbatimit realizohet monitorim arkeologjik dhe mbikëqyrje arkeologjike nga Parku Arkeologjik Bylis dhe Klos dhe/ose institucionet shtetërore të specializuara.

4. Ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik Bylis dhe Klos kryhen, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”.

5. Aplikimi për lejet për ndërhyrjet kryhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

SEKSIONI 3

NDËRHYRJE TË TJERA NË PARKUN ARKEOLOGJIK

1. Ndërhyrje të paautorizuara në parkun arkeologjik konsiderohen të gjitha ndërhyrjet mbi pasuritë kulturore të paluajtshme ose të luajtshme, të kryera pa miratimin paraprak të KKTKM-së.

1.1 Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda parkut, NJAKPA-ja ka detyrimin:

a) të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit me aktin e konstatimit;

b) të njoftojë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Gjetjet rastësore brenda territorit të Parkut mund të evidentohen kryesisht gjatë zbatimit të punimeve të miratuara për rikonstruksion, rindërtim ose rëritim të godinave ekzistuese, në pronësi private ose jo, gjatë rikonstruksionit të rrugëve dhe rrjeteve inxhinierike, si edhe gjatë punimit të tokës apo veprimtarive të tjera të banorëve.

2.1 Klasifikohen si gjetje rastësore të luajtshme dhe të paluajtshme, në kontekstet e tyre arkeologjike, edhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të nenit 144, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2.2 Në rast zbulimi të gjetjeve rastësore gjatë zbatimit të punimeve të miratuara në Park, punimet



pezullohen menjëherë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2.3 Në rast zbulimi të gjetjeve rastësore gjatë punimit të tokës ose gjatë veprimtarive të tjera të banorëve, punimet pezullohen menjëherë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 146, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2.4 Në varësi të vlerave që mbartin gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja përcakton procedurat dhe hulumtimet e nevojshme arkeologjike për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

3. Vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese në territorin e parkut, pranë monumenteve të veçanta, në rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik kryhet pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

3.1 Tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumenteve, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.

3.2 Vendosja e tabelave prezantuese dhe të sinjalistikës rrugore/turistike në afërsi të Parkut Arkeologjik, që ofrojnë informacion mbi parkun dhe vlerat kulturore të tij, kryhet nën mbikëqyrjen e NJAKPA-së Bylis dhe Klos pas njoftimit zyrtar të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU IV RUAJTJA FIZIKE E PASURISË KULTURORE

1. NJAKPA-ja Bylis dhe Klos garanton sigurinë dhe ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, përfshirë mbrojtjen nga rreziku i zjarrit.

2. NJAKPA-ja Bylis dhe Klos monitoron dhe kontrollon vazhdimisht faktorët e riskut që mund të cenojnë sigurinë dhe integritetin fizik të pasurisë kulturore.

3. Për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit, NJAKPA-ja Bylis dhe Klos merr masa për:

a) pajisjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve e të sistemeve të zbulimit, sinjalizimit dhe shuarjes së zjarrit;

b) zbatimin e procedurave të emergjencës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në rast se zjarri nuk vihet nën kontroll nga NJAKPA-ja Bylis dhe Klos, pavarësisht masave të marra, ndërhyjnë autoriteti kompetent për mbrojtjen

nga zjarri dhe shpëtimin, i cili merr masat e nevojshme për shuarjen e tij.

5. Në kuadër të detyrimit për ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, NJAKPA-ja Bylis dhe Klos lidh protokolle bashkëpunimi me:

a) Policinë e Shtetit;

b) autoritetin kompetent për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, jo më vonë se data e transferimit të administrimit.

6. Për sigurimin fizik të pasurisë kulturore, NJAKPA-ja Bylis dhe Klos angazhon subjekte të licencuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e mbrojtjes së pasurive kulturore.

KREU V INVENTARI DHE KARTELAT E PASURISË KULTURORE

1. NJAKPA-ja Bylis dhe Klos mban dhe përditëson periodikisht inventarin dhe kartelën e pasurisë kulturore, në përputhje me formatin dhe të dhënat e miratuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

2. Çdo ndërhyrje e kryer në pasuritë kulturore, si dhe çdo rast qarkullimi i pasurive të luajtshme pasqyrohet në inventar dhe në kartelën përkatëse.

3. NJAKPA-ja, në mënyrë sistematike ose sipas nevojës, kryen verifikimin e gjendjes së konservimit të pasurive kulturore, duke kërkuar asistencë nga IKTK-ja, kur është e nevojshme.

4. NJAKPA-ja Bylis dhe Klos mban kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me IKRTK-në dhe IKTK-në për çështjet që lidhen me inventarin dhe kartelat e pasurive kulturore.

KREU VI RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. Deri në datën 15 janar të çdo viti, NJAKPA-ja Bylis dhe Klos dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse raportin vjetor mbi administrimin e pasurisë kulturore gjatë vitit kalendarik paraardhës. Raporti përmban:

a) gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore gjatë periudhës së monitorimit;

b) nivelin e realizimit të planeve vjetore të veprimtarive kulturore të miratuara;

c) të dhëna mbi numrin e vizitorëve;

ç) listën e shërbimeve të ofruara për publikun;

d) numrin e punonjësve sipas funksioneve dhe planin e tyre të trajnimit;

dh) listën e kontraktorëve të angazhuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore, të shoqëruar me kopjet përkatëse të kontratave;

e) raportimin mbi të ardhurat totale vjetore të gjeneruara nga NJAKPA-ja Bylis dhe Klos;

ë) shkallën e realizimit të objektivave të përcaktuar në planin e menaxhimit.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, mbi bazën e raportimit vjetor, vlerëson dhe monitoron administrimin e pasurisë kulturore nga NJAKPA-ja Bylis dhe Klos dhe, sipas rastit, ushtron kontroll në vend për verifikimin e gjendjes

së konservimit dhe përmbushjes së detyrimeve, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të NJAKPA-së Bylis dhe Klos.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Çështjet, që nuk parashikohen në këtë plan, sipas kompetencave, rregullohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet NJAKPA-së Bylis dhe Klos, dhe institucioneve të specializuara, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.





KOORDINATAT E ZONËS ARKEOLOGJIKE KLOS (KRGJSH 2010)		
ID	X	Y
1	479115	4488213
2	479136	4488232
3	479171	4488244
4	479200	4488262
5	479225	4488279
6	479262	4488297
7	479306	4488325
8	479350	4488357
9	479394	4488412
10	479435	4488464
11	479477	4488549
12	479529	4488606
13	479584	4488630
14	479685	4488645
15	479773	4488652
16	479815	4488605
17	479873	4488549
18	479964	4488484
19	480018	4488394
20	480058	4488325
21	480014	4488258
22	479950	4488210
23	479910	4488140
24	479913	4488111
25	479991	4488053
26	480063	4487995
27	480069	4487957
28	480020	4487906
29	479997	4487871
30	480027	4487787
31	480059	4487743
32	480115	4487720
33	480155	4487689
34	480125	4487593
35	480082	4487531
36	479975	4487544
37	479837	4487524
38	479683	4487586
39	479569	4487637
40	479477	4487610
41	479406	4487593



42	479321	4487578
43	479256	4487574
44	479172	4487570
45	479096	4487621
46	479068	4487698
47	479055	4487787
48	479027	4487879
49	479002	4487970
50	479016	4488038
51	479065	4488139
52	479091	4488184

**KOORDINATAT E ZONËS ARKEOLOGJIKE
BYLIS (KRGJSH 2010)**

ID	X	Y
1	477679	4490572
2	477680	4490589
3	477671	4490609
4	477664	4490633
5	477668	4490648
6	477678	4490663
7	477689	4490686
8	477699	4490704
9	477715	4490721
10	477738	4490746
11	477764	4490781
12	477780	4490815
13	477795	4490837
14	477817	4490851
15	477857	4490875
16	477885	4490905
17	477913	4490924
18	477926	4490926
19	477939	4490922
20	477950	4490915
21	477958	4490902
22	477963	4490887
23	477965	4490871
24	477973	4490850
25	477984	4490829
26	478003	4490806
27	478014	4490790
28	478023	4490768



29	478030	4490737
30	478042	4490677
31	478047	4490655
32	478042	4490630
33	478039	4490607
34	478045	4490587
35	478054	4490573
36	478072	4490560
37	478093	4490549
38	478105	4490535
39	478118	4490493
40	478141	4490443
41	478158	4490404
42	478164	4490382
43	478171	4490354
44	478183	4490329
45	478200	4490304
46	478216	4490285
47	478240	4490248
48	478248	4490224
49	478256	4490210
50	478274	4490194
51	478290	4490181
52	478297	4490173
53	478302	4490159
54	478302	4490137
55	478303	4490111
56	478306	4490094
57	478314	4490075
58	478323	4490057
59	478325	4490036
60	478324	4490013
61	478326	4490003
62	478332	4489994
63	478337	4489987
64	478342	4489980
65	478343	4489967
66	478343	4489950
67	478345	4489934
68	478342	4489919
69	478332	4489899
70	478330	4489889
71	478335	4489881



72	478342	4489876
73	478351	4489869
74	478357	4489859
75	478363	4489845
76	478368	4489824
77	478369	4489806
78	478366	4489777
79	478363	4489753
80	478364	4489726
81	478369	4489704
82	478377	4489684
83	478400	4489651
84	478420	4489617
85	478431	4489570
86	478447	4489510
87	478455	4489449
88	478454	4489412
89	478445	4489365
90	478439	4489296
91	478456	4489173
92	478459	4489075
93	478427	4488992
94	478393	4488974
95	478358	4488997
96	478328	4489006
97	478304	4488990
98	478285	4488988
99	478263	4488992
100	478209	4489026
101	478162	4489057
102	478121	4489102
103	478061	4489151
104	477988	4489171
105	477951	4489197
106	477922	4489223
107	477864	4489293
108	477834	4489302
109	477779	4489333
110	477743	4489348
111	477706	4489371
112	477679	4489360
113	477653	4489350
114	477605	4489355



115	477568	4489359
116	477509	4489380
117	477477	4489415
118	477475	4489465
119	477470	4489494
120	477472	4489526
121	477469	4489561
122	477454	4489578
123	477438	4489601
124	477417	4489623
125	477400	4489644
126	477392	4489666
127	477395	4489693
128	477402	4489720
129	477413	4489741
130	477418	4489757
131	477416	4489784
132	477412	4489802
133	477413	4489826
134	477420	4489862
135	477428	4489886
136	477448	4489927
137	477473	4489965
138	477506	4490000
139	477520	4490019
140	477553	4490048
141	477575	4490072
142	477584	4490093
143	477595	4490122
144	477603	4490149
145	477606	4490201
146	477614	4490245
147	477620	4490278
148	477622	4490302
149	477616	4490334
150	477610	4490361
151	477617	4490393
152	477621	4490418
153	477638	4490457
154	477654	4490488
155	477665	4490508
156	477673	4490536



VeNDIM
Nr. 285, datë 17.4.2026

**PËR DEKLARIMIN “PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME” TË
PARKUT ARKEOLOGJIK ORIKUM,
MIRATIMIN E ZONIFIKIMIT DHE TË
PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN E TIJ DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 396, DATË 31.3.2005, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, dhe të pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin “Pasuri kulturore e paluajtshme” të Parkut Arkeologjik Orikum, sipas hartës së zonifikimit dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e Parkut Arkeologjik Orikum, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e Parkut Arkeologjik Orikum në Gjeoportalin Kombëtar.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Kudo në vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufijve dhe të rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikut, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit”, të ndryshuar, dhe në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi, fjala “Orikum/Orikumit” dhe harta që i përket Parkut Arkeologjik Orikum, hiqen.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, institucionet dhe organet e tjera të trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN
E PARKUT ARKEOLOGJIK ORIKUM**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin Parkut Arkeologjik Orikum, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Objektivat kryesorë të këtij plani janë:

a) ruajtja, mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe peizazhit të Parkut Arkeologjik Orikum;

b) administrimi i Parkut Arkeologjik Orikum;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Parkut Arkeologjik Orikum me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Hapësira territoriale në mbrojtje përfshin:

a) zonën A – qytetin antik të Orikut, i cili, për nga vlerat kulturore dhe historike që mbart, përbën një nga qendrat më të mëdha ilire të antikitetit dhe një nga sitet arkeologjike më të rëndësishme në Shqipëri. Qyteti ndodhet në territorin e Orikut, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë;

b) zonën B – hapësirën me potencial arkeologjik rreth qytetit të Orikut antik, e cila në brendësi të saj ka Nekropolin Antik, hapësirën me gjetje arkeologjike nënujore në zonën e lagunës, si dhe Kishën e Marmiroit. Kjo zonë ndodhet në territorin e Orikut, Bashkia Vlorë.



KREU II RUAJTJA DHE MBROJTJA E PASURISË KULTURORE

SEKSIONI 1 NDËRHYRJET E LEJUARA NË PARKUN ARKEOLOGJIK ORIKUMIT, ZONA A - QYTETI ANTIK I ORIKUMIT

Në zonën A - qyteti antik i Orikumit, pjesë e Parkut Arkeologjik Orikum, lejohen, vetëm këto veprimtari, si më poshtë vijon:

1. Mirëmbajtja, konservimi dhe restaurimi i strukturave arkeologjike në park kryhet sipas procedurave të mëposhtme:

a) Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e strukturave arkeologjike në Parkun Arkeologjik Orikum hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”), në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “DRTK”) Vlorë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar “Për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale” dhe miratohen në Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim “KKTKM”);

b) Zbatimi i punimeve të mirëmbajtjes dhe i konservimit kryhen nga DRTK-ja Vlorë, ose/dhe subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara ose subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese dhe i rrjeteve inxhinierike në park kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja dhe më pas procedura e miratimit ndjek dispozitat e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet për rikonstrukcionin e rrugëve ekzistuese dhe për të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik brenda parkut hartohen nga persona fizikë ose juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke mos cenuar pasuritë kulturore të nëntokës. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen në përputhje me ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Rikonstruksioni, rindërtimi ose ritrajtimi i godinave ekzistuese, kryhen mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja, sipas këtyre rregullave:

a) Projektet për rikonstrukcionin, rindërtimin dhe ritrajtimin e godinave ekzistuese, brenda parkut, hartohen dhe realizohen pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës;

b) Mbikëqyrja e punimeve realizohet nga specialistët e Parkut Arkeologjik Orikum, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Vendosja e konstruksioneve të lehta dhe të përkohshme (me strukturë druri, xhami, plastike ose metali), për nevoja funksionale të parkut, si: informimi publik, shërbimet ndihmëse etj., kryhen sipas këtyre rregullave:

a) Projektet hartohen nga DRTK-ja Vlorë, IKTK-ja dhe/ose nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen nga KKTKM-ja. Vendosja e konstruksioneve duhet të plotësojë këto kritere:

i. lartësi maksimale: 1 kat;

ii. të jenë të çmontueshme;

iii. nuk duhet të dëmtojnë nëntokën, peizazhin dhe duhet të respektojnë kërkesat e sigurisë e të aksesueshmërisë.

b) Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

5. Kryerja e testimeve arkeologjike, që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, të tilla, si sondazhe, hulumtime parandaluese ose të shpëtimit, sipas vendimeve të KKTKM-së, në funksion të ndërhyrjeve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij seksioni, sipas këtyre rregullave:

a) Fillimi i punimeve bëhet pas lidhjes së aktmarrëveshjes ndërmjet IKTK-së, zhvilluesit dhe subjektit të licencuar për veprimtari arkeologjike;

b) Zbatimi i punimeve, monitorimi dhe mbikëqyrja arkeologjike kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike.



6. Zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore kryhet mbi bazën e projekteve të shqyrtuara dhe të miratuara nga KKTKM-ja, pasi ato janë miratuar fillimisht nga organet teknike, këshillat shkencorë, bordet ose departamentet përgjegjëse të institucioneve të specializuara, që kryejnë kërkime arkeologjike, si dhe me dhënien e opinionit të DRTK-së Vlorë, lidhur me periudhën e kryerjes së kësaj veprimtarie.

Projektet kërkimore-shkencore realizohen nga institucionet shtetërore të specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për veprimtari arkeologjike, të cilat janë përgjegjëse, për:

a) marrjen e lejeve përkatëse, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;

b) kryerjen e hulumtimeve arkeologjike, në përputhje me vendimin e KKTKM-së, sipas llojit të lejes së dhënë;

c) zbatimin e të gjitha masave të sigurisë për ruajtjen e mbrojtjen e pasurisë kulturore, personave dhe mjedisit.

7. DRTK-ja Vlorë ndjek në mënyrë të vazhdueshme procesin e të gjitha ndërhyrjeve, nga faza e hartimit, miratimit të projektit, deri në zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve.

8. DRTK-ja Vlorë ndjek procedurat për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve të nevojshme për ndërhyrjet ruajtëse e mbrojtëse, përfshirë ato që lidhen me ndikimin në mjedis dhe natyrë.

9. Për të gjitha ndërhyrjet në parkun arkeologjik, gjatë fazës së zbatimit, realizohet monitorim arkeologjik dhe mbikëqyrje arkeologjike nga DRTK-ja Vlorë dhe/ose institucionet shtetërore të specializuara.

10. Ndërhyrjet në Parkun Arkeologjik Orikum kryhen në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 220, datë 7.4.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes,

dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”, dhe legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

11. Aplikimi për lejet për ndërhyrjet kryhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

SEKSIONI 2

NDËRHYRJET E LEJUARA NË PARKUN ARKEOLOGJIK ORIKUMIT, ZONA B – HAPËSIRA ME POTENCIAL ARKEOLOGJIK RRETH QYTETIT TË ORIKUMIT

1. Në zonën B – hapësira me potencial arkeologjik rreth qytetit të Orikumit, pjesë e Parkut Arkeologjik Orikum, krahas ndërhyrjeve të lejuara në zonën A, lejohen edhe ndërtimet e reja, në përputhje me PPV-në (planet e përgjithshme vendore) në fuqi, si dhe legjislacionin sektorial të zbatueshëm për zonën, pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Për çdo projekt të ri, të propozuar në zonën B, hartohet paraprakisht një raport vlerësimi arkeologjik, i hartuar nga institucione të specializuara dhe/ose nga subjekte të licencuara, i cili është pjesë e dokumentacionit për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së.

4. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes së formave të testimit, të përcaktuara nga KKTKM -ja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona.

5. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është IKTK-ja.

6. Ndërhyrjet e lejuara në zonën B – hapësira me potencial arkeologjik rreth qytetit të Orikumit, pjesë e Parkut Arkeologjik Orikum, që prekin elemente të mjedisit, peizazhit, trashëgimisë natyrore, si dhe çdo element tjetër, në funksion të zonës së mbrojtur, krahas procedurës së përcaktuar në këtë seksion, marrin edhe mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.



SEKSIONI 3 NDËRHYRJE TË TJERA NË PARKUN ARKEOLOGJIK

1. Ndërhyrje të paautorizuara në parkun arkeologjik konsiderohen të gjitha ndërhyrjet mbi pasuritë kulturore të paluajtshme ose të luajtshme, të kryera pa miratimin paraprak të KKTKM-së. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda parkut, DRTK-ja Vlorë, ka detyrimin:

a) të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit me aktin e konstatimit;

b) të njoftojë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Gjetjet rastësore brenda territorit të parkut mund të evidentohen kryesisht gjatë zbatimit të punimeve të miratuara për rikonstruksion, rindërtim ose ritrajtim të godinave ekzistuese, në pronësi private ose jo, gjatë rikonstruksionit të rrugëve dhe rrjeteve inxhinierike, si edhe gjatë punimit të tokës apo veprimtarive të tjera të banorëve. Klasifikohen si gjetje rastësore të luajtshme dhe të paluajtshme, në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të nenit 144, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar. Në rast zbulimi të gjetjeve rastësore, ndiqen rregullat e mëposhtme:

a) Në rast zbulimi të gjetjeve rastësore, gjatë zbatimit të punimeve të miratuara në park, punimet pezullohen menjëherë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;

b) Në rast zbulimi të gjetjeve rastësore, gjatë punimit të tokës ose gjatë veprimtarive të tjera të banorëve, punimet pezullohen menjëherë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 146, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

Në varësi të vlerave që mbartin gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja përcakton procedurat dhe hulumtimet e nevojshme arkeologjike për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

3. Vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese në territorin e parkut pranë monumenteve të veçanta, në rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik kryhet pas shqyrtimit e

miratimit nga KKTKM-ja. Tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike. Vendosja e tabelave prezantuese dhe e sinjalistikës rrugore/turistike, në afërsi të Parkut Arkeologjik, që ofrojnë informacion për parkun dhe vlerat kulturore të tij, kryhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së Vlorë, pas njoftimit zyrtar të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU III RUAJTJA FIZIKE E PASURISË KULTURORE

1. DRTK-ja Vlorë garanton sigurinë dhe ruajtjen fizike të pasurisë kulturore, përfshirë mbrojtjen nga rreziku i zjarrit.

2. DRTK-ja Vlorë monitoron dhe kontrollon vazhdimisht faktorët e riskut, që mund të cenojnë sigurinë dhe integritetin fizik të pasurisë kulturore.

3. Për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit, DRTK-ja Vlorë merr masa, për:

a) pajisjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe të sistemeve të zbulimit, sinjalizimit dhe shuarjes së zjarrit;

b) zbatimin e procedurave të emergjencës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Në rast se zjarri nuk vihet nën kontroll nga DRTK-ja Vlorë, pavarësisht masave të marra, ndërhyjnë autoriteti kompetent për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, i cili merr masat e nevojshme për shuarjen e tij.

5. Për sigurimin fizik të pasurisë kulturore, DRTK-ja Vlorë angazhon subjekte të licencuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e mbrojtjes së pasurive kulturore.

KREU IV INVENTARI DHE KARTELAT E PASURISË KULTURORE

1. DRTK-ja Vlorë mban dhe përditëson periodikisht inventarin dhe kartelën e pasurisë kulturore, në përputhje me formatin dhe të dhënat e miratuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKRTK”).

2. Çdo ndërhyrje e kryer në pasuritë kulturore, pas miratimit nga KKTKM-ja ose ministri, sipas

rastit të ndërhyrjes, si dhe çdo rast qarkullimi i pasurive të luajtshme pasqyrohet në inventar dhe në kartelën përkatëse.

3. DRTK-ja Vlorë, në mënyrë sistematike ose sipas nevojës, kryen verifikimin e gjendjes së konservimit të pasurive kulturore, duke kërkuar asistencë nga IKTK-ja, kur është e nevojshme.

4. DRTK-ja Vlorë mban kontakt dhe bashkëpunon vazhdimisht me IKRTK-në dhe IKTK-në për çështjet që lidhen me inventarin dhe kartelat e pasurive kulturore.

KREU V RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. Deri në datën 15 janar të çdo viti, DRTK-ja Vlorë dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore raportin vjetor për administrimin e pasurisë kulturore gjatë vitit kalendarik paraardhës. Raporti përmban:

- a) gjendjen e konservimit të pasurisë kulturore gjatë periudhës së monitorimit;
- b) nivelin e realizimit të planeve vjetore të veprimtarive kulturore të miratuara;
- c) të dhëna për numrin e vizitorëve;
- ç) listën e shërbimeve të ofruara për publikun;

d) numrin e punonjësve, sipas funksioneve dhe planin e tyre të trajnimit;

dh) listën e kontraktorëve të angazhuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore, të shoqëruar me kopjet përkatëse të kontratave;

e) raportimin mbi të ardhurat totale vjetore, të gjeneruara nga DRTK-ja Vlorë;

ë) shkallën e realizimit të objektivave, të përcaktuar në planin e menaxhimit.

2. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, mbi bazën e raportimit vjetor, vlerëson dhe monitoron administrimin e pasurisë kulturore nga DRTK-ja Vlorë dhe, sipas rastit, ushtron kontroll në vend për verifikimin e gjendjes së konservimit dhe përmbushjes së detyrimeve, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të DRTK-së Vlorë.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Çështjet që nuk parashikohen në këtë plan, sipas kompetencave, rregullohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet DRTK-së Vlorë dhe institucioneve të specializuara, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.





Zona A – Qyteti Antik i Orikut

x	y
451692.2678	4465336.567
451708.9677	4465070.76
451682.5262	4465017.181
451672.0887	4464981.694
451613.2911	4464905.849
451541.6206	4464883.582
451448.3794	4464884.974
451325.2175	4464929.159
451251.4595	4465032.838
451213.8846	4465114.25
451197.8806	4465306.299
451476.9084	4465309.778
451692.2678	4465336.567

Koordinata – Zona B – Zona me potencial
Arkeologjik Orikum

x	y
453378.9599	4465780.855
454317.1127	4465124.165
453525.606	4463897.243
453232.4876	4463707.629
452989.6429	4463666.749
452927.3661	4463576.987
452826.4708	4463492.444
452730.0983	4463504.273
452651.4695	4463616.302
452343.5647	4463665.01
452159.8656	4463673.708
452031.137	4463729.374
451906.2355	4463833.401
451719.0573	4464050.5
451619.2057	4464183.055
451392.713	4464206.365
451217.0159	4464282.559
451099.4206	4464379.975
451052.1042	4464478.783
451034.0126	4464612.382
450952.2525	4464786.34
450797.7783	4464848.964
450766.4659	4464964.472
450770.6409	4465117.903
450809.6074	4465168.698
450945.9901	4465240.369
451020.4439	4465275.16
451054.5396	4465303.689
451476.2126	4465312.039
452579.799	4465498.87
453108.6299	4465672.827
453378.9599	4465780.855

**VENDIM****Nr. 286, datë 17.4.2026****PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E
KRIJIMIT TË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 66, të ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencia e Prokurimit Publik dhe struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, nën mbikëqyrjen e Inspektoratit të Përgjithshëm, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Albana Koçi****PROGRAMI KOMBËTAR PËR
PARANDALIMIN E KRIJIMIT TË
MBETJEVE****Përmbajtja**

1. Hyrje
2. Konteksti kombëtar
 - 2.1 Kuadri i politikave kombëtare
 - 2.2 Krijimi i mbetjeve
3. Objektivat e PKPM-së
4. Fushat e ndërhyrjes
 - 4.1 Ndërhyrjet në kuadrin rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve

4.1.1 Përcaktimi i objektivave dhe i treguesve të parandalimit të krijimit të mbetjeve

4.1.2 Përdorimi i masave të planifikimit

4.1.3 Përdorimi i instrumenteve ekonomike

4.1.4 Ndalimet dhe heqjet graduale

4.1.5 Përdorimi i prokurimit publik të gjelbër

4.2 Përmirësimi i projektimit dhe i prodhimit për parandalimin e krijimit të mbetjeve

4.2.1 Ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve

4.2.2 Përcaktimi i kërkesave të projektimit ekologjik

4.2.3 Vendosja e kërkesave për informacion

4.2.4 Krijimi i mjedisit të favorshëm për bizneset të përkrahin ekonominë qarkulluese

4.3 Promovimi i konsumit të qëndrueshëm dhe zgjatja e jetëgjatësisë së produktit

4.3.1 Modelet e konsumit të qëndrueshëm dhe sjellja e përgjegjshme e konsumatorit

4.3.2 Krijimi i kushteve për ripërdorim dhe për riparim

4.4 Minimizimi i mbetjeve nga sektori i ndërtimit, i prodhimit dhe nga proceset industriale

4.4.1 Përdorimi i teknikave më të mira të disponueshme

4.4.2 Përvetësimi i teknologjive me efikasitet të lartë të burimeve

4.4.3 Reduktimi i krijimit të mbetjeve dhe i ndikimit mjedisor nga sektori i ndërtimit

4.5 Parandalimi i shpërdorimit të ushqimit, promovimi i rishpërndarjes së ushqimit dhe arritja e reduktimit të përgjithshëm të mbetjeve bio

4.5.1 Reduktimi i mbetjeve ushqimore në prodhimin primar, përpunimin, shitjen me pakicë, shërbimet ushqimore dhe familjet.

4.5.2 Dhurimi i ushqimeve

4.5.3 Kompostimi në banesë

5. Prioritetet e PKPM-së

5.1 Prioriteti 1: Hartimi i kuadrit rregullator të politikave mbështetëse për parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe mbikëqyrjes së autoriteteve

5.2 Prioriteti 2: Mundësimi i praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit

5.3 Adresimi i rrymave specifike prioritare të mbetjeve

5.3.1 Mbetjet organike

5.3.2 Mbetjet plastike

5.3.3 Mbetjet e ambalazhit

5.3.4 Mbetjet nga ndërtimi dhe shembja

5.4 Masat horizontale

6. Treguesit e arritjeve



7. Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i programit

7.1 Objektivat dhe qëllimi i monitorimit

7.2 Metodologjia e monitorimit

7.3 Monitorimi i progresit dhe përshtatja e menaxhimit

7.4 Baza e përshtatjes së programit

7.5 Mbikëqyrja dhe procedurat inspektuese për zbatimin e Programit

Shtojca. Lista e masave dhe ndikimi i tyre në parandalimin e krijimit të mbetjeve

Plani i veprimit

Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1. Parandalimi i krijimit të mbetjeve në kontekstin e politikave kombëtare

Figura 1. Shkalla e rritjes së mbetjeve, PBB-së dhe popullsisë

Tabela 2. Prioritetet dhe fushat e ndërhyrjes

Tabela 3. Treguesit e gjenerimit të mbetjeve

Tabela 4. Lista e veprimeve dhe ndikimi i tyre në parandalimin e krijimit të mbetjeve

Plani i veprimit

Shkurtime

AKEM	Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
DKM	Direktiva Kuadër e BE-së për Mbetjet (2008/98/KE)
PKMM	Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve
HoReCa	Hotele, restorante dhe kafene/katering
LMIM	Ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve
MB	Mbetjet bashkiake
MBZhR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MM	Ministria e Mjedisit
MNS	Mbetjet nga ndërtimi dhe shembja
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
OJQ	Organizatë joqeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PAYT	Paguaj sipas hedhjes
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PKPM	Programi Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve
PPG	Prokurimi publik i gjelbër
PPS	Produkt problematik, i panevojshëm ose i shmangshëm
PVMM	Planet vendore të menaxhimit të mbetjeve
PZMM	Planet zonale të menaxhimit të mbetjeve
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese
SPIM	Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit
SUP	Plastikë/a njëpërdorimshme
TMD	Teknikat më të mira të disponueshme
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar



1. Hyrje

Parandalimi i krijimit të mbetjeve është një komponent themelor i politikës së BE-së për menaxhimin e mbetjeve, i cili reflekton rëndësinë e promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit. Ai qëndron në krye të hierarkisë së mbetjeve si opsioni më i preferuar për menaxhimin e mbetjeve, i ndjekur nga përgatitja për ripërdorim, riciklimi, format e tjera të rikuperimit të mbetjeve dhe, në fund, asgjësimi. Direktiva Kuadër e BE-së për Mbetjet (2008/98/KE) i kushton rëndësi të veçantë parandalimit të krijimit të mbetjeve, duke iu kërkuar shteteve anëtare miratimin e masave për parandalimin e mbetjeve dhe nxitjen e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është një sfidë kritike mjedisore dhe e shërbimit publik, ku sistemi aktual vazhdon të bazohet në modelin linear të menaxhimit. Përgjithësisht mbetjet depozitohen në landfille ose në venddepozitime dhe vetëm një pjesë drejtohen për riciklim dhe rikuperim. Në vitin¹ 2022, rreth 77% e mbetjeve bashkiake (rreth 630,000 tonë), iu nënshtruan asgjësimit, duke e bërë këtë të fundit metodën dominuese të menaxhimit të mbetjeve. Krahasimisht, vetëm 19% e mbetjeve (rreth 155,000 tonë), iu nënshtruan procesit të riciklimit ndërsa shumica e venddepozitimeve kërkon përmirësim të kontrollit mjedisor.

Forcimi i masave për parandalimin e mbetjeve është kusht thelbësor për integrimin e Shqipërisë në BE, veçanërisht në kuadër të kapitullit 27 për mjedisin, i cili kërkon përputhshmëri me direktivat e BE-së për mbetjet. Për më tepër, Plani i Veprimit të BE-së për Ekonominë Qarkulluese nxit vendet e BE-së që të përshpejtojnë ruajtjen e konsumit të burimeve brenda kufijve optimalë, të reduktojnë gjurmën e tij dhe të dyfishojnë shkallën e përdorimit të materialeve të qarkullueshme për dekadën e ardhshme. Gjithashtu, Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, nënshkruese e së cilës është edhe Shqipëria, nënvizon nevojën për prodhim dhe konsum më të qëndrueshëm, bazuar në nxitjen e parandalimit dhe riciklimit të mbetjeve, si dhe ripërdorimit të produkteve.

Parandalimi i krijimit të mbetjeve në Shqipëri është në një fazë të hershme. Politikat kombëtare, si ligji nr. 57/2025, “Për Menaxhimin e Integruar të

Mbetjeve”, Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020–2035, promovojnë përparësitë e parandalimit dhe përgatitjes për ripërdorim. Megjithatë, ka ende shumë për të bërë për përmirësimin e zbatimit të masave specifike, alokimit të fondeve të dedikuara, si dhe vendosjes së afateve të qarta kohore për zbatim. Ndërgjegjësimi për parandalimin e mbetjeve dhe përfitimet e tij, si dhe kultura e ripërdorimit dhe riparimit, duhet të bëhen pjesë e përditshme e bizneseve dhe e konsumatorëve.

Me reduktimin e sasisë së mbetjeve, strategjitë për parandalimin e tyre rrisin ndjeshëm përpjekjet për menaxhim dhe reduktojnë rreziqet për shëndetin e publikut dhe mjedisin. Gjithashtu, masat mbi parandalimin e krijimit të mbetjeve kontribuojnë në zhvillimin e një ekonomie më të qëndrueshme, më efikase në përdorimin e burimeve, si dhe më qarkulluese. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, sidomos në zonat bregdetare dhe natyrore ku trajtimi joefikas i mbetjeve ndikon drejtpërdrejt në atraktivitetin dhe cilësinë e mjedisit. Kalimi në një shoqëri të orientuar drejt parandalimit, shoqëruar me grumbullim të diferencuar të mbetjeve, rikuperim dhe përmirësim të asgjësimit përbën një hap të domosdoshëm drejt një ekonomie më të gjelbër dhe një Shqipërie më të pastër.

Në kuadër të këtij programi, parandalimi në kuptimin e ngushtë të tij, si dhe referuar përkufizimit në Direktivën Kuadër të Mbetjeve dhe në ligjin nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka kuptimin: “masat që merren përpara se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre; ndikimi negativ i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut; përmbajtja e substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte”. Si i tillë, Programi Kombëtar i Parandalimit të Krijimit të Mbetjeve fokusohet në masat për parandalimin e mbetjeve dhe përfshin një kuadër politikash që synojnë burimin e lëndëve të para, projektimin, prodhimin dhe fazën e përdorimit, duke synuar mbajtjen sa më gjatë të produkteve në qarkullim.

¹ Raporti i Mbetjeve të Ngurta Urbane 2022, INSTAT.



2. Konteksti kombëtar

2.1 Kuadri i politikave kombëtare

Shqipëria ndodhet në një moment kyç të zhvillimit të politikave për menaxhimin e mbetjeve, ku parandalimi është një objektiv strategjik kombëtar. Ligji i ri nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 6 të tij, përcakton qartë hierarkinë e mbetjeve edhe sipas Direktivës Kuadër të Mbetjeve, duke vendosur në krye parandalimin dhe përgatitjen për ripërdorim, të ndjekura nga rikuperimi dhe asgjësimi. Neni 66 i këtij ligji ngarkon Ministrinë e Mjedisit me detyrimin për zhvillimin e Programit Kombëtar të

Parandalimit të Krijimit të Mbetjeve, në përputhje me objektivat kombëtare dhe me *acquis* të BE-së. Strategjitë më të fundit kombëtare, përfshirë Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020–2035, nënvizojnë, gjithashtu, rëndësinë e parandalimit të krijimit të mbetjeve, si dhe ripërdorimit të produkteve, duke i cilësuar si objektiva strategjike.

Tabela 1 paraqet një pasqyrë të plotë që adreson parandalimin e mbetjeve në kuadrin e politikave kombëtare të Shqipërisë.

Tabela 1. Parandalimi i krijimit të mbetjeve në kontekstin e politikave kombëtare

Dokument/iniciativë politike	Fokus në parandalimin e mbetjeve
Ligji nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”	-Neni 6, përcakton Hierarkinë e Mbetjeve referuar edhe Direktivës Kuadër të Mbetjeve, duke vendosur në shkallët e para të saj, parandalimin e mbetjeve dhe përgatitjen për ripërdorim, më pas riciklimi, format e tjera të rikuperimit të mbetjeve dhe në fund asgjësimi. Neni 66, ngarkon Ministrinë e Mjedisit për hartimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, i cili duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.
Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020–2035	Qëllimi i Dokumentit të Politikave Strategjike, përcakton: - Hartimin e programit kombëtar për parandalimin e krijimit të mbetjeve si një nga objektivet kryesorë të tij; - Hierarkinë e mbetjeve si parimin kryesor duke i dhënë përparësi parandalimit; - Nevojën e kalimit gradual nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkulluese, duke përfshirë “mbylljen e ciklit”, të produkteve dhe zgjatjen e jetës së tyre përmes reduktimit, ripërdorimit, riciklimit; - Vendosjen e standardeve minimale për prokurimin publik të gjelbër; - Inkurajimin e kompostimit në banesë, në zonat rurale.
Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2020–2030)	- Promovon nismat e ripërdorimit të produkteve dhe reduktimit të mbetjeve; - Promovon reduktimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfill, nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit; - Promovon zhvillimin e sistemeve të ndarjes së mbetjeve në burim, veçanërisht të mbetjeve organike dhe atyre të riciklueshme.
“Kontributi Kombëtar i Përcaktuar”, i rishikuar (2021)	- Synon reduktimin e sasisë së mbetjeve të biodegradueshme që shkojnë në landfill (me objektiv kryesor, maksimumi 35% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 2010).
Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian (2022–2030)	- Nxit reduktimin e mbetjeve në burim, në përputhje me standardet e BE-së; - Nxit kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, duke përfshirë parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve si dhe ripërdorimin e produkteve; - Synon përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës më të mirë të grumbullimit, transportit, rikuperimit dhe asgjësimit; - Synon reduktimin e sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfill, duke përmirësuar kapacitetin e riciklimit dhe kompostimit.
Udhërrëfyesi Drejt Ekonomisë Qarkulluese të Shqipërisë	- Prezanton skemat “Paguaj sipas hedhjes”; - Promovon zbatimin e skemave të PZP-së për ambalazhet dhe rrymat e tjera specifike të mbetjeve; - Mbështet ndalimin e disa produkteve plastike njëpërdorimshme, me qëllim reduktimin e përdorimit të tyre.
Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor	- Mbështet përgatitjen dhe zbatimin e programit për parandalimin e mbetjeve, strategjisë për menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve, si dhe programit për reduktimin, ripërdorim dhe riciklim; - Promovon zhvillimin e marrëveshjes rajonale mbi parandalimin e ndotjes nga plastika duke përfshirë adresimin specifik të çështjes prioritarë të mbetjeve detare; - Promovon metodat e qëndrueshme të prodhimit dhe furnizimit me ushqim; - Inkurajon iniciativa drejtuar konsumatorëve për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi mbetjet, grumbullimin e diferencuar dhe konsumin e qëndrueshëm.



Angazhimi i Shqipërisë në agjendat ndërkombëtare dhe rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm ka forcuar më tej angazhimin e saj për parandalimin e mbetjeve. Në kuadër të angazhimeve të saj për integrimin në BE-dhe si nënshkruese e Deklaratës së Sofjes mbi Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (2020), Shqipëria vijon procesin e përafrimit të kuadrit ligjor dhe politikave të saj për menaxhimin e mbetjeve me Direktivën Kuadër për Mbetjet, Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese dhe Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane. Këto dokumente strategjike identifikojnë parandalimin e mbetjeve si objektiv qendror dhe nënvizojnë rëndësinë e promovimit të modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, zbatimit të parimeve të projektimit ekologjik, si dhe reduktim të produkteve njëpërdorimshme, veçanërisht të atyre plastike.

Plani i Veprimit për zbatimin e Agjendës së Gjellbër (2021–2030) përkthen këto angazhime rajonale në masa konkrete dhe të zbatueshme, shumë prej të cilave janë tashmë të integruara në kuadrin e saj të politikave mjedisore të Shqipërisë. Për më tepër, udhërrëfyesi i OECD-së drejt Ekonomisë Qarkulluese në Shqipëri, ofron një analizë gjithëpërfshirëse të situatës aktuale të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri dhe përcakton hapat për zbatimin e Agjendës së Gjellbër. Strategjitë për parandalimin e mbetjeve, përfshirë reduktimin dhe ripërdorimin, që përbëjnë një dimension qendror në arritjen e objektivave të qarkullueshmërisë. Përdorimi i instrumenteve ekonomike për inkurajimin e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm, si dhe krijimi i kushteve të favorshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të kaluar drejt modeleve të biznesit qarkullues, janë të lidhur ngushtësisht me parandalimin e mbetjeve.

Përmeshja e standardeve dhe objektivave të përcaktuar nga agjendat ndërkombëtare, kërkon përfshirjen e gjerë të parandalimit të krijimit të mbetjeve në dokumentet kryesore strategjike të zhvillimit mjedisor dhe ekonomik të Shqipërisë. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022–2030, nënvizon qartë angazhimin e Shqipërisë në modelin e ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së qëndrueshme. Strategjia mbështet modelin e ekonomisë qarkulluese përmes reduktimit të mbetjeve dhe inovacionit për transformimin e hallkave të qëndrueshme në zinxhirin e konsumit dhe prodhimit, rrjedhimisht edhe parandalimin strategjik ashtu si efikasitetin e përdorimit të burimeve. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike (2019–2030), ndërlidhin parandalimin e mbetjeve me masat klimatike dhe mundësinë e reduktimit të emetimeve të metanit nëpërmjet parandalimit të depozitimit të mbetjeve të biodegradueshme në landfill.

Me gjithë progresin e deritanishëm, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja publike në parandalimin, ndarja dhe riciklimi i mbetjeve mbeten sfida të rëndësishme. Përpjekjet e shoqërisë civile dhe nismave të financuara nga donatorët kanë sjellë përmirësime të dukshme, por ende mbeten hapësira për rritjen e nivelit të përgjithshëm të edukimit mjedisor dhe përfshirjen e qytetarëve në praktika të qëndrueshme. Ligji nr. 74/2025, “Për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit” (PZP), pritet të krijojë mekanizmat e nevojshëm për funksionimin e skemave përkatëse dhe të zgjerojë rolin e sektorit privat në mbështetje të praktikave të ekonomisë qarkulluese. Situata aktuale kërkon fuqizimin dhe përmirësimin e masave të parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe zbatimin e një qasjeje të unifikuar dhe të koordinuar me qëllim që politikat ekzistuese të sjellin rezultate të qëndrueshme.

Kuadri i politikave mjedisore të Shqipërisë njeh parandalimin e mbetjeve si një objektiv strategjik dhe një element themelor i ekonomisë qarkulluese. Përmes parandalimit është e mundur të përmirësohet ndjeshëm menaxhimi i mbetjeve, të reduktohet varësia nga lëndët e para dhe të mbështetet zhvillimi ekonomik. Në këtë kuadër, Programi i Parandalimit të krijimit të Mbetjeve, synon fuqizimin e iniciativave kombëtare, harmonizimin me politikatat e përshkruara më sipër, si dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe praktikave të Shqipërisë me *acquis* të BE-së.

2.2 Krijimi i mbetjeve

Të dhënat e disponueshme mbi krijimin total të mbetjeve në Shqipëri tregojnë një rënie, krahasuar me pikun e raportuar 10 vjet më parë. Në vitin 2015, sasia e mbetjeve bashkiake të gjeneruara arriti mbi 1.4 milionë tonë, ndërsa në vitin 2023, kjo sasi ra në rreth 844 mijë tonë, duke shënuar një reduktim prej

rreth 40%. Diagrami më poshtë tregon shkallën e krijimit të mbetjeve, krahasuar me dinamikën e ndryshimit të numrit të popullsisë, si dhe rritjen e regjistruar të PBB-së².




Figura 1. Shkalla e rritjes së mbetjeve, PBB-së dhe popullsisë

Ekonomia shqiptare pritet të rritet në vitet në vijim. Programi i parandalimit të krijimit të mbetjeve synon të kontribuojë në shkëputjen e rritjes ekonomike nga gjenerimi i mbetjeve dhe shmangien e rritjes proporcionale të kurbës së gjenerimit të mbetjeve me PBB-në, duke kontribuar njëkohësisht në objektivat strategjike kombëtare për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese dhe efikasitetit të përdorimit të burimeve. Gjithashtu, rritja e të ardhurave familjare do të stimulojë rritjen e konsumit, si dhe rritjen e sasive të krijimit të mbetjeve bashkiake. Për këtë arsye, objektivat e politikave të krijimit të mbetjeve në Shqipëri, do të orientohen edhe drejt përputhjes me trendet e krijimit të mbetjeve të vendeve të BE-së.

Struktura e mbetjeve bashkiake në Shqipëri, pasqyron disa burime kryesore të gjenerimit të mbetjeve. Një studim i vitit 2022 mbi përbërjen e mbetjeve tregon se 58.1% e mbetjeve bashkiake të gjeneruara në Shqipëri ishin organike, të ndjekura nga 9.2% plastikë dhe 8.9% mbetje letre. Në këtë kontekst, strategjitë kryesore për parandalimin e

mbetjeve bashkiake do të fokusohen në reduktimin e mbetjeve ushqimore të shmangshme, si dhe në uljen e përdorimit të produkteve plastike problematike, të shmangshme dhe të panevojshme, përfshirë produktet plastike njëpërdorimshme dhe mikroplastikat.

Zhvillimi i shpejtë urban dhe sidomos ai bregdetar ka çuar në rritje të konsiderueshme të mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja (MNS), veçanërisht atyre të materialeve të gjermimit nga vendet e ndërtimit. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), sasia e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja, të gjeneruara në vitin 2022 ishte 446,000 tonë, ku pjesën më të madhe e përbënin materialet e gjermimit dhe gurëve. Aktualisht, vetëm bashkia Tiranë disponon vende të posaçme për asgjësimin e mbetjeve të ndërtimit. Zhvillimi i teknikave të parandalimit të MNS-ve, pavarësisht se nuk mund t'i shmangin plotësisht, mundësojnë reduktimin e ndjeshëm të sasisë së mbetjeve për trajtim.

² Të dhënat e disponueshme për krijimin e mbetjeve tregojnë një rënie të mbetjeve të gjeneruara, pavarësisht rritjes së PBB-së në të njëjtën periudhë. Megjithatë, kjo rënie mund t'u atribuohet ndryshimeve metodologjike në raportimin e të dhënave dhe jo një reduktimi real të gjenerimit të mbetjeve.

Sa u përket mbetjeve të rrezikshme, edhe pse numri i prodhuesve të mëdhenj në Shqipëri mbetet relativisht i kufizuar, sipas të dhënave të AKM-së, sasitë e raportuara të mbetjeve të rrezikshme të gjeneruara në vitin 2023, arritën në pothuajse 40,000 tonë. Pjesa më e madhe e këtyre mbetjeve përfshinte mbetje nga ndarja e naftës/ujit (30%), trajtimi i gazit, si dhe mbetje nga metalurgjia e hekurit (22%). Po ashtu, mbetjet e baltës së mbetjeve, vajrave të përdorura, si dhe mbetjeve të tjera që përmbajnë vaj, vijojnë të jenë një kategori e konsiderueshme.

3. Objektivat e PKPM-së

Rruga drejt ekonomisë qarkulluese përbën një objektiv strategjik, si për Shqipërinë, ashtu dhe BE. Udhërrëfyesi për një Ekonomi Qarkulluese në Shqipëri vlerëson se, pavarësisht sfidave që mbeten, Shqipëria zotëron një potencial të konsiderueshëm për të përparuar me ritme të shpejta në këtë drejtim. Si i tillë, Programi për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve synon të vendosë baza dhe të forcojë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të Direktivës Kuadër për parandalimin e mbetjeve në Shqipëri.

Objektiivi kryesor i PKPM-së është promovimi i parandalimit të krijimit të mbetjeve si instrument për shkëputjen e rritjes ekonomike nga gjenerimi i mbetjeve dhe kalimin e Shqipërisë drejt ekonomisë qarkulluese.

Për arritjen e këtij objektiivi, PKPM parashikon forcimin e stimuljeve për bizneset dhe konsumatorët, reduktimin e mbetjeve aty ku është e mundur dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit në institucionet publike, familje dhe biznese, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Strategjitë kryesore për arritjen e objektiivit kryesor përfshijnë:

1. Përforsimin e kuadrit rregullator për parandalimin e mbetjeve dhe “udhëheqjen me shembull” të autoriteteve publike.

2. Krijimin e mjedisit të favorshëm për bizneset, me qëllim zbatimin e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe adoptimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese.

3. Promovimin e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm.

4. Zgjerimin e aktiviteteve të ripërdorimit dhe riparimit.

5. Adresimin e rrymave specifike me prioritet të mbetjeve.



Këto strategji janë në përputhje me politikat ekzistuese kombëtare dhe synojnë zgjerimin dhe forcimin e kuadrit rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve, duke krijuar bazat për shkëputjen e kurbës së gjenerimit të mbetjeve nga ajo e rritjes ekonomike dhe duke përshpejtuar tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie qarkulluese.

4. Fushat e ndërhyrjes

Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve (PKPM) përfshin një gamë të gjerë ndërhyrjesh, që synojnë reduktimin e mbetjeve dhe garantimin e tranzicionit të vendit drejt ekonomisë qarkulluese. DKM-ja identifikon 5 (pesë) fusha ndërhyrjeje që do të përfshihen në parandalimin e gjenerimit të mbetjeve si vijon:

4.1 Ndërhyrjet në kuadrin rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve

Kuadri rregullator i parandalimit të krijimit të mbetjeve luan një rol themelor në përcaktimin e qëllimeve, objektivave dhe kërkesave që kushtëzojnë të gjitha vendimmarrjet e tjera.

4.1.1 Përcaktimi i objektivave dhe i treguesve të parandalimit të krijimit të mbetjeve

Përcaktimi i objektivave kombëtarë është pjesë themelore e Programit të Parandalimit të Krijimit të Mbetjeve në Shqipëri. Në kuadrin rregullator të parandalimit, objektivat sasiore janë të dobishëm në rastin e treguesve të tillë si gjenerimi i mbetjeve shtëpiake për frymë dhe gjenerimi i mbetjeve joshtëpiake për frymë. Përveç kësaj, objektivat mbi ripërdorimin dhe riparimin janë, gjithashtu, pika kyçe, në përcaktimin e rëndësisë së zbatimit të këtyre masave, si një mjet për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve.



Si pjesë e përditësimit të kuadrit monitorues të ekonomisë qarkulluese, pritet që Komisioni Evropian të publikojë tregues të rinj në parandalimin e mbetjeve. Në mungesë të tyre, aktualisht shtetet anëtare të BE-së përdorin një gamë treguesish cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e rezultateve të politikave të tyre në parandalimin e krijimit të mbetjeve. Treguesit janë të rëndësishëm për matjen gjithëpërfshirëse të përfitimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, që burojnë nga ulja e sasisë së mbetjeve dhe rritja e ekonomisë qarkulluese.

4.1.2 Përdorimi i masave të planifikimit

Planifikimi i mirëstrukturuar ofron kuadrin e nevojshëm rregullator për reduktimin e mbetjeve, përmirësimin e performancës së burimeve dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme mjedisore dhe ekonomike. Ai konkretizon objektivat gjithëpërfshirëse të politikave në masa të qenësishme dhe garanton prioritizimin e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe zbatimin efektiv të tij.

Përveç autoriteteve publike qendrore, edhe autoritetet vendore luajnë një rol të rëndësishëm në marrjen e masave të promovimit të parandalimit të krijimit të mbetjeve, duke miratuar skema tarifore që nxisin parandalimin e mbetjeve; duke promovuar shërbimet e tyre, duke punuar me organizatat e ndryshme në vend për promovimin dhe inkurajimin e ripërdorimit; si dhe duke informuar dhe angazhuar në mënyrë aktive qytetarët në ripërdorim dhe aktivitete të tjera të parandalimit të krijimit të mbetjeve.

Shqipëria është e ndarë në 10 (dhjetë) zona të menaxhimit të mbetjeve. Secila prej këtyre zonave do të zhvillojë një plan zonal të menaxhimit të mbetjeve. Çdo plan zonal i menaxhimit të mbetjeve do të përmbajë një kapitull të veçantë mbi parandalimin e krijimit të mbetjeve, me masa specifike që duhen arritur në nivel zonal dhe vendor. Përveç kësaj, pas përditësimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, autoritetet vendore do të hartojnë Plane Vendore për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, në përputhje me dispozitat e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve dhe Planeve Zonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

4.1.3 Përdorimi i instrumenteve ekonomike

Instrumentet ekonomike përdoren për të përafruar stimujt financiarë me objektivat mjedisore, për të nxitur përpjekjet për parandalimin e mbetjeve dhe për të mbështetur kalimin në modele më të

qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit. Masat ekonomike krijojnë kushte të favorshme ndaj bizneseve, me qëllim reduktimin e mbetjeve në zbatim të standardeve të projektimit ekologjik dhe projektimit për ripërdorim. Tarifat e ekomoduluara në skemat e PZP-së dhe skemat e depozitimit-kthimit janë një tjetër instrument ekonomik që përdoret për shpërblimin e produkteve të dizenuara në mënyrë të qëndrueshme.

Zbatimi i skemave të tarifimit, si skemat “paguej sipas sasisë që hedh” (*Pay As You Throw* - PAYT), transponon parimin “Ndotësi paguan”, dhe lidh koston e menaxhimit të mbetjeve me sasinë e mbetjeve të gjeneruara. Shembujt nga Evropa dhe SHBA-ja kanë treguar se ky parim është një mjet i rëndësishëm për autoritetet vendore në reduktimin e krijimit në total të mbetjeve bashkiake dhe rritjen e ndarjes në burim të mbetjeve nga qytetarët. Në të gjithë Evropën, zbatohen aktualisht sisteme të ndryshme PAYT: kostot bazohen në peshën e mbetjeve, vëllimin e mbetjeve, frekuencën e grumbullimit si dhe kombinimin e disa faktorëve.

Udhërrëfyesi “Drejt Ekonomisë Qarkulluese të Shqipërisë”, parashikon zbatimin e sistemit PAYT në nivel kombëtar si një instrument për të reduktuar krijimin e mbetjeve dhe rritjen e materialeve të ndara në burim. Udhërrëfyesi parashikon krijimin e sistemit PAYT me kosto të ulët, i cili zakonisht shoqërohet me sisteme të bazuara në vëllim. Për këtë qëllim, nevojitet një analizë gjithëpërfshirëse, pasi zona të ndryshme në vend mund të adaptojnë sisteme të ndryshme PAYT.

Nxitja e ripërdorimit dhe/ose e riparimit të produkteve që janë hedhur apo pjesëve të tyre përbërëse që janë të përshtatshme për ripërdorim dhe/ose riparim, veçanërisht përmes mbështetjes me masa edukative, ekonomike, logjistike apo masave të tjera, si mbështetja apo ngritja e rrjeteve dhe qendrave të akredituara për riparimin dhe ripërdorimin, sidomos në zonat me densitet të lartë të popullsisë.

4.1.4 Ndalimet dhe heqjet graduale

Instrumentet rregullatore kanë për qëllim vendosjen e objektivave, vendosjen e ndalimeve dhe kufizimeve që ndryshojnë kushtet e kuadrit rregullator. Kufizime të tilla përfshijnë:

- Ndalime për produktet, materialet dhe/ose kimikatet që konsiderohen shqetësuese.

- Ndalim të asgjësimit të mallrave të pashitura të konsumit. Kjo praktikë është gjithnjë e më e



zakonshme në nivel global si rezultat i rritjes së shitjeve *online* dhe mbiprodhimit.

- Kërkesa që ofrojnë alternativa ripërdorimi për ushqimin e ambalazhuar me vete (*take-away*).

Gjithnjë e më shumë, po zbatohen masa kontrolli për produkte të caktuara që konsiderohen problematike, të panevojshme ose të shmangshme (PPS), veçanërisht për produktet plastike. Në këtë kategori përfshihet plastika njëpërdorimshme (SUP), të tilla si qeset mbajtëse, serviset njëpërdorimshme, pipat dhe materialet e ambalazhit, të cilat përbëjnë një nga burimet kryesore të ndotjes, veçanërisht në mjediset tokësore, ujore (liqene dhe lumenj) dhe detare dhe që shoqërohen me rreziqe të tjera për biodiversitetin dhe shëndetin publik.

Ashtu si për shumicën e shteteve anëtare, plastika në kontekstin shqiptar identifikohet si fushë prioritare me peshë në kuadrin e politikave mjedisore. Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor kërkon nga vendet e rajonit miratimin e masave për parandalimin e ndotjes nga plastika, përfshirë adresimin specifik të çështjes prioritare të mbetjeve detare, ku plastiket njëpërdorimshme janë burimi kryesor i ndotjes nga plastika.

Lufta kundër plastikës dhe parandalimi i krijimit të mbetjeve, do të ruajë një rol thelbësor në promovimin e turizmit të qëndrueshëm, si një sektor me peshë të madhe dhe në rritje për ekonominë e Shqipërisë. Reduktimi i plastikës njëpërdorimshme, rritja e ripërdorimit në shërbimet e hotelarisë si dhe integrimi i praktikave qarkulluese në zonat bregdetare do të ndihmojnë në mbrojtjen e aseteve natyrore të vendit, dhe në përmirësimin e cilësisë së përvojës së vizitorëve. Mjediset më të pastra, veçanërisht në parqet kombëtare dhe përgjatë bregdetit, do të përmirësojnë përvojën e vizitorëve, në përshatje me trendet globale të qëndrueshmërisë në industrinë e turizmit.

4.1.5 Përdorimi i prokurimit publik të gjellbër

Një nga mekanizmat më efektivë, të autoriteteve publike në parandalimin e krijimit të mbetjeve, është përfshirja e kërkesave të ekonomisë qarkulluese në proceset e prokurimit publik, i njohur edhe si prokurimi publik i gjellbër. Çdo vit, autoritetet publike shpenzojnë fonde të konsiderueshme publike për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve.

Në Shqipëri, përfshirja e Prokurimit Publik të Gjellbër (PPG) në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik (2024–2030) ka përparuar

ndjeshëm, nga e cila kërkohet qartë integrimi i kriterëve mjedisore (të gjellbra) dhe sociale në kuadrin e prokurimit publik. Strategjia iu jep mundësi institucioneve qeveritare të përzgjedhin produkte dhe shërbime të pëlqyeshme nga ana mjedisore, ndër të cilat përfshihen edhe kriteret për minimizimin e mbetjeve të ambalazhit, me qëllim rritjen e përmbajtjes së ricikluar dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve. Në këtë mënyrë PPG, jo vetëm mbështet parandalimin e mbetjeve, por gjithashtu nxit tregjet lokale të gjellbra si dhe përgatit autoritetet publike për standardet e prokurimit të BE-së. Plani i Veprimit i Strategjisë parashikon ngritjen e moduleve të specializuara të trajnimit, si dhe ofrimin e të paktën dy seancave trajnuese, të fokusuara në prokurimin e gjellbër dhe social, për stafin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe si Operatorit të Blerjeve të Përqendruara.

Sa më sipër, zhvillimi i udhëzimeve praktike të prokurimit publik, vjen në ndihmë të autoriteteve vendore në miratimin e standardeve të PPG-së. Gjithashtu, do të parashikohet zhvillimi i trajnimeve specifike me institucionet publike, për përfshirjen e “kriterëve të parandalimit të krijimit të mbetjeve” në prokurimin publik. Përveç PPG-së, autoritetet vendore duhet të miratojnë politika shtesë për “udhëheqjen me shembull”, të tilla si ndalimi i plastikës njëpërdorimshme në evente publike dhe/ose në ndërtesa të administratës publike. Të gjitha këto do të jenë mënyra për t’i ofruar publikut shembuj konkretë dhe produkte alternative të qëndrueshme.

Vendosja e objektivave kombëtarë, si dhe forcimi i kuadrit rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve janë hapa kyç, për mundësimin e një qasjeje sistematike dhe të koordinuar si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel vendor. Për më tepër, autoritetet publike do ta udhëheqin vetë procesin nëpërmjet potencialit ekonomik dhe shembullit për të tjerët. Objektivi i mësipërm është një gur themeli në përpjekjen për parandalimin e mbetjeve në Shqipëri.

4.2 Përmirësimi i projektimit dhe prodhimit për parandalimin e krijimit të mbetjeve

Vendimet e marra në fazë projektimi dhe prodhimi, janë përcaktuese për mënyrën se si një produkt të shndërrohet në mbetje. Në rastin kur infrastruktura mbështetëse është e përshtatshme, faza e projektimit është stadi ku duhet të përcaktohen parametrat e performancës, si:



qëndrueshmëria, ripërdorimi, riparimi dhe riciklimi, që janë edhe parametra përcaktues për jetëgjatësinë e produktit dhe përfshirjen e tij në ekonominë qarkulluese. Për këtë arsye, ndërhyrjet që merren në fazat e projektimit dhe prodhimit, kanë ndikim të lartë në parandalimin e krijimit dhe reduktimin e mbetjeve.

Për nxitjen e projektimit dhe prodhimit të produkteve në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese, zbatohen një sërë qasjesh të shumta, që shpesh përdoren njëkohësisht. Ato nxisin prodhuesit të përdorin praktikatat e projektimit dhe të ekonomisë qarkulluese, sikurse ndalojnë praktikat e caktuara, apo kufizojnë përdorimin e disa materialeve e substancave.

4.2.1 Ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve

Rregullorja (BE) 2025/40, mbi ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve, përmban masa të ndryshme mbi parandalimin e mbetjeve të cilat synojnë reduktimin e ndikimit mjedisor të ambalazheve. Dispozitat kryesore të Rregullores, përfshijnë kërkesat për ambalazhet e ripërdorshme, kufizimet/ndalimet për formate të caktuara të ambalazhit, etiketimin, shenjimin si dhe informacionin mbi ambalazhin, ashtu edhe kërkesat për operatorët ekonomikë dhe vërtetimin e përputhshmërisë. Lidhur me këtë të fundit, Rregullorja prezanton detyrimet në lidhje me sistemet e ripërdorimit dhe rimbushjes, si dhe objektivat e detyrueshëm të ripërdorimit.

Gjithashtu, Rregullorja kërkon përfshirjen e masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve nga ambalazhet, në programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve të Shteteve Anëtare.

Në Shqipëri, vendimi i Këshillit të Ministrave për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve do të miratohet në vitin 2026. Ky akt nënligjor synon që ndër të tjera, të rregullojë edhe reduktimin e sasisë totale të ambalazheve dhe të harmonizojë kuadrin ligjor kombëtar me kërkesat e Rregullores së BE-së.

4.2.2 Përcaktimi i kërkesave të projektimit ekologjik

Rregulloret e projektimit ekologjik përbëjnë një instrument thelbësor për përmirësimin e performancës së produkteve dhe për parandalimin e krijimit të mbetjeve. Deri më tani, rregulloret e projektimit ekologjik janë përdorur gjerësisht me qëllim vendosjen e standardeve të eficiencës energjetike, si dhe nxitjen e përdorimit të materialeve

të ricikluara, veçanërisht për ato grupe produktesh që nuk lidhen drejtpërdrejt me energjinë.

Rregullorja më e fundit e BE-së për projektimin ekologjik, dedikuar Produkteve të Qëndrueshme, përcakton kuadrin gjithëpërfshirës për përcaktimin e kërkesave të projektimit ekologjik në produktet e tregut të BE-së. Ajo prek aspekte të ndryshme të produktit, duke përfshirë parametrat që ndikojnë drejtpërsëdrejti në parandalimin e mbetjeve, si dhe ato që lidhen me qëndrueshmërinë, ripërdorimin, riparimin dhe menaxhimin e substancave që konsiderohen shqetësuese për mjedisin dhe shëndetin.

Përcaktimi i rregullave për ndalimin e vjetërimit të parakohshëm, i njohur ndryshe edhe si vjetërim i planifikuar i produkteve, do të synojë krijimin e kushtëzimeve ndaj prodhuesve, për shkurtimin e qëllimshëm të jetëgjatësisë së një produkti, si dhe detyrimin e zëvendësimit të shpeshtë të tij nga ana e konsumatorëve. Këtu do të përfshihen edhe barrierat teknologjike, si: mospërputhja me përditësimet softuerike, përdorimi i qëllimshëm i komponentëve me cilësi të ulët, si dhe mungesa e aksesit në pjesë këmbimi dhe/ose informacionit mbi riparimin.

4.2.3 Vendosja e kërkesave për informacion

Përveç përcaktimit të kërkesave mbi performancën e produktit, rregullorja e BE-së për projektimin ekologjik përcakton edhe kërkesat për informacion. Skemat e transparencës dhe etiketimit lidhen me kritere specifike të projektimit dhe janë tregues i performancës mjedisore të një produkti. Në BE, aktualisht po zbatohet Pasaporta Digjitale të Produkteve (PDP), si një instrument për ta bërë informacionin e disponueshëm nga kushdo, përgjatë të gjithë zinxhirit të vlerës. Qëllimi është t'u lejojë, të gjithë aktorëve përgjatë zinxhirit të vlerës së një produkti, të kenë akses në informacionin përkatës për produktin, duke përfshirë informacione të tilla, si përbërja dhe performanca.

Partnerët kryesorë të importit në Shqipëri përfshijnë vende të BE-së dhe vende joanëtare të BE-së, si Kina dhe Turqia. Produktet e prodhuara në BE-së, rregullohen nga Rregullorja e Projektimit ekologjik për Produktet e Qëndrueshme si dhe Direktiva e së Drejtës për Riparim, të cilat nëpërmjet Pasaportës Digjitale të Produktit, synojnë rritjen e qëndrueshmërisë së produktit, aftësisë së riparimit, si dhe rritjen e përmbajtjes së ricikluar të tij. Për sa u përket produkteve nga vendet joanëtare të BE-së,



nuk ekzistojnë të njëjtat standarde në prodhim. Kjo situatë krijon kushtet e një pabarazie tregu, ku produktet e importuara nga BE-ja kanë tendencë të jenë më të qëndrueshme dhe më të kushtueshme, ndërsa produktet e importuara nga vendet joanëtare të BE-së edhe pse më të përballueshme ekonomikisht, japin ndikim mjedisor negativ, kanë jetëgjatësi më të shkurtër dhe paraqesin sfida më të mëdha për riparim ose riciklim.

Sa më sipër, një nga prioritetet kryesore do të jetë evidentimi i pengesave ekzistuese në arritjen e objektivave të parandalimit të krijimit të mbetjeve në Shqipëri.

4.2.4 Krijimi i mjedisit të favorshëm për bizneset të përkrahin ekonominë qarkulluese

Një nga pengesat kryesore për bizneset është mungesa e stimuljeve dhe e mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin e projektimit qarkullues të produkteve dhe transformimin e modeleve të tyre të biznesit. Përtej instrumenteve ekonomike, krijimi i kushteve të tregut për produktin, krijimi i mundësive të financimit të drejtpërdrejtë, si dhe siguri i fondeve për mbështetjen e bizneseve, janë elemente thelbësore për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, përfshirë mbështetjen për kërkimin, zhvillimin, arsimin, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Ndërgjegjësimi dhe rritja e njohurive teknike të pronarëve të bizneseve dhe konsumatorëve, do të jenë pjesë e rëndësishme në përkrahjen e modeleve të ekonomisë qarkulluese.

4.3 Promovimi i konsumit të qëndrueshëm dhe zgjatja e jetëgjatësisë së produktit

Në kuadër të parandalimit të krijimit të mbetjeve, përmirësimi i projektimit të produkteve duhet të shoqërohet me promovimin e konsumit të qëndrueshëm dhe me masa që rrisin jetëgjatësisë së produktit gjatë përdorimit të tij. Këtu përfshihen si masat që ndikojnë në fazën e përdorimit ashtu dhe ato të pas përdorimit të një produkti, të cilat synojnë mbështetjen e prodhuesve, konsumatorëve dhe bizneseve, në përdorimin e produkteve më të qëndrueshme, si dhe sistemeve të ripërdorimit, rimbushjes dhe të riparimit. Promovimi i praktikave të sipërcituara, do të reduktojë kërkesën për produkte të reja duke i mbajtur produktet dhe materialet sa më gjatë në qarkullim.

4.3.1 Modelet e konsumit të qëndrueshëm dhe sjellja e përgjegjshme e konsumatorit

Konsumatorët duhet të përqafojnë një stil efikas jetese në dobi të përdorimit të burimeve dhe zgjatjes

së jetëgjatësisë së produktit. Ndryshimi i sjelljes së konsumatorit, kërkon sa përpjekje të vazhdueshme të mbështetura nga mekanizma ekonomikë dhe sistematikë që e bëjnë më të lehtë zgjedhjen e produkteve të qëndrueshme. Gjithashtu, konsumatorët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e mbetjeve, duke i dhënë përparësi riparimit të produkteve për sa është e mundur në vend të zëvendësimit të tyre, duke zgjedhur shpërndarjen dhe ripërdorimin e mallrave, në vend të blerjeve të reja, si dhe duke mbajtur qëndrime konsumatore të përgjegjshme dhe të informuara.

Në kuadrin e ekonomisë së shpërndarjes bëjnë pjesë edhe konsumatorët që zgjedhin të mos i blejnë mallrat, por t'i shkëmbejnë ato me të tjerët përmes metodave të qiramarrjes ose *leasing*. Kjo qasje, redukton konsumin e burimeve dhe lehtëson përgjegjësitë e menaxhimit të mbetjeve pasi produkti të jetë përdorur. Në këtë model, pronari ose prodhuesi mbetet përgjegjës për mallrat dhe i përmirëson apo i mirëmban ato, duke siguruar krijimin e sa më të paktë ose aspak të mbetjeve. Promovimi i ngritjes së qendrave të shpërndarjes do t'u jepte konsumatorëve mundësinë e përzgjedhjes së instrumenteve të qiramarrjes, si alternativë ndaj blerjes së produkteve.

Krahas hartimit të “kushteve të kuadrit rregullator”, autoritetet publike do të angazhohen në ngritjen e strukturave private edhe përmes marrëveshjeve vullnetare, të cilat do të promovojnë objektiva mjedisore dhe sociale. Këto marrëveshje, shkojnë përtej rregulloreve të detyrueshme dhe kanë qëllim që të inkurajojnë kompanitë e biznesit privat, të përmirësojnë performancën e tyre mjedisore në bazë vullnetare. Ato po bëhen gjithnjë e më të spikatura në vende të ndryshme, si strategji të vlefshme dhe të adaptueshme për arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë, ose për përmirësimin e performancës mjedisore përtej përputhshmërisë me detyrimet rregullore.

Marrëveshjet vullnetare do të luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen e përshtatjes së produkteve, ambalazheve dhe modeleve të ofrimit të shërbimeve, me qëllim parandalimin e mbetjeve. Duke iu ofruar bizneseve fleksibilitet në përdorimin e inovacionit dhe alternativave, pa presionin e rregulloreve detyruese, këto iniciativa vullnetare u mundësojnë atyre të zhvillojnë standarde të reja të industrisë dhe do të kalojnë gradualisht drejt rregullimit formal. Marrëveshjet do të mund të jenë të çdo forme dhe



me palë të ndryshme të interesuara, përfshirë bizneset, aktorët e sektorit publik, OJQ-të dhe çdo palë tjetër relevante të interesuara. Këto bashkëpunime vullnetare do të luajnë rol thelbësor për mbështetjen e bizneset në përqafimin e praktikave të ripërdorimit dhe riparimit, duke sjellë reduktimin e ambalazheve të përdorura, si dhe modifikimin e projektimit të produkteve drejt qëndrueshmërisë.

Marrëveshjet vullnetare do të përdoren gjithnjë e më shumë në sferat e parandalimit të plastikës dhe mbetjeve ushqimore dhe paraqiten veçanërisht të përshtatshme për partneritet me hotele, restorante dhe kafene/katering (HoReCa).

4.3.2 Krijimi i kushteve për ripërdorim dhe riparim

Ripërdorimi është një strategji themelore për parandalimin e mbetjeve dhe një shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Ai parandalon mbetjet duke rritur jetëgjatësinë e produkteve dhe materialeve, redukton varësinë nga produktet njëpërdorimshme, si dhe minimizon nevojën për prodhime të reja, duke reduktuar mbetjet që e shoqërojnë atë. Përgatitja për aktivitetet e ripërdorimit përfshin: rinovimin dhe riparimin, krijimin e dyqaneve dhe tregjeve të dorës së dytë, transformimin e materialeve të mbetjeve në produkte të reja me vlerë më të lartë, përdorimin e kontejnerëve të ripërdorshëm në sektorin e shitjeve me pakicë etj.

Ngritja e qendrave të ripërdorimit dhe riparimit, do të jetë një nga iniciativat më të rëndësishme të mbështetura nga autoritetet publike. Qendrat e ripërdorimit dhe riparimit do të kenë një funksion të dyfishtë. Nga njëra anë, reduktojnë ndjeshëm volumin e mbetjeve dhe nga ana tjetër, do të ofrojnë përfitime sociale dhe ekonomike duke krijuar vende pune dhe akses në mallra të lira për grupet vulnerabël. Të dhënat tregojnë se një ndërmarrje sociale, aktive në fushën e ripërdorimit dhe përgatitjes për ripërdorim, aktualisht krijon mesatarisht 70 vende pune për 1000 tonë mbetje të grumbulluara. Për më tepër, shumica e ndërmarrjeve sociale punësojnë midis 45% dhe 80% të personave nga grupeve disavantazhuara, në aktivitetet e tyre.

Rregulloret e përditësuara të BE-së synojnë të garantojnë ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe të

përballeshme të riparimit, duke edukuar konsumatorët rreth të drejtave të tyre për riparim. Artikujt e riparuar gjatë periudhës së garancisë do të marrin një shtesë kohore prej një viti të garancisë ligjore, duke nxitur konsumatorët të përzgjedhin riparimin në vend të zëvendësimit/blerjes së produktit. Edhe pas përfundimit të garancisë, prodhuesit do të mbeten të detyruar të riparojnë produktet shtëpiake që janë teknikisht të riparueshme, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Kërkesa për akses në informacionin e riparimit dhe pjesët e këmbimit do të jetë një masë kyçe rregullatore për të mundësuar një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm riparimi.

4.4 Minimizimi i mbetjeve nga sektori i ndërtimit, i prodhimit dhe nga proceset industriale

Mbetjet e gjeneruara nga prodhimi dhe proceset industriale përbëjnë një nga rrymat më të rëndësishme të mbetjeve në Shqipëri. Sektorët më të mëdhenj në Shqipëri përfshijnë tekstilin dhe këpucët, ndërtimin, minierat dhe guroret, si dhe sektorin e bujqësisë.

Parandalimi i krijimit të mbetjeve në sektorin e industrisë në Shqipëri vazhdon të pengohet nga një nivel ende i kufizuar i inovacionit dhe përvetësimit të teknologjisë, si dhe të njohurive teknike në vend.³

4.4.1 Përdorimi i teknikave më të mira të disponueshme

Teknikat më të mira të disponueshme (TMD), janë thelbësore për reduktimin e gjenerimit të mbetjeve në proceset industriale. Ato përfaqësojnë metodat, praktikat dhe teknologjitë më efektive dhe të përparuara për minimizimin e ndikimit mjedisor, përfshirë mbetjet. TMD-të promovojnë procese me efikasitet të lartë të burimeve, duke reduktuar konsumin e lëndëve të para dhe prodhimin e mbetjeve në burim, si dhe duke reduktuar krijimin e mbetjeve.

TMD-të do të shërbejnë si bazë për lëshimin e lejeve mjedisore të cilat do të përcaktojnë detyrimet e operatorëve për të minimizuar ndikimin mjedisor, përfshirë krijimin e mbetjeve, emetimet, si dhe përdorimin e burimeve. Proceset që preken nga TMD-të, lidhen me prodhimin industrial, nxjerrjen e mineraleve, prodhimin, aktivitetet e ndërtimit dhe shembjes.

³ Ripërdorimi dhe Riparimi në një Ekonomi Qarkulluese dhe Sociale, Përmbledhje Politikash nga Platforma e Mësimin të Faqe| 8090

Politikave mbi Mjedisin dhe Eficiencën e Burimeve, Interreg Europe, dhjetor 2022 (burimi origjinal në: <https://rreuce.org>).



Promovimi i reduktimit të substancave të rrezikshme të produktet, përfshin zbatimin e rregulloreve përkatëse, futjen e alternativave inovative të sigurta, si dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, në përputhje me kërkesat e BE-së për transparencën kimike, duke përfshirë rregulloret REACH-in (regjistrimi, vlerësimi, autorizimi dhe kufizimi i kimikateve) dhe RoHS- in (kufizimi i substancave të rrezikshme). Kjo qasje e integruar do të mbështesë parandalimin e mbetjeve, do të ndihmojë në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, si dhe do të nxisë njëkohësisht zhvillimin e tregjeve më të sigurta dhe më të qëndrueshme.

4.4.2 Përvetësimi i teknologjive me efikasitet të lartë të burimeve

Teknologjitë me efikasitet të lartë të burimeve janë thelbësore për parandalimin e mbetjeve në industrinë e përpunimit, pasi ato mundësojnë një prodhim më të pastër dhe më të qëndrueshëm, reduktojnë vëllimin e mbetjeve të gjeneruara dhe fuqizojnë ekonominë qarkulluese. Teknologjitë e sipërcituara do të optimizojnë përdorimin e lëndëve të para, duke minimizuar mbetjet gjatë proceseve të prodhimit dhe duke ulur sasinë e mbetjeve që krijohen. Gjithashtu, ato do të lehtësojnë rikuperimin e materialeve të vlefshme brenda ciklit të prodhimit, duke lejuar ripërdorimin dhe riciklimin, e rrjedhimisht edhe akumulimin e mbetjeve.

4.4.3 Reduktimi i krijimit të mbetjeve dhe i ndikimit mjedisor nga sektori i ndërtimit

Ripërdorimi paraqet potencial të lartë në sektorin e ndërtimit, me përfshirjen e materialeve të rikuperuara nga punimet e shembjes në projektet e reja të ndërtimit ose rinovimit. Për të nxitur këtë qasje, autoritetet publike do të hartojnë kritere dhe kushte të posaçme në kuadrin rregullator të parandalimit të krijimit të mbetjeve, për nxitjen e përgatitjes për ripërdorim të mbetjeve nga ndërtimi dhe shembjet. Kjo do të realizohet përmes një sërë masash, duke përfshirë:

- Zbatimin e praktikave selektive të shembjes në kantieret e ndërtimit;
- Vendosjen e objektivave për përgatitjen për ripërdorim, riciklimin dhe forma të tjera të

rikuperimit të materialeve të mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimi dhe shembjet;

- Hartimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve për projektet e reja të ndërtimit;
- Zhvillimin e standardeve të cilësisë për materialet e ricikluara të ndërtimit;
- Nxitjen e përdorimit të materialeve të ricikluara të ndërtimit në proceset e prokurimit publik për projektet e mëdha infrastrukturore.

4.5 Parandalimi i shpërdorimit të ushqimit, promovimi i rishpërndarjes së ushqimit dhe arritja e reduktimit të përgjithshëm të mbetjeve bio.

Parandalimi i krijimit të mbetjeve ushqimore përbën një nga sfidat më të rëndësishme që ka marrë vëmendje të madhe, si në Evropë, ashtu edhe në nivel global. OZHQ.12.3 parashikon që mbetjet ushqimore për frymë, të përgjysmohen deri në vitin 2030, si në nivel të shitjes me pakicë ashtu edhe të konsumatorit, duke reduktuar humbjet e ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe furnizimit. Pavarësisht përpjekjeve ndërkombëtare, mbetjet organike mbeten kategoria më e madhe e mbetjeve të depozituara në landfillet bashkiake. Si rezultat, landfillimi është burimi i tretë më i madh i emetimeve të metanit në nivel global.⁴

4.5.1 Reduktimi i mbetjeve ushqimore në prodhimin primar, përpunimin, shitjen me pakicë, shërbimet ushqimore dhe familjet.

Mbetjet ushqimore janë një shqetësim i madh i sigurisë globale ushqimore ashtu edhe për menaxhimin efektiv mjedisor. Në vitin 2020, BE-ja miratoi strategjinë “Nga ferma në pirun” si pjesë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane⁵. Strategjia u përqendrua në fusha konkrete të menaxhimit me efikasitet të humbjes dhe shpërdorimit të ushqimit, sigurimit të prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit, shitjes me shumicë dhe pakicë, mikpritjes dhe shërbimeve ushqimore, si dhe promovimin e konsumit të qëndrueshëm të ushqimit.

Parandalimi i krijimit të mbetjeve ushqimore është më i qëndrueshëm ekonomikisht sesa trajtimi i mbetjeve. Për këtë arsye, masat duhet të fokusohen në parandalimin dhe reduktimin e mbetjeve ushqimore, nga prodhimi primar dhe përpunimi tek shitja me pakicë dhe shpërndarjet e tjera të ushqimit dhe deri te familjet.



Një seri masash mund të ndikojnë drejtpërdrejt në reduktimin e mbetjeve ushqimore në faza të ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit. Parashikimi i mirë, si dhe inventarët e saktë të ushqimeve do të rrisin ndjeshëm përmirësimin e zinxhirit të furnizimit me ushqim. Parandalimi i krijimit të mbetjeve ushqimore në familje do të kërkojë, gjithashtu, një nivel të lartë ndërgjegjësimi, si te qytetarët, ashtu edhe te bizneset.

Duke qenë se çështja e mbetjeve ushqimore për nga rëndësia, kërkon përgjithësisht masa specifike, shumica e vendeve në BE kanë zhvilluar programe kombëtare për parandalimin dhe reduktimin e mbetjeve ushqimore, të bazuara në studime gjithëpërfshirëse gjatë gjithë zinxhirit të prodhimit. Identifikimi i boshllëqeve në këtë drejtim do të jetë një prioritet kyç për Shqipërinë, për të arritur reduktimin e ndjeshëm të sasisë së krijimit të mbetjeve ushqimore.

4.5.2 Dhurimi i ushqimeve

Dhurimin dhe rishpërndarja e ushqimit janë mekanizma të rëndësishëm për reduktimin e mbetjeve ushqimore. Lehtësimi i dhurimit të ushqimit është një fushë prioritare, në planin e veprimit të BE-së për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Parandalimi i krijimit të mbetjeve ushqimore synon shmangien e prodhimit të tepërt ushqimor në zinxhirin e furnizimit me ushqim. Megjithatë, në rastin kur ushqimi është i sigurt dhe i përshtatshëm për konsum njerëzor, opsioni i preferuar është që ushqimi të jetë i disponueshëm për njerëzit në nevojë. Edhe pse qëllimi kryesor i dhurimit të ushqimit është të ofrojë ushqim të mirë dhe të shëndetshëm për njerëzit vulnerabël dhe jo të reduktojë mbetjet ushqimore, mundësia e ridrejtimit të produkteve të pashitura te këta marrës, përputhet plotësisht me qëllimet e parandalimit të krijimit të mbetjeve ushqimore.

Për të lehtësuar dhe inkurajuar dhurimin e ushqimit, vende të ndryshme në Evropë kanë investuar, në:

- Rregulloret detyruese: duke kërkuar dhurimin e ushqimit të pashitur nga supermarketet, sektorit të kateringut dhe mikpritjes.

- Elementet ligjore: duke minimizuar rreziqet ligjore dhe përgjegjësinë për dhurimet e ushqimit, aty ku është e mundur.

- Stimujt ekonomikë: duke përjashtuar nga taksat ushqimin e dhuruar.

- Mekanizma organizativë: nëpërmjet ngritjes së grupeve sektoriale të punës për dhurimin e ushqimit, për lehtësimin dhe inkurajimin e dhurimit të ushqimit në Shqipëri, si dhe kryerjen e një studimi mbi pengesat e mundshme ligjore dhe dhurimet ushqimore që kryhen aktualisht.

- Ngritjen e kapaciteteve: organizimi i trajnimeve mbi dhurimet e ushqimit, për punonjësit në sektorët e industrisë ushqimore shitjes me pakicë dhe shërbimit të ushqimit (p.sh. hotele, restorante dhe kafene).

Banka e Ushqimit në Shqipëri është pjesë e Federatës Evropiane të Bankave të Ushqimit. Kjo iu jep bizneseve mundësinë e bashkëpunimit me Bankën e Ushqimit duke mundësuar shpërndarjen në sasi të ushqimit te njerëzit në nevojë. Këto qasje ndihmojnë në devijimin e ushqimit të konsumueshëm nga asgjësimi në landfill dhe të përdoren. Megjithatë, aktualisht, Shqipëria nuk ka një kuadër ligjor dhe rregullator të posaçëm për nxitjen e dhurimeve të ushqimit.

4.5.3 Kompostimi në banesë

Një nga mënyrat më të përballueshme dhe efektive për parandalimin e krijimit të mbetjeve bio në burim, është kompostimi në banesë. Kompostimi është një proces biologjik natyror në të cilin mbetjet organike zbërthehen nga mikroorganizmat dhe shndërrohen në një substancë plehu organik, të ngjashme me humusin dhe të pasur me lëndë ushqyese. Kompostimi në shtëpi kryhet kryesisht në oborret e shtëpive dhe nuk kërkon pajisje të ndërlikuara, por vetëm njohuri bazë dhe këmbëngulje.

Për ta bërë kompostimin në banesë të sigurt dhe efikas ë familjet duhet të kenë njohuri të sakta mbi ndarjen mbetjeve organike për kompostim, si dhe përdorimin e kompostuesit për realizimin e një procesi të sigurt dhe efikas. Për këtë arsye, autoritetet kombëtare dhe vendore do të zhvillojnë fushata ndërgjegjësimi, me materiale edukative dhe trajnime për rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe edukimin e njerëzve mbi përdorimin e duhur të kompostuesve. Për më tepër, me qëllim kryerjen e këtij procesi, autoritetet vendore do të sigurojnë dhe dhurojnë kompostues shtëpiakë.

Studimet e fundit mbi përbërjen e mbetjeve bashkiake në Rajonin Jugor të Vlorës konstatuan se mbetjet organike (mbetjet ushqimore dhe mbetjet e gjelbra) ishin fraksioni mbizotërues i mbetjeve



bashkiake, 50% deri në 60% të tyre në qytet⁶ dhe deri në 70% në zonat rurale⁷. Këto të dhëna nënvizojnë potencialin e lartë të kompostimit në banesë për të reduktuar ndjeshëm sasinë e mbetjeve organike që përfundojnë në landfillë.

5. Prioritetet e PKPM-së

Bazuar në analizën e seksionit 4, në përshkrimin e fushave të ndërhyrjes, si dhe në vlerësimin e

zbatueshmërisë së tyre në kontekstin shqiptar, identifikohen tri prioritete kryesore, së bashku me fushat e përzgjedhura të ndërhyrjes.

Tabela më poshtë paraqet prioritetet e Programit Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve dhe fushat e ndërhyrjes.

Tabela 2. Prioritetet dhe fushat e ndërhyrjes

Prioritet	Fusha e ndërhyrjes
Prioriteti 1. Hartimi i kuadrit rregullator të politikave mbështetëse të parandalimit të krijimit të mbetjeve nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional	• Hartimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve; • Përdorimi i fuqisë blerëse së autoriteteve publike; • Udhëheqja me shembull nga autoritetet publike; • Ofrimi i infrastrukturës dhe shërbimeve thelbësore.
Prioriteti 2: Mundësimi i praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit	• Përdorimi i instrumenteve ekonomike për të nxitur praktikatat e parandalimit të krijimit të mbetjeve; • Krijimi i një mjedisi të favorshëm për bizneset dhe konsumatorët për përvetësimin e praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit; • Promovimi i ripërdorimit dhe riparimit.
Prioriteti 3: Adresimi i rrymave specifike me prioritet të mbetjeve	• Reduktimi i mbetjeve organike; • Reduktimi i mbetjeve plastike; • Reduktimi i mbetjeve të ambalazheve; • Reduktimi i mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja.

Prioriteti 1 synon krijimin dhe forcimin e kuadrit rregullator të politikave për parandalimin e krijimit të mbetjeve nën mbikëqyrjen e autoriteteve publike. Si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë vendor, pasja e një kuadri të fortë politikash është thelbësore për mundësimin e një qasjeje sistematike dhe koordinuese në parandalimin e mbetjeve. Përveç kësaj, autoritetet publike do të japin shembullin e tyre, nëpërmjet instrumenteve të prokurimit publik të gjelbër dhe ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme.

Prioriteti 2 përqendrohet në mundësimin e praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit. Këto ndërhyrje do të krijojnë stimuj për bizneset dhe konsumatorët nëpërmjet përdorimit të masave ekonomike dhe rregullatore, si për reduktimin e mbetjeve në burim ashtu dhe për zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve. Gjithashtu, me promovimin e ripërdorimit dhe riparimit, këto masa do të kontribuojnë në parandalimin e mbetjeve dhe

në forcimin e një ekonomie qarkulluese që i mban produktet dhe materialet, më gjatë në qarkullim.

Prioriteti 3 synon rrymat specifike me prioritet të mbetjeve, ku potenciali i ndikimit në parandalimin e krijimit të mbetjeve është më i lartë. Këto përfshijnë mbetjet organike (mbetje ushqimore dhe të gjelbra), mbetjet plastike, mbetjet nga ambalazhet si dhe mbetjet nga ndërtimi dhe shembja.

Përveç këtyre fushave prioritare, janë identifikuar edhe masa horizontale për zbatimin e tyre. Këto masa përfshijnë:

- Zbatimin e fushatave informuese;
- Zhvillimin e një faqeje në internet, të dedikuar për parandalimin e krijimit të mbetjeve;
- Përdorimin e aplikacioneve të telefonisë dhe platformave *online*, për mbështetjen e nismave të parandalimit të krijimit të mbetjeve.

5.1 Prioriteti 1: Hartimi i kuadrit rregullator të politikave mbështetëse për parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe mbikëqyrjes së autoriteteve

⁶ Përgatitja e një Raporti të Rishikuar të “Studimit të Fizibilitetit për Rajonin Jugor të Vlorës, korrik 2020”, i përgatitur nga projekti Asistencë Teknike për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta për dy Bashki të Përzgjedhura të Shqipërisë – EuropeAid/138181/DH/SER/AL.

⁷ Anketa të kryera në bashkitë e Sarandës dhe Roskovecit në vitin 2021, në kuadër të projektit “Menaxhimi i modernizuar dhe miqësor ndaj klimës i mbetjeve të ngurta dhe riciklimit në Shqipëri”, financuar nga GIZ.

**Masa 1. Hartimi i Planeve Zonale të Menaxhimit të Mbetjeve me grup masash për parandalimin e mbetjeve**

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin e saj të Veprimit (referuar më poshtë si Strategjia Kombëtare për përditësim në vitin 2026), Planet Zonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PZMM) do të hartohen për të dhjetë zonat e menaxhimit të mbetjeve në vend. Të gjitha PZMM-të do të përmbajnë një kapitull të veçantë mbi parandalimin e mbetjeve, ku do të përshkruhen të gjitha masat pjesë e planit të veprimit për periudhën përkatëse të zbatimit në përputhje me nevojat dhe karakteristikat e zonës përkatëse të menaxhimit të mbetjeve. Në mënyrë të detyrueshme, planet duhet të përfshijë, gjithashtu, objektiva dhe synime të matshme për përgatitjen për ripërdorimin në të njëjtën linjë me kërkesat kombëtare dhe ato të BE-së.

PZMM-të duhet të miratohen jo më vonë se viti 2028.

Masa 2. Hartimi i Planeve Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve me grup masash për parandalimin e mbetjeve

Në përputhje me kërkesat e sipërcituara, do të hartohen dhe miratohen edhe Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMM). Këto PVMM do të jenë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të ri, Strategjinë Kombëtare, si dhe PZMM-të. Ashtu si PZMM-të, planet vendore duhet të përfshijnë një kapitull të veçantë mbi masat për parandalimin e mbetjeve, si dhe objektiva dhe synime të matshme për përgatitjen për ripërdorim. Procesi i hartimit, konsultimit dhe miratimit të PVMM-ve pritët të përfundojë deri në fund të vitit 2030.

Masa 3. Hartimi dhe publikimi i udhëzuesve praktikë për përfshirjen e kriterëve të gjelbra në prokurimin publik

Udhëzimet praktike për përfshirjen e kriterëve të gjelbra në prokurimin publik, të hartuara dhe publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, për ndjekje dhe zbatim nga autoritetet kontraktore.

Masa 4. Përfshirja e “kriterëve të gjelbra” në prokurimin publik, me qëllim ndikimin sistematik në parandalimin e krijimit të mbetjeve

Formulimi i duhur i kriterëve dhe kërkesave mjedisore në dokumentet e tenderit, promovon

parandalimin e mbetjeve që në fazat e hartimit, dorëzimit të ofertave dhe zbatimit të kontratave.

Për sa më sipër kriteret e qëndrueshme të zbatueshme, përfshijnë:

- Përdorimin e materialeve të ricikluara të ndërtimit në kantieret e ndërtimit të financuara nga autoritetet publike.

- Pajisjet dhe furnizimet e zyrave: përparësi u jepet letrës së ricikluar, tonerëve që mund të rimbushen, pajisjeve me efikasitet energjetik me mundësi riparimi.

- Shërbimin e ushqimit, që përfshin shmangien e produkteve plastike njëpërdorimshme, si dhe kërkesat për sisteme kompostimi të mbetjeve organike.

- Veshjet dhe tekstilet, ku përfshihen kërkesat për qëndrueshmëri, për mundësi riparimi dhe ripërdorimi.

- Eventet dhe aktivitetet publike, si p.sh., përdorimi i kontejnerëve të ripërdorshëm, menaxhimi i mbetjeve në vendin e krijimit, si dhe fushata informuese për vizitorët.

Masa 5. Zhvillimi i modeleve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bazuar në tipologjitë e ndryshme të ndërtimeve dhe softuerëve për llogaritjen e tarifave të mbetjeve

Qeveria do të asistojë bashkitë, në përdorimin e sistemit PAYT, duke zhvilluar modele për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bazuar në tipologji të ndryshme ndërtimore në vend (zona me ndërtesa shumëkatëshe, zona me banesa private, zona banimi të përziera etj.). Modelet do t'u ofrojnë bashkive mënyra organizimi të proceseve të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në territorin e kompetencës, duke mundësuar tarifimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me parimin PAYT. Në varësi të tipologjisë ndërtimore të zonës, modelet e përdorura mund të bazohen në parimin e vëllimit dhe/ose peshës së mbetjeve. Pas krijimit të modeleve, do të zhvillohet një softuer i dedikuar, i cili do të ndihmojë bashkitë në përllogaritjen e tarifave të sakta të mbetjeve për secilin model të zgjedhur, duke siguruar transparencë në tarifim.

Masa 6. Zbatimi i parimit “Paguaj sipas hedhjes”

“Paguaj sipas hedhjes” (PAYT) është parimi që ofron nxitje ekonomike në reduktimin e mbetjeve, duke inkurajuar qytetarët të riciklojnë më shumë dhe të reduktojnë krijimin e tyre. Sistemi PAYT,



konsiderohet një nga instrumentet ekonomike më efektive për reduktimin e mbetjeve dhe promovimin e konsumit të përgjegjshëm. Zbatimi i tij mundëson vendosjen e tarifave të balancuara të mbetjeve bashkiake, sipas të cilit çdo familje ose biznes, paguan sipas sasisë aktuale të mbetjeve të gjeneruara, në vend të një tarife fikse. Në këtë mënyrë, familjet dhe bizneset do të nxiten të ndajnë sa më shumë mbetje të riciklueshme të jetë e mundur (për të cilat nuk do të paguajnë) dhe do të paguajnë një tarifë mbetjesh vetëm për mbetjet e mbetura të përziera.

Zbatimi i PAYT kërkon ndryshime thelbësore, si në mënyrën e ndarjes së tarifave të mbetjeve bashkiake midis familjeve dhe bizneseve, ashtu dhe në sistemin e grumbullimit të mbetjeve bashkiake. Modeli i grumbullimit në pika të përbashkëta duhet të zëvendësohet gradualisht me përdorimin e koshave/kontejnerëve individualë, duke mundësuar matjen e sasisë së mbetjeve për familje dhe subjekte biznesi.

Paralelisht me zhvillimin e modeleve për grumbullimin e mbetjeve, MM-ja do të iniciojë ndryshimet e nevojshme ligjore për adoptimin e sistemit PAYT, duke mundësuar zbatimin e tarifave të bazuara në peshë dhe/ose vëllim për shërbimet bashkiake të menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë do të fillojnë të aplikojnë tarifimin PAYT për familjet dhe subjektet e biznesit, jo më vonë se viti 2029.

Masa 7. Vendosja e modulimit tarifar të PZP-së

Për të rritur ripërdorimin dhe riciklimin e ambalazheve, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit, MM-ja do të sigurojë që kontributet financiare të paguara nga prodhuesit, të modulohen në përputhje me riciklueshmërinë e produkteve të tyre të nxjerra në treg.

Tarifat e ekomoduluara të PZP-së për produktet e vendosura në treg, do të bazohen në ndikimin mjedisor të këtyre produkteve, duke marrë parasysh riciklueshmërinë, qëndrueshmërinë, lehtësinë e riparimit dhe potencialin e krijimit të mbetjeve. Në këtë mënyrë, tarifat e ekomoduluara do të shërbejnë si një instrument i rëndësishëm brenda skemave të PZP-së për parandalimin e krijimit të mbetjeve. Prodhuesit do të inkurajohen financiarisht të projektojnë produkte që krijojnë më pak mbetje, që janë më të lehta për t'u ricikluar dhe që kanë jetëgjatësi më të madhe, duke mbështetur kështu

drejtpërdrejt parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese.

Masa 8. Krijimi i skemës së PZP-së për tekstilet

PZP-ja për tekstilet është një politikë që i ngarkon prodhuesit e tekstileve me përgjegjësi gjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve të tyre, duke përfshirë grumbullimin, ripërdorimin, riparimin dhe riciklimin e mbetjeve, në mbështetjen drejt një ekonomie qarkulluese. Sipas Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet, shtetet anëtare duhet të krijojnë skema kombëtare të PZP-së, për të financuar dhe menaxhuar si impiantet e grumbullimit, ashtu dhe ato të ndarjes dhe riciklimit. Ky kalim i përgjegjësisë nga autoritetet publike të prodhuesit, pritet të reduktojë krijimin e mbetjeve tekstile dhe të inkurajojë prodhimin e produkteve më rezistente dhe më të qëndrueshme nga ana mjedisore. Qeveria synon miratimin e skemës së PZP-së për tekstilet, brenda vitit 2028, duke siguruar krijimin e mekanizmave të nevojshëm për funksionimin efektiv të skemës dhe për mbështetjen e iniciativave për riciklim dhe ripërdorim..

Masa 9. Mbështetja me fonde publike e nismave të parandalimit të krijimit të mbetjeve

Në zbatim të ligjit të ri “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe për krijimin e një mekanizmi financiar të dedikuar, MM-ja do të mbështesë me fonde publike nismat që synojnë parandalimin e krijimit të mbetjeve. Mbështetja me fondet publike e këtyre iniciativave, luan një rol kyç në promovimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve. Financimi publik për parandalimin e mbetjeve do të nxisë inovacionin, do të reduktojë pengesat financiare, do të inkurajojë praktikën më të mira, si dhe do të përshpejtojë kalimin në sisteme të qëndrueshme dhe qarkulluese të menaxhimit të mbetjeve, me përfitime afatgjata mjedisore dhe ekonomike.

5.2 Prioriteti 2: Mundësimi i praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit

Masa 10. Përfshirja në lejet mjedisore e reduktimit të krijimit të mbetjeve nga ndërmarrjet e mëdha industriale

Ndërmarrjet e mëdha industriale në sektorin e prodhimit dhe përpunimit industrial, të cilat gjenerojnë më shumë se 1000 tonë mbetje në vit, do të hartojnë plane të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim nxjerrjen e lëndëve të para dhe reduktimin e mbetjeve përfshirë edhe e sektorin e ndërtimit.



Lejet mjedisore të këtyre ndërmarrjeve do të përfshijnë kërkesa për efikasitetin e burimeve dhe reduktimin e mbetjeve. Kur është e nevojshme, këto kërkesa do të bazohen në dokumentet referuese të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), të zhvilluara në përputhje me Direktivën e BE-së, për Emetimet Industriale dhe legjislacionin përkatës shqiptar.

Masa 11. Analiza e fizibilitetit për simbiozën industriale dhe identifikimin e sektorëve kryesorë të prodhimit

Qeveria do të nxisë shkëmbimin e materialeve, ku mbetjet e një biznesi bëhen lëndë e parë për një tjetër, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e krijimit të mbetjeve. Për këtë qëllim, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit do të kryejë një analizë të fizibilitetit për simbiozën industriale dhe do të identifikojë sektorët kryesorë të prodhimit ku mund të arrihet sinergji midis industrive.

Një hap i mëtejshëm do të jetë ofrimi i hapësirave të dedikuara në zonat dhe parqet industriale, si dhe për grupet e ndërmarrjeve që do të përfshihen në simbiozën industriale, për të mundësuar bashkëpunim efektiv dhe përdorim optimal të burimeve.

Masa 12. Forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe zbatimit të plan- masave të reduktimit të mbetjeve

Në kuadrin e parandalimit të krijimit të mbetjeve, monitorimi dhe verifikimi janë thelbësorë për të garantuar efektivitetin dhe llogaridhënien në reduktimin e mbetjeve. Ndjekja e progresit ofron të dhëna të sakta mbi nivelet e gjenimit të mbetjeve, duke lejuar vlerësimin e përmbushjes së objektivave të parandalimit. Nëpërmjet monitorimit verifikohen si strategjitë e suksesshme të parandalimit të krijimit të mbetjeve, ashtu dhe ato që paraqesin nevojë për përshtatje ose përmirësim. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit (SPIM do të fuqizohet me kapacitete të qarta dhe burime financiare për auditimin e përputhshmërisë, duke përfshirë verifikimin e planeve për reduktimin e mbetjeve të bizneseve, vlerësimin e zbatimit të masave për reduktimin e mbetjeve etj.). Gjithashtu, kjo strukturë do të sigurojë përgjegjësi të lartë dhe efektivitet në drejtim të vënies së gjobave ose pezullimeve të licencave për shkelësit.

Masa 13. Promovimi i teknologjive me efikasitet të lartë të përdorimit të burimeve në industrinë përpunuese, duke u dhënë përparësi

ushqimit, tekstileve dhe prodhimit të produkteve plastike

Forma aktuale “lineare” e funksionimit të industrisë, ku lëndët e para nxirren, përpunohen në mallra dhe në fund hidhen si mbetje ose shkaktojnë emetime, do të rishikohet me qëllim përmbushjen e objektivave të parandalimit të krijimit të mbetjeve, rritjen e përdorimit të materialeve të ricikluara, rritjen e efikasitetit të burimeve të përdorura si dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve.

Qeveria shqiptare do të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të industrisë përpunuese, për përdorimin e teknologjisë me efikasitet të lartë të burimeve, duke ofruar:

- Grante ose subvencione të drejtpërdrejta, për të kompensuar kostot e blerjes dhe të zbatimit të teknologjive të reja, me efikasitet të lartë të shfrytëzimit të burimeve;

- Kredi me interes të ulët ose linja kredie të orientuara posaçërisht drejt investimeve në teknologjitë e pastra;

- Mekanizma financimi, dhe teknologji inovative, për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare.

Kjo masë synon të përmirësojë efikasitetin e burimeve, të reduktojë mbetjet dhe emetimet, si dhe të mbështesë zhvillimin e një ekonomie qarkulluese në industrinë shqiptare.

Masa 14. Forcimi i kërkesave të konformitetit për mallrat e importuara nga vendet joanëtare të BE-së

Masa synon të forcojë kërkesat e konformitetit për produktet me rrezik të lartë të importuara nga vendet joanëtare të BE-së, duke vendosur detyrimin për importuesit që të paraqesin deklarata konformiteti ose Pasaportë Digjitale të Produktit për Shqipërinë, të përgatitur paraprakisht dhe të lexueshme nga pajisjet elektronike. Dokumenti vërteton përputhshmërinë e produktit me kriteret e qëndrueshmërisë të zbatueshme në tregun shqiptar, përfshirë jetëgjatësinë, riparueshmërinë, përmbajtjen e materialeve dhe identifikimin e substancave të rrezikshme, me synim parandalimin e gjenimit të mbetjeve.

Masa 15. Përcaktimi i ndalimit ligjor për përdorimin e praktikave të vjetrit të planifikuar

Ndalimi ligjor për vjetrimin e planifikuar, kontribuon ndjeshëm në një ekonomi më të qëndrueshme dhe me efikasitet më të lartë të



burimeve, duke fuqizuar konsumatorët dhe duke nxitur inovacionin në projektimin e produkteve. Si rezultat i kësaj mase rregullatore, produktet do të projektohen për të pasur jetëgjatësi më të madhe, duke reduktuar nevojën për blerje të reja, si dhe duke ulur krijimin e mbetjeve. Përveç kësaj, konsumatorët do të përfitojnë produkte më të qëndrueshme dhe të riparueshme, duke nxitur sjellje të përgjegjshme blerjeje dhe duke reduktuar ndikimin në mjedis.

Masa 16. Hyrja në fuqi e ndalimit ligjor për asgjësimin e mallrave stok të pashitura

Rregullat e BE-së për produktet e qëndrueshme adresojnë problematika mjedisore të asgjësimit të produkteve të pashitura të konsumit, duke ndaluar shkatërrimin e veshjeve, aksesoreve dhe këpucëve të pashitura. Për të garantuar proporcionalitetin e masave të ndërmarra, të parashikohen përjashtime për rastet kur produkte të tilla nuk mund të përdoren më dhe duhet të dorëzohen në impiantet e riciklimit ose impiantet e tjera të trajtimit të mbetjeve. Kjo masë, e bazuar në ndalimin ligjor të përdorimit të praktikave të vjetritimit të planifikuar, do të zbatohet nëpërmjet aktit nënligjor që ndalon shkatërrimin e këtyre mallrave, përveç rasteve kur ato janë të papërdorshme dhe kërkojnë riciklim. Zbatimi i saj, është me kosto efektive dhe me ndikim të lartë, duke dërguar një sinjal të qartë në treg dhe duke adresuar drejtpërsëdrejti problemin themelor sistematik brenda zinxhirit të furnizimit.

Masa 17. Prezantimi i detyrimeve të “së drejtës për riparim”

E drejta për riparim do të mbështetet, gjithashtu, në ndalimin ligjor të përdorimit të praktikave të vjetritimit të planifikuar. Detyrimi i ri do të sigurojë që prodhuesit të ofrojnë shërbime riparimi në kohë dhe me kosto efektive, si dhe të informojnë konsumatorët rreth të drejtave të tyre për riparim. Ky detyrim do të zbatohet si për mallrat e prodhuara në Shqipëri, ashtu dhe për ato të importuara. Mallrat e riparuar gjatë garancisë do të përfitojnë nga një zgjatja njëvjeçare e garancisë ligjore, duke nxitur konsumatorët të zgjedhin praktikat e riparimit në vend të riblerjes së produkteve. Për më tepër, pasi të ketë skaduar garancia ligjore, prodhuesi do të jetë i detyruar të riparojë produktet e zakonshme shtëpiake, duke siguruar që shërbimet e riparimit të jenë të disponueshme dhe të arritshme për konsumatorët gjatë gjithë jetës së produktit.

Masa 18. Ngritja e qendrave të riparimit dhe ripërdorimit

Qendrat e riparimit dhe e ripërdorimit janë hapësira të specializuara të projektuara për rritjen e jetëgjatësisë së sendeve shtëpiake përmes riparimit, restaurimit dhe ripërdorimit. Ato do të veprojnë në formë të ndryshme organizative dhe ligjore, duke përfshirë ndërmarrje bashkiake, struktura komunitare, ndërmarrje sociale, iniciativa private ose partneritete publike-privatë. Këto qendra kanë të përbashkët qëllimin e reduktimit të mbetjeve, parandalimit të asgjësimit të panevojshëm, si dhe promovimin e konsumit të qëndrueshëm.

Autoritetet vendore, në bashkëpunim me AKEM-in, do të mundësojnë krijimin e qendrave të riparimit dhe ripërdorimit. Krijimi i qendrave të riparimit dhe ripërdorimit në vende të posaçme, do të formojë sjelljet e qëndrueshme dhe do të lehtësojë aksesin e qytetarëve në shërbime të tilla. Këto qendra mund të projektohen edhe si tregje të përkohshme. Autoritetet bashkiake do të konkretizojnë mbështetjen e aktiviteteve të qendrave të ripërdorimit logjistikisht dhe organizativisht, duke ofruar hapësira të posaçme, si dhe duke promovuar përparësitë e ripërdorimit. Krijimi i qendrave të riparimit dhe të ripërdorimit do të realizohet nëpërmjet partneriteteve me organizatat jofitimprurëse dhe vullnetare.

Masa 19. Ngritja e qendrave publike për huazimin dhe shkëmbimin e mallrave të përdorura

Qendrat për huazimin dhe shkëmbimin e mallrave promovojnë praktika shoqërore dhe mjedisore me interes, të cilat synojnë rritjen e jetëgjatësisë së mallrave të konsumit dhe parandalimin e asgjësimit të tyre si mbetje. Këto iniciativa kombinojnë elemente të konsumit të qëndrueshëm, me pjesëmarrjen e komunitetit dhe edukimit mjedisor. Ato realizohen në formën e eventeve, ku qytetarët mund të sjellin sendet e tyre të mirëmbajtura, por të panevojshme dhe t'i shkëmbejnë ato me pjesëmarrës të tjerë.

Bashkitë do të mbështesin dhe inkurajojnë krijimin e qendrave të shkëmbimit dhe huazimit, duke siguruar ambiente ose hapësira të përshtatshme, si dhe duke ofruar mbështetje logjistike dhe komunikimi/shkëmbimi për aktivitetet e huazimit dhe shkëmbimit të mallrave të përdorura.



Masa 20. Promovimi i krijimit të qendrave të huazimit dhe shkëmbimit të produkteve të përdorura, midis njerëzve

Në ekonominë moderne të ndarjes, përdoruesit shpesh zgjedhin të mos e zotërojnë vetë një produkt, por ta ndajnë atë me përdorues të tjerë, për shembull përmes marrjes me qira të një produkti. Kjo mënyrë, mundëson që të konsumohen më pak burime, të gjenerohen më pak mbetje dhe produkti të përmbushë qëllimin e tij.

Bashkitë do të krijojnë bashkëpunime me organizatat joqeveritare, grupet lokale të iniciativave, si dhe ndërmarrjet sociale për rritjen e fushëveprimit dhe ndikimit në politikëbërjen e menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë nëpërmjet partneritetit me rrjetet vullnetare do të krijojnë qendra të huazimit dhe ripërdorimit të ashtuquajtura “magazina veglash”, ku përdoruesit do të mund të marrin me qira për periudha të caktuara kohore, mjete ose vegla të ndryshme pune, si trapanë, sharra etj.

Masa 21. Ngritja e rrjetit të shërbimeve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të mbetjeve të vëllimshme me qëllim ripërdorimin e tyre

Në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë, do të ngrihet një rrjet shërbimesh publike për grumbullimin e mbetjeve bashkiake. Përveç rrymave të tjera të mbetjeve, familjet do të kenë mundësinë të depozitojnë edhe mbetjet e vëllimshme, pa pagesë. Gjithashtu, bashkitë do të ngrenë shërbimet e grumbullimit në vend për familjet, ku pagesat do të kryhen për metër kub vëllim. Pas grumbullimit, mbetjet e vëllimshme do të transportohen në qendrat e riparimit për t'u përgatitur për ripërdorim.

Masa 22. Ndërtimi i çezmave me ujë të pijshëm në hapësirat publike

Instalimi i çezmave të ujit të pijshëm në hapësirat publike krijon komunitete më të shëndetshme, më të qëndrueshme dhe më gjithëpërfshirëse, duke reduktuar ndikimin mjedisor nga përdorimi i plastikës. Përdorimi i çezmave redukton konsumin e shisheve plastike njëpërdorimshme dhe ndikon në uljen e ndotjes nga mbetjet plastike.

Masa do të synojë mirëmbajtjen e çezmave ekzistuese, si dhe ndërtimin e atyre të reja me ujë të pijshëm në hapësirat publike, me qëllim reduktimin

e përdorimit të ujit të ambalazhuar dhe gjenerimin e mbetjeve të ambalazhit.

Masa 23. Kufizimi i reklamave dhe postës pa adresë

Në sektorin familjar, reklamat dhe postat pa adresë, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm të krijimit të mbetjeve të letërës, do të reduktohen përmes strategjisë së tipit “opt-out” (tërheqje nga lista e marrësve). Qytetarët do të kenë mundësinë e refuzimit të marrjes së postës së këtij lloji, duke vendosur afishe “Jo” në kutitë postare.

Autoritetet publike në Shqipëri, do të përkrahin kufizimin e reklamave dhe postës pa adresë, nëpërmjet: afishimit “Jo” në kutinë postare, për familjet që nuk dëshirojnë të marrin postë pa adresë; si dhe kushtëzimit në dërgimin e postës pa adresë në kutitë që nuk kanë të ngjitur një afishe “Po”.

5.3 Adresimi i rrymave specifike prioritare të mbetjeve

5.3.1 Mbetjet organike

Masa 24. Kryerja e studimeve të thelluar përgjatë zinxhirit prodhues të mbetjeve ushqimore

Bazuar në vendimin e deleguar të Komisionit të BE-së të vitit 2019⁸, sasia e mbetjeve ushqimore të gjeneruara në një vit të plotë kalendarik, do të matet çdo katër vjet për të pasur një tregues të saktë të sasive të mbetjeve ushqimore për secilën fazë të zinxhirit të furnizimit me ushqim. Studimi i thelluar do të mbulojë fazat e mëposhtme të zinxhirit të furnizimit me ushqim, për:

- prodhimin primar;
- përpunimin dhe prodhimin;
- shpërndarjen me pakicë dhe shpërndarjen tjetër të ushqimit;
- restorantet dhe shërbimet ushqimore;
- familjet.

Vlerësimi i sasive të mbetjeve ushqimore përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit me ushqim do të mbështesë politikat e parandalimit të krijimit të mbetjeve ushqimore. Bazuar në studimin e thelluar, do të zhvillohet programi kombëtar i parandalimit dhe reduktimit të humbjeve në ushqim, ku do të vendoset objektivi i matshëm i reduktimit të mbetjeve ushqimore në nivel shitjeje me pakicë dhe në nivel konsumatori, deri në vitin 2035.

⁸ Vendimi i deleguar i Komisionit (BE) 2019/1597, i 3 majit 2019, që plotëson direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me një Faqe | 8098

metodologji të përbashkët dhe kërkesat minimale të cilësisë për matjen uniforme të niveleve të mbetjeve ushqimore.

**Masa 25. Zhvillimi i Programit Kombëtar për Parandalimin dhe Reduktimin e Humbjeve nga ushqimi**

Hartimi i programit kombëtar për parandalimin dhe reduktimin e humbjeve ushqimore, do të mbulojë të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor, përfshirë prodhimin primar, përpunimin dhe prodhimin, shitjen me pakicë, si dhe shpërndarjen. Programi kombëtar i sipërpërmendur, do të zhvillohet si program ndërsektorial midis Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dokument më vete ose i integruar me Strategjinë e re për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

Masa 26. Zhvillimi i planeve vendore për parandalimin e shpërdorimit të ushqimit

Masa do të parashikojë përgatitjen dhe zbatimin e planeve vendore që synojnë parandalimin e mbetjeve ushqimore në njësitë dhe ndërmarrjet/shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, bashkiake, si dhe tregjet bashkiake ku gjenerohen mbetje ushqimore. Në zbatim të programit, të gjitha njësitë vendore që gjenerojnë mbetje ushqimore do të hartojnë plane dhe do të zbatojnë masat përkatëse.

Masa 27. Nënshkrimi i marrëveshjeve vullnetare me shërbimet e kateringut për reduktimin e mbetjeve ushqimore

Me qëllim reduktimin e mbetjeve ushqimore, si për rastin e marrëveshjeve vullnetare me bizneset për reduktimin e përdorimit të plastikës, bashkitë do të nënshkruajnë marrëveshje vullnetare me shërbimet e kateringut. Këto marrëveshje do të përdoren fillimisht për trajtimin e sfidave të reja mjedisore, derisa të hyjnë në fuqi, kërkesat ligjore të përhershme.

Gjithashtu, për të promovuar masat për parandalimin e mbetjeve, bashkitë do t'u ofrojnë hoteleve, restoranteve dhe shërbimeve të kateringut “ekoetiketa” ose “ekocertifikata”, për t'i bërë ato të dallueshme për qytetarët.

Masa 28. Promovimi i kompostimit në banesë

Kompostimi në banesë kontribon ndjeshëm në uljen e sasisë totale të mbetjeve shëtipaie, duke reduktuar peshën dhe vëllimin e mbetjeve të hedhura dhe rrjedhimisht kostot e menaxhimit të

mbetjeve bashkiake. Materiali organik i kompostuar mund të përdoret më pas në oborre, në kopshte ose për bimësinë e brendshme duke krijuar përfitime mjedisore dhe ekonomike për qytetarët.

Masa parashikon promovimin e kompostimit në banesë nga autoritetet vendore, veçanërisht për familjet që jetojnë në shtëpi private dhe në zonat rurale të vendit. Me zbatimin e PAYT-it, bashkive iu rekomandohet ofrimi i një tarife të reduktuar për familjet që bëjnë kompostim në shtëpi. Për këtë qëllim, bashkitë do të krijojnë dhe zbatojnë procedura për monitorimin e përdorimit aktual të kompostuesve familjarë.

5.3.2 Mbetjet plastike**Masa 29. Miratimi i masave rregullatore për reduktimin e plastikës njëpërdorimshme**

Qeveria do të përcaktojë kërkesa të reja për përmirësimin ligjor të ndotjes së shkaktuar nga produktet plastike njëpërdorimshme. Këto masa do të përfshijnë kufizime të qarta në tregtimin e këtyre produkteve, vendosjen e objektivave për uljen e konsumit dhe kërkesa të detyrueshme për përdorimin e modeleve të ripërdorimit dhe rimbushjes, si dhe po ashtu masa të tjera të përshtatshme për të reduktuar përdorimin e plastikës njëpërdorimshme.

Masa 30. Nënshkrimi i marrëveshjeve vullnetare me bizneset për reduktimin e plastikës njëpërdorimshme

Përgjatë viteve 2020–2024, u zbatua iniciativa “Zona pa plastikë” (*Low Plastic Zone*), e cila synonte inkurajimin e bizneseve për të reduktuar përdorimin e plastikës njëpërdorimshme, për të promovuar alternativa të ripërdorshme dhe për të mbështetur praktika të qëndrueshme⁹.

Në vijim të kësaj iniciative, bashkitë do të nënshkruajnë marrëveshje vullnetare me bizneset, me qëllim marrjen e masave konkrete për reduktimin e përdorimit të artikujve plastike (veçanërisht ata plastike njëpërdorimshme), si dhe ambalazhet plastike në shërbimet e tyre. Si alternativë, etiketimi “Zona pa plastikë” mund të vijojë të përdoret, me kusht marrjen e pëlqimit nga propozuesi fillestar i iniciativës.

⁹ Zbatuar nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*.

**Masa 31. Ndalimi i përdorimit të enëve dhe kontejnerëve plastikë njëpërdorimshme në godinat e administratës publike**

Institucionet shtetërore, organizatat publike, si dhe autoritetet vendore do të jenë liderët e zbatimit të modeleve të konsumit të qëndrueshëm, duke u bërë shembull për reduktimin e përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimshme. Në këtë kuadër ato do të ndalojnë përdorimin e këtyre produkteve plastike njëpërdorimshme në të gjitha godinat e administratës publike, brenda një periudhe kohore jo më vonë se viti 2027.

Autoritetet publike nëpërmjet masave administrative, do të kufizojnë dhe madje do të ndalojnë ku është e nevojshme, përdorimin e produkteve plastike njëpërdorimshme në godinat e administratës publike dhe atyre të ndërmarrjeve publike. Përveç kësaj do të miratojnë edhe rregulla të përgjithshme për zhvillimin e eventeve “pa plastikë” në ambientet e tyre.

Masa 32. Ndalimi i përdorimit të enëve dhe i kontejnerëve plastikë njëpërdorimshme në eventet publike

Për sa u përket eventeve publike, masa do të zbatohet fillimisht si ndalim i përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimshme, gjatë eventeve të organizuara nga autoritetet vendore. Më pas, ndalimi do të shtrihet për të gjitha eventet publike, sipas territorit të përkatësisë, ndërsa në planin afatgjatë, do të synohet vetëm përdorimi i produkteve të ripërdorshme për të gjitha eventet publike.

5.3.3 Mbetjet e ambalazhit**Masa 33. Vendosja e detyrimeve në lidhje me ambalazhin e ripërdorshëm**

Operatorët ekonomikë që reklamojnë ambalazhe të ripërdorshme në Shqipëri, do të krijojnë sisteme për lehtësimin e ripërdorimit dhe do të marrin masa për nxitjen e grumbullimit të ambalazheve të ripërdorshme.

Masa 34. Vendosja e detyrimeve në lidhje me sistemet e ripërdorimit

Operatorët ekonomikë që përdorin ambalazhe të ripërdorshme do të marrin pjesë në një ose më shumë sisteme ripërdorimi, duke u siguruar që këto sisteme, plotësojnë kriteret e specifikuar në pjesën A të shtojcës VI të rregullores (BE) 2025/40 për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve.

Masa 35. Vendosja e detyrimeve për rimbushjen e ambalazheve të ripërdorura

Operatorët ekonomikë që ofrojnë rimbushje produktesh, do të informojnë konsumatorët rreth procedurave specifike të rimbushjes, duke përfshirë llojet e kontejnerëve të lejuar, standardet e higjienës që duhen zbatuar, si dhe përgjegjësinë e përdoruesit përfundimtar mbi shëndetin dhe sigurinë gjatë përdorimit të kontejnerëve që rimbushen.

Operatorët do të sigurohen që ambalazhet dhe enët e disponueshme në stacionet e rimbushjes, të jepen falas, vetëm nëse plotësojnë kërkesa të caktuara ose janë pjesë e një skeme depozitim-kthimi. Operatorët nuk do të mbajnë përgjegjësi për problemet e higjienës ose të sigurisë ushqimore që mund të lindin nga përdorimi i enëve të furnizuara nga përdoruesi përfundimtar. Në rastin e distributorëve me sipërfaqe shitjeje mbi 400 m², do të bëhen përpjekje për të dedikuar të paktën 10% të hapësirës së disponueshme për stacione të rimbushjes, për produkte ushqimore dhe joushqimore.

Masa 36. Vendosja e detyrimeve për rimbushjen e ambalazheve të ripërdorura në sektorin e ushqimit që merret me vete (*take-away*)

Shitësit me pakicë që operojnë brenda sektorit HoReCa në Shqipëri, të cilët ofrojnë pije të nxehta ose të ftohta dhe/ose ushqime të gatshme dhe të ambalazuara për t'u marrë me vete, do të krijojnë sisteme që lejojnë konsumatorët të sjellin enët e tyre për rimbushje. Në rastin kur klientët sjellin mbrapsht enët e tyre, shitësit me pakicë do t'i shesin produktet e tyre me të njëjtin çmim dhe në kushte po aq të favorshme sa ato për të njëjtin produkt me ambalazh njëpërdorimshme. Ata do të informojnë klientët në pikat e shitjes, lidhur me disponueshmërinë e produkteve me enë që rimbushen të sjella nga konsumatori, duke përdorur shenja ose njoftime të qarta dhe lehtësisht të lexueshme.

Masa 37. Vendosja e opsionit të ofertës së ripërdorimit për sektorin e ushqimit që ambalazhohet me vete (*take-away*)

Shitësit me pakicë që operojnë brenda sektorit HoReCa dhe që ofrojnë pije të nxehta, të ftohta ose ushqime të gatshme dhe të ambalazuara për t'u marrë me vete, do t'u ofrojnë klientëve mundësinë e zgjedhjes së produkteve të ambalazuara në enë të ripërdorshme, përmes një sistemi të dedikuar ripërdorimi. Shitësit me pakicë do të afishojnë



njoftime me shenja të qarta dhe lehtësisht të lexueshme në pikat e shitjes, me qëllim informimin e klientëve rreth disponueshmërisë së produkteve në ambalazhe të ripërdorshme. Gjithashtu, ata do të jenë të detyruar të shesin të paktën 10% të produkteve në formate ambalazhi të ripërdorshme, ndërsa produktet e shitura në enë të ripërdorshme do të ofrohen me të njëjtin çmim, si dhe në kushte të krahasueshme me ato në ambalazhe njëpërdorimshme.

5.3.4 Mbetjet nga ndërtimi dhe shembja

Masa 38. Vendosja e objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim të materialeve të tjera për mbetjet jo të rrezikshme nga ndërtimi dhe shembja

Përcaktimi i objektivave për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklim të mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja (MNS), është hap thelbësor për rritjen dhe nxitjen e përdorimit të tyre të qëndrueshëm. Në përputhje me dispozitat e DKM-së, do të merren masa parandaluese për depozitimin e MNS në landfille. Objektivat për përgatitjen, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e materialeve të tjera të MNS-së jo të rrezikshme, do të transpozohen nëpërmjet aktit nënligjor përkatës mbi menaxhimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja, deri në fund të vitit 2026. Këta objektiva do të zbatohen edhe për objektet e veçanta të ndërtimit dhe shembjes, ndërsa realizimi i tyre do të monitorohet në nivel bashkiak dhe kombëtar.

Masa 39. Vendosja e standardeve të cilësisë për materialet e ndërtimit të ripërdorshme dhe të riciklueshme

Ministria e Mjedisit do të kërkojë hartimin e standardeve të cilësisë për MNS-të e ricikluara nga mbetjet e ndërtimit dhe shembjes brenda një afati të mesëm kohor. Qëllimi është të sigurohet që materialet e ricikluara të jenë të qëndrueshme, të sigurt dhe konkurruese në treg, duke nxitur përdorimin e tyre në sektorin e ndërtimit. Standardet e cilësisë për materialet e ndërtimit të ricikluara do të jenë pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave mbi menaxhimin e MNS-ve.

Masa 40. Vendosja e kërkesave për shembjen selektive (pjesore) në vendet e ndërtimit

Shembja selektive është metoda e çmontimit të një ndërtese, duke i hequr pjesë të ndryshme dhe ruajtur të tjerat, ndryshe nga shembja tradicionale, e cila zakonisht përfshin shembjen e plotë. Shembja selektive gëzon përfitime mjedisore dhe ekonomike

dhe përfshin rikuperimin e materialeve ndërtimore, reduktimin e mbetjeve, si dhe zvogëlimin e gjurmës së karbonit. Ripërdorimi i materialit, si dhe riciklimi si opsion i dytë, konsumon më pak energji dhe rrit jetëgjatësinë e materialit.

Qeveria do të hartojë kuadrin ligjor për shembjen selektive të ndërtimeve me qëllim largimin dhe trajtimin e sigurt të substancave të rrezikshme, si dhe lehtësimin e ripërdorimit dhe riciklimit me cilësi të lartë, nëpërmjet zhvendosjes selektive të materialeve. Kjo masë do të jetë në përputhje me politikat e reja qeveritare mbi ekonominë qarkulluese dhe efikasitetin e burimeve, ku materialet nga sektori i ndërtimit mbeten në qarkullim.

Masa 41. Vendosja e kërkesave për zhvillimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve në projektet dhe lejet e reja të ndërtimit

Në projektet dhe lejet e ndërtimit, me sipërfaqe mbi 500 m² do të zbatohen kërkesat për zhvillimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve. Përfshirja e planit të posaçëm për menaxhimin e MNS-ve, do të bëhet pjesë e procedurës për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe do të kontrollohet e zbatohet nga autoritetet vendore. Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi menaxhimin e MNS-ve do të rishikohet duke përfshirë kërkesat për menaxhimin e MNS-ve.

Masa 42. Përfshirja e kërkesave për përdorimin e materialeve të ndërtimit të ripërdorura dhe të ricikluara në prokurimin publik të projekteve të mëdha infrastrukturore

Në prokurimin publik të projekteve të mëdha infrastrukturore si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave për menaxhimin e MNS-ve, deri në fund të vitit 2026, do të përfshihen në aktet nënligjore të Ministrisë së Mjedisit, ku të referohet ligji i prokurimit publik, kërkesat për përdorimin e materialeve të ndërtimit të ricikluara MNS.

5.4 Masat horizontale

Qytetarët duhet të jenë të mirinformuar dhe të pajisur me njohuritë dhe mjetet e duhura, për ndryshimin e sjelljeve, si dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që gjenerojnë. Më poshtë jepet përshkrimi i tri masave horizontale, ku do të mbështetet zbatimi i masave prioritare sipas rëndësisë.

Masa 43. Zhvillimi i fushatave informuese

Ndërgjegjësimi dhe angazhimi i qytetarëve është një nga parakushtet kryesore për parandalimin efektiv të mbetjeve. Rrënjësia e sjelljeve të konsumit të qëndrueshëm, ripërdorimit, si dhe reduktimit të mbetjeve nga ndërtimi, realizohet përmes masave



sistematike edukative dhe informuese, të zbatuara në nivel lokal dhe kombëtar. Autoritetet vendore do të luajnë një rol kyç në zbatimin e fushatave informative dhe edukative, përmes zhvillimit dhe zbatimit të strategjive vendore të komunikimit për menaxhimin e mbetjeve, si dhe partneriteteve me OJQ-të, shkollat dhe mediat lokale.

Fushatat edukative dhe informuese do të synojnë të:

- Informojnë publikun rreth sistemit të ri të tarifimit të mbetjeve (PAYT), të faturimit, si dhe të avantazheve të ndarjes së mbetjeve në banesa etj.;

- Krijojnë motivim për rritjen e pjesëmarrjes në grumbullimin e diferencuar, kompostimin, ripërdorimin dhe riparimin;

- Prezantojnë alternativa konkrete dhe praktika të mira për reduktimin e mbetjeve në jetën e përditshme;

- Promovojnë sjellje të përgjegjshme, duke stimuluar konsumatorët për të zgjedhur produkte të qëndrueshme, jetëgjatë dhe me pak ambalazhime.

Masat e sipërpërmendura do të synojnë mbështetjen e të gjitha iniciativave bashkiake, në kuadër të parandalimit të krijimit të mbetjeve. Fushatat fillimisht do t'iu adresohen grupeve të caktuara, dhe në rastet për publikun e gjerë do të marrin formën e:

- Fushatave masive të informimit përmes mediave, rrjeteve sociale dhe posterave;

- Organizimeve të eventeve komunitare “fundjava të gjelbra”, fushata shkëmbimi etj.;

- Krijimit të platformave dhe aplikacioneve *online* për reduktimin e mbetjeve ushqimore, dhurimin e artikujve, riparimin etj.;

- Shpërndarjes në rrjet të udhëzuesve dhe broshurave mbi kompostimin në banesa, video me këshilla praktike etj.

Masat për parandalimin e mbetjeve dhe planet vendore për menaxhimin e mbetjeve, në tërësi do të mbështeten nga planet bashkiake të komunikimit. Këto plane do të përfshijnë:

- Grupet e targetuara;
- Mesazhet kryesore për grupet e targetuara;
- Strategjinë dhe kanalet e komunikimit;
- Buxhetin dhe burimet.

Ministria e Mjedisit do të mbështesë bashkitë nëpërmjet zhvillimit të fushatave kombëtare të informimit dhe ndërgjegjësimin, mbi futjen e sistemit PAYT, si dhe rëndësinë e parandalimit të mbetjeve

ushqimore në familje. Ky i fundit do të përfshijë masa të tilla si:

- Fushata kombëtare që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin dhe edukimit të familjeve mbi temën e parandalimit të shpërdorimit të ushqimit; dhe

- Fushata kombëtare që synojnë edukimin e qytetarëve mbi mënyrën e leximit të etiketës shoqëruese të produkteve, si dhe kuptimit të termave “të përdoret para datës” dhe “data e skadencës”.

Masa 44. Zhvillimi i faqes së posaçme në rrjet për parandalimin e krijimit të mbetjeve, në web-in zyrtar *online* të ekonomisë qarkulluese në vend/MM-së

Në faqen *web* zyrtare të Ministrisë së Mjedisit do të krijohet një seksion i posaçëm interneti, kushtuar parandalimit të krijimit të mbetjeve, roli i së cilës është edukimi, angazhimi, si dhe koordinimi i përpjekjeve të të gjithë sektorëve, për një shoqëri më të qëndrueshme dhe përdorim efikas të burimeve. Ky seksion do të shërbejë si një *hub* qendror për përditësimin e politikave, rregulloreve dhe iniciativave të parandalimit të krijimit të mbetjeve. Gjithashtu, në faqen e internetit do të ofrohen udhëzime si dhe burime për zbatimin e masave të reduktimit të mbetjeve.

Masa 45. Përdorimi i aplikacioneve të telefonisë dhe i platformave *online* për iniciativat e parandalimit të krijimit të mbetjeve

Aplikacionet e telefonisë janë një mjet i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimin dhe stimulimin e sjelljes së qëndrueshme. Bashkitë do të ndërtojnë dhe përdorin platforma dhe aplikacione të telefonisë, për të mbështetur iniciativat dhe shërbimet e parandalimit të krijimit të mbetjeve. Platformat *online* dhe aplikacionet e telefonisë do të përdoren për të informuar qytetarët, në lidhje me:

- Vendet e ofrimit të shërbimeve të riparimit dhe huazimit të artikujve;

- Shitjen e mobilie dhe rrobave të përdorura;

- Vendet ku të ofrojnë dhe/ose kërkojnë artikuj për dhurim ose shkëmbim;

- Konsultimin dhe shkëmbimin e përvojave për kompostimin në banesë;

- Këshilla dhe sugjerime mbi parandalimin e mbetjeve (p.sh. receta kulinare me ushqimet e mbetura, ide për riciklim ose ripërdorim, iniciativa që lidhen me “zero mbetje”, fushata etj.).



Platformat *online* do të bëhen pjesë e strategjisë/ planeve bashkiake të komunikimit, në lidhje me iniciativat për parandalimin e mbetjeve.

Shtojca e Programit, përmban masat e parandalimit të krijimit të mbetjeve, si dhe afatet e zbatimit të tyre afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe të ndikimit të pritshëm të tyre në parandalimin e mbetjeve.

Masa 46. Hartimi i një plani monitorimi për ndjekjen e progresit të zbatimit të PKPM-së

Kjo masë synon hartimin dhe zbatimin e një plani të strukturuar monitorimi, me qëllim ndjekjen sistematike të progresit të zbatimit të Planit Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve (PKPM). Plani i monitorimit do të përcaktojë tregues të matshëm performance, burimet e të dhënave, institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat e raportimit periodik, duke mundësuar vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe

identifikimin në kohë të nevojave për ndërhyrje korrigjuese. Kjo qasje do të kontribuojë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e zbatimit të politikave të parandalimit të krijimit të mbetjeve, në përputhje me praktikat e BE-së.

6. Treguesit e arritjeve

PKPM do të ofrojë tregues të rezultateve dhe masave të identifikuara. PKPM-ja përfshin tri lloje treguesish:

- Treguesit e gjenerimit të mbetjeve, të cilët janë sasiore dhe lidhen drejtpërdrejt me matjen e gjenerimit të mbetjeve;

- Treguesit e ripërdorimit, të cilët janë, gjithashtu, sasiore dhe lidhen drejtpërdrejt me matjen e gjenerimit të mbetjeve;

- Treguesit e performancës, të cilët monitorojnë zbatimin e veprimeve të identifikuara.

Tabela më poshtë paraqet treguesit kryesorë të gjenerimit të mbetjeve dhe të ripërdorimit.

Tabela 3. Treguesit e gjenerimit të mbetjeve

Zona e ndërhyrjes	Treguesi	Detajet
Sasia e mbetjeve bashkiake të përziera në vit	Reduktohet me 5% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin 2023	Në vitin 2023, sasitë totale të mbetjeve bashkiake ishin 844,157 tonë, ose 353 kg/person; Në vitin 2030, sasitë duhet të reduktohen në 801,949 tonë, ose 335 kg/person.
Sasia e mbetjeve ushqimore të reduktuara në fazën e përpunimit dhe prodhimit	Reduktohet me 10% deri në vitin 2035 krahasuar me vitin 2026	Studimi i thelluar mbi mbetjet ushqimore do të përcaktojë sasitë e mbetjeve ushqimore nga përpunimi dhe prodhimi, të cilat përcaktojnë treguesin e synuar të reduktimit në vitin 2035.
Sasia e mbetjeve ushqimore të reduktuara nga familjet dhe të shitjes me pakicë (përfshirë restorantet dhe shërbimet ushqimore)	Reduktohet me 30% deri në vitin 2035 krahasuar me vitin 2026	Studimi i thelluar mbi mbetjet ushqimore do të përcaktojë sasitë e mbetjeve ushqimore nga familjet dhe të shitjes me pakicë, të cilat përcaktojnë treguesin e synuar të reduktimit në vitin 2035.
Parandalimi i krijimit të mbetjeve të ambalazhit	5% deri në vitin 2030, 10% deri në vitin 2035	Krahasuar me sasitë e përcaktuara në vitin 2018.
Promovimi i ripërdorimit dhe riparimit	Ton mbetjesh të parandaluara përmes përgatitjes për ripërdorim	Sasia e produkteve të ripërdorshme të mbledhura në vit përmes përgatitjes për ripërdorim nga mbetjet e hedhura.
	Ton mbetjesh të parandaluara përmes ripërdorimit	Sasia e produkteve të ripërdorura të shitura çdo vit.



Plani i veprimit përmban të gjithë treguesit e performancës që monitorojnë zbatimin e masave të identifikuara për reduktimin e mbetjeve në nivel konsumatori, në nivel institucional dhe biznesi.

Bazuar në masat e parandalimit të krijimit të mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja, në planin afatmesëm është i pritshëm reduktimi i sasive të gjeneruara, si dhe përmirësimi i cilësisë së mbetjeve të ndërtimit dhe shembjes.

Masat që lidhen me parandalimin e mbetjeve në sektorin e prodhimit dhe të industrisë, do të synojnë optimizimin e proceseve operative, uljen e sasive të mbetjeve, si dhe përmirësimin e tregut me produkte rezistente në kohë, të riparueshme dhe të ripërdorshme.

7. Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i Programit

7.1 Objektivat dhe qëllimi i monitorimit

Monitorimi i zbatimit të PKPM-së është thelbësor në arritjen e objektivave të parandalimit të krijimit të mbetjeve, gjurmimin sistematik të progresit, si dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese. Nëpërmjet monitorimit autoritetet përgjegjëse do të vlerësojnë, jo vetëm zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, por edhe nëse ato po kontribuojnë në mënyrë efektive në reduktimin e mbetjeve. Monitorimi do të mbështetet në transparencën, llogaridhënien, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ekzekutimit të politikave dhe të performancës mjedisore.

Objektivat e monitorimit janë sa vijon:

- Gjurmimi i ecurinë së zbatimit të masave të PKPM-së;
- Vlerësimi i efektivitetit të masave për parandalimin e mbetjeve;
- Sigurimi i përputhshmërisë me direktivat e BE-së dhe angazhimet e Shqipërisë, në kuadër të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor;
- Raportimi i përditësuar dhe përshtatja e Programit gjatë zbatimit.

7.2 Metodologjia e monitorimit

MM-ja do të koordinojë aktivitetet e monitorimit, të mbështetura nga AKEM-ja dhe AKM-ja. Të dhënat e monitorimit të mbledhura rregullisht, do të rishikohen çdo gjashtë muaj dhe do të raportohen publikisht çdo 2 vjet përmes Raportit të Zbatimit të PKPM-së.

Monitorimi do të kryhet në dy nivele: monitorimi i procesit dhe monitorimi i performancës (ndikimit).

- Monitorimi i Procesit do të fokusohet në zbatimin e planit të veprimeve dhe ndërhyrjeve të listuara në PKPM (d.m.th., afatet kohore, institucionet përgjegjëse, rezultatet e arritura), ndërsa Plani përdor të dhëna administrative, raporte të zbatimit dhe rezultate nga takimet koordinuese. (Ministria e Mjedisit ka rolin kryesor dhe do të mbështetet nga AKEM-ja dhe AKM-ja).

- Monitorimi i Performancës do të gjurmojë rezultatet e ndërhyrjeve për reduktimin e mbetjeve, si dhe ndryshimet cilësore në sjelljet e konsumit dhe prodhimit. Ai mbështetet në statistikat kombëtare (p.sh. INSTAT), të dhënat e mbetjeve bashkiake, raportimin e industrisë dhe, kur është e nevojshme, Eurostatin ose nivelet rajonale. AKEM-ja do të udhëheqë procesin, duke u mbështetur nga autoritetet vendore, INSTATin dhe AKM-n.

Treguesit do të koordinohen me objektivat strategjikë dhe operacionalë të PKPM-së dhe do të zbatohen kriteret SMART (specifik, i matshëm, i arritshëm, relevant, i kufizuar në kohë). Situata faktike, si dhe objektivat përkatës do të përcaktohen për çdo masë.

7.3 Monitorimi i progresit dhe përshtatja e menaxhimit

Progresi i PKPM-së do të ndiqet përmes kombinimit të treguesve sasiore dhe cilësorë të përshtatur për të kuptuar, si dinamikën e zbatimit, ashtu edhe ndikimet aktuale në parandalimin e mbetjeve.

Mënyrat e monitorimit të progresit përfshijnë:

i. Raportimin: institucionet përgjegjëse raportojnë çdo vit progresin respektiv të aktiviteteve (të përfunduara, në vazhdim, të vonuara), burimet e përdorura, si dhe pengesat e hasura gjatë zbatimit.

ii. Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI): treguesit e listuar për secilën masë (seksionet 6 dhe do të përdoren për të matur rezultatet dhe monitorimin e trendeve në kohë, si reduktimi i mbetjeve, sipas rrymave specifike, apo rritja e praktikave të ripërdorimit.

iii. Të dhënat statistikore kombëtare: statistikat vjetore mjedisore të INSTAT-it, të dhënat e mbetjeve bashkiake, si dhe anketimet e ndryshme do të jenë burimet e të dhënave për vlerësimin e tendencave në krijimin dhe trajtimin e mbetjeve.



iv. Një mjet monitorimi për ndjekjen e progreszbatimit të PKPM-së. Ky mjet mund të përshtatet, gjithashtu, në kuadrin e monitorimit të progresit të Strategjisë Kombëtare.

7.4 Baza e përshtatjes së programit

PKPM-ja është një dokument dinamik që kërkon përshtatje në varësi të sfidave, mundësive ose gjetjeve të të dhënave sipas rastit. Rezultatet e monitorimit do të shërbejnë si bazë provash, për:

- Identifikimin e masave që nuk kanë performancë të pëlqyeshme, si dhe përshtatjen e objektivave, afateve kohore ose mekanizmave të zbatimit;

- Rritjen e ndërhyrjeve efektive që japin rezultate të matshme dhe mbështesin palët e interesuara;

- Vendosjen e masave të reja ose testimin e mjeteve të inovacionit (p.sh., mjete digjitale, skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit) bazuar në ndryshimin e trendeve të konsumit ose sasisë së mbetjeve;

- Përputhjen me kërkesat e BE-së, veçanërisht me përditësimet e Direktivës Kuadër për Mbetjet ose të Planit të Veprimit për Ekonominë Qarkulluese;

Sigurimin e fondeve, me qëllim përdorimin e raporteve të progresit në aplikimet për mbështetje nga BE-ja ose donatorët.

7.5 Mbikëqyrja dhe procedurat inspektuese për zbatimin e Programit

Zbatimi i masave të parashikuara në Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve mbikëqyret përmes mekanizmave institucionalë të monitorimit dhe procedurave inspektuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar për inspektimin dhe menaxhimin e mbetjeve. Përfshirja e procedurave inspektuese, në kuadër të këtij programi, synon të sigurojë kontrollin sistematik të zbatimit të masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve, verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe identifikimin e mangësive në zbatimin e politikave dhe instrumenteve të parashikuara në program. Ky mekanizëm është në përputhje me kërkesat e Directive 2008/98/EC on Waste (*Waste Framework Directive*), veçanërisht me dispozitat e neneve 34 dhe 36 të kësaj direktive, të cilat kërkojnë nga autoritetet kompetente, të sigurojnë monitorimin dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për mbetjet, përmes mekanizmave të kontrollit

dhe inspektimit, si dhe të kryejnë inspektime periodike për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore dhe zbatimin e masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve.

Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Programit ushtrojnë funksionet e tyre edhe përmes mekanizmave ekzistues të inspektimit në fushën e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Veprimtaritë inspektuese realizohen nga strukturat kompetente të inspektimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe institucione të tjera, sipas përcaktimeve ligjore.

Planifikimi i inspektimeve zhvillohet në kuadër të programeve vjetore të inspektimit, të bazuara në analizën e riskut dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës për inspektimin dhe menaxhimin e mbetjeve. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë u kushtohet subjekteve që gjenerojnë sasi të konsiderueshme mbetjesh, si dhe sektorëve ekonomikë me ndikim të lartë në krijimin e mbetjeve, përfshirë sektorin e ndërtimit, ambalazhet dhe plastikën, si dhe industrinë ushqimore. Inspektimet synojnë, gjithashtu, verifikimin e zbatimit të masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve të parashikuara në këtë Program.

Objekti i kontrollit në kuadër të procedurave inspektuese lidhet, në veçanti, me zbatimin e masave për reduktimin e krijimit të mbetjeve në burim, respektimin e kërkesave për ripërdorim dhe riparim të produkteve, reduktimin e përdorimit të ambalazheve dhe promovimin e alternativave të qëndrueshme, minimizimin e mbetjeve ushqimore, zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, si dhe raportimin dhe saktësinë e të dhënave mbi mbetjet dhe masat parandaluese.

Kontrollet inspektuese mund të përfshijnë inspektime në terren në subjektet ekonomike dhe institucionet publike, verifikimin e dokumentacionit dhe të praktikave të menaxhimit të mbetjeve, kontrollin e raportimeve dhe të dhënave të deklaruara nga subjektet, si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet sistemit të inspektimit dhe sistemit kombëtar të monitorimit të mbetjeve.



Rezultatet e inspektimeve shërbejnë për të mbështetur procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Programit, për të identifikuar mangësitë në zbatimin e masave dhe për të orientuar përmirësimin e politikave dhe instrumenteve për

parandalimin e krijimit të mbetjeve. Në rast të konstatimit të shkeljeve të kërkesave ligjore, ose të moszbatimit të masave të parashikuara në Program, strukturat kompetente ndërmarrin masat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

SHTOJCA

LISTA E MASAVE DHE NDIKIMI I TYRE NË PARANDALIMIN E KRIJIMIT TË MBETJEVE

Tabela 4. Lista e masave dhe ndikimi i tyre në parandalimin e krijimit të mbetjeve

Masë	Ndikimi i pritur në parandalimin e krijimit të mbetjeve	Instrumenti	Rryma e mbetjeve me prioritet
Veprime afatshkurtra (deri 24 muaj)			
Veprimi 5. Zhvillimi i modeleve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bazuar në tipologjitë e ndryshme ndërtimore dhe softuerëve për llogaritjen e tarifave	I lartë (pararendës i miratimit të PAYT)	Teknike	Të gjitha rrymat e mbetjeve bashkiake
Veprimi 16. Përcaktimi i ndalimeve ligjore mbi përdorimin e praktikave të vjetrit të planifikuar	I lartë (parandalon krijimin e mbetjeve)	Rregullator	Kryesisht PEEE, tekstile
Veprimi 17. Miratimi i ndalimit ligjor për asgjësimin e mallrave stok/të pashitura	I lartë (parandalon mbetjet nga mbiprodhimi)	Rregullator	Tekstile, lëkurë dhe goma
Veprimi 18. Prezantimi i detyrimeve të “së drejtës për riparim”	Mesatare (zgjat jetëgjatësinë e produktit)	Rregullator	PEEE, bateri
Veprimi 25. Kryerja e studimit të thelluar përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit të mbetjeve ushqimore	Mesatare (në përputhje me objektivat e BE-së)	Teknike	Mbetjet e ushqimit
Veprimi 31. Miratimi i politikave për reduktimin e plastikës njëpërdorimshme	Mesatare (redukon ndotjen dhe mbetjet plastike)	Politika	Plastika
Veprimi 40. Vendosja e objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim të materialeve të tjera për mbetjet jo të rrezikshme, nga ndërtimi dhe shembja	I lartë (redukon nxjerrjen e materialeve fillestare)	Politika dhe rregullore	MNS
Veprimi 41. Vendosja e standardeve të cilësisë për materialet ndërtimit të ripërdorshme dhe të riciklueshme	I lartë (redukon nxjerrjen e materialeve fillestare)	Politika	MNS
Veprimi 42. Vendosja e kërkesave për shembje selektive/pjesore në vendet e ndërtimit	I lartë (redukon nxjerrjen e materialeve fillestare)	Rregullator	MNS
Veprimi 43. Prezantimi i kërkesave për zhvillimin e planeve të menaxhimit të mbetjeve në projektet dhe lejet e reja të ndërtimit	I lartë (redukon nxjerrjen e materialeve fillestare)	Rregullator	MNS
Veprimi 48. Zhvillimi i mjetit monitorues për ndjekjen e progresit të zbatimit të PKPM-së	I ulët (mjet planifikimi dhe monitorimi)	Monitorimi dhe raportimi	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 1. Hartimi i Planeve Zonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve me grup-masa për parandalimin e mbetjeve	I lartë (përfshirë masa parandaluese që mbulojnë të gjitha rrymat e mbetjeve)	Politika	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 3. Hartimi dhe publikimi i Udhëzuesve Praktikë për përfshirjen e kriterëve të gjelbra në prokurimin publik	I lartë (nxit kërkesën e tregut për produkte të qëndrueshme)	Teknike	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 6. Zbatimi i parimit “Paguaj sipas hedhjes”	I lartë (nxit reduktimin e burimit)	Rregullator	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 9. Mbështetja me fonde publike për nismat e parandalimit të krijimit të mbetjeve	I lartë (financimi i një shumëllojshmërie iniciativash)	Rregullator/ekonomik	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 10. Përfshirja në lejet mjedisore e reduktimit të krijimit të mbetjeve në ndërmarrjet e mëdha industriale	I lartë (parandalon mbetjet nga mbiprodhimi)	Rregullator	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 14. Rritja e pragjeve të konformitetit për mallrat jashtë BE-së	I lartë (parandalon mbetjet nga prodhimi i paqëndrueshëm)	Ekonomik	PEEE, plastikë
Veprimi 22. Zbatimi i sistemeve/strukturave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të vëllimshme me qëllim ripërdorimin	Mesatare (zgjat jetëgjatësinë e produktit)	Politika	Mbetje të mëdha
Veprimi 26. Zhvillimi i një programi kombëtar për parandalimin dhe reduktimin e humbjeve nga ushqimi	I lartë (thelbësor për vendosjen e objektivit)	Politika	Mbetjet e ushqimit
Veprimi 28. Nxitja e dhurimit të ushqimit përmes krijimit të kushteve të përshatshme institucionale dhe procedurale	Mesatare (në përputhje me objektivat e BE-së)	Rregullator	Mbetjet e ushqimit
Veprimi 33. Ndalimi i përdorimit të enëve dhe kontejnerëve plastikë njëpërdorimshme në ndërësat e administratës publike	I ulët (redukon ndotjen dhe mbetjet plastike)	Rregullator	Plastika
Veprimi 34. Ndalimi i përdorimit të enëve dhe kontejnerëve plastikë njëpërdorimshme në eventet publike	I ulët (redukon ndotjen dhe mbetjet plastike)	Rregullator	Plastika
Veprimi 35. Vendosja e detyrimeve për ambalazhet e ripërdorshme	I lartë (i lidhur me arritjen e objektivit)	Rregullator	Plastikë, karton, qelq
Veprimi 36. Vendosja e detyrimeve për sistemet e ripërdorimit	I lartë (i lidhur me arritjen e objektivit)	Rregullator	Plastikë, karton, qelq



Veprimi 37. Vendorsja e detyrimeve për rimbushjen e ambalazheve të përdorura	I lartë (i lidhur me arritjen e objektivit)	Rregullator	Plastikë, karton, qelq
Veprimi 38. Vendorsja e detyrimit për rimbushjen e ambalazheve të përdorura për sektorin e ushqimit që merret me vete	I lartë (i lidhur me arritjen e objektivit)	Rregullator	Plastikë, karton, qelq
Veprimi 39. Vendorsja e opsioneve të ofertës së e ripërdorimit për sektorin e ushqimit që merret me vete	I lartë (i lidhur me arritjen e objektivit)	Rregullator	Plastikë, karton, qelq
Veprimi 46. Zhvillimi i faqes digjitale në rrjet mbi parandalimin e mbetjeve në sitin zyrtar të internetit të MM-së	I ulët (efekt indirekt nëpërmjet ndryshimit të sjelljes)	Informuese dhe edukative	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprime afatmesme (25–48 muaj)			
Veprimi 8. Krijimi i skemës së PZP për tekstilet	I lartë (duke nxitur riciklimin/parandalimin)	Ekonomik	Mbetjet e tekstilit
Veprimi 11. Analiza e simbiozës industriale dhe identifikimi i sektorëve kryesorë të prodhimit	I lartë (parandalon mbetjet nga simbioza industriale)	Ekonomik	Sektorët industrialë të identifikuar
Veprimi 12. Forcimi i mekanizmit monitorues dhe zbatues të planeve të reduktimit të mbetjeve	I lartë (parandalon mbetjet nga mbiprodhimi)	Politika dhe rregullore	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 24. Kufizimi i reklamave dhe postës pa adresë	Mesatare (redukon ndjeshëm mbetjet e letrës)	Rregullator	Mbetjet e letrës
Veprime afatgjata (vitet 2030–2035)			
Veprimi 2. Hartimi dhe pajisja e Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve me grup-masa për parandalimin e mbetjeve	I lartë (përfshirë masa parandaluese që mbulojnë të gjitha rrymat e mbetjeve)	Politika	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 4. Përfshirja e “kriterëve të gjelbra” në prokurimin publik, me qëllim ndikimin sistematik në parandalimin e krijimit të mbetjeve.	I lartë (nxit kërkesën e tregut për produkte të qëndrueshme)	Rregullator	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 7. Vendorsja e modulimit të tarifave/taksave të PZP-së	I lartë (duke nxitur riciklimin/parandalimin)	Ekonomik	Plastika, PEEE, bateritë
Veprimi 13. Promovimi i teknologjive me efikasitet të lartë të burimeve në industrinë përpunuese, duke i dhënë përparësi ushqimit, tekstileve dhe prodhimit të produkteve plastike	I lartë (parandalon mbetjet nga mbiprodhimi)	Ekonomik	Mbetjet e ushqimit, tekstileve, plastikës
Veprimi 44. Vendorsja e kërkesave për përdorimin e materialeve të ndërtimit të ricikluara në prokurimin publik të projekteve të mëdha infrastrukturore	I lartë (redukon nxjerrjen e materialeve fillestare)	Rregullator	MNS
Veprime të vazhdueshme			
Veprimi 19. Ngritja e qendrave të riparimit dhe ripërdorimit	Mesatare (zgjat jetëgjatësinë e produktit)	Bazuar në treg	Lëkurë, goma, e rëndë, PEEE, metal
Veprimi 20. Ngritja e qendrave publike për huazimin dhe shkëmbimin e mallrave të përdorura	Mesatare (zgjat jetëgjatësinë e produktit)	Bazuar në treg	Lëkurë, gomë, të rënda, PEEE, tekstile
Veprimi 21. Promovimi i krijimit të qendrave të huazimit dhe shkëmbimit të përdorura midis njerëzve.	Mesatare (zgjat jetëgjatësinë e produktit)	Bazuar në treg	Metal, plastikë
Veprimi 23. Ndërtimi i çezmave me ujë të pijshëm në hapësirat publike.	Mesatare (redukon përdorimin e shisheve PET)	Bazuar në treg	Mbetjet plastike
Veprimi 29. Nënshkrimi i marrëveshjeve vullnetare me institucionet e shërbimit të ushqimit për reduktimin e mbetjeve ushqimore.	Mesatare (në përputhje me objektivat e BE-së)	Vullnetar	Mbetjet e ushqimit
Veprimi 30. Promovimi i kompostimit në banesë.	I lartë	Politika	Ushqimi dhe mbetjet e gjelbra
Veprimi 32. Nënshkrimi i marrëveshjeve vullnetare me bizneset për reduktimin e përdorimit të plastikës.	I ulët (mekanizëm vullnetar)	Vullnetar	Mbetjet plastike
Veprimi 45. Zhvillimi i fushatave informuese.	I ulët (efekt indirekt nëpërmjet ndryshimit të sjelljes)	Informuese dhe edukative	Të gjitha rrymat e mbetjeve
Veprimi 46 dhe 47. Ngritja e faqes digjitale për parandalimin e mbetjeve në faqen <i>web</i> zyrtar të internetit të MM-së. Zhvillimi i aplikacioneve të telefonisë dhe të platformave <i>online</i> për iniciativat e parandalimit të krijimit të mbetjeve.	I ulët (promovon nisma të tjera parandaluese)	Informuese dhe edukative	Të gjitha rrymat e mbetjeve

[illegible]

[illegible]

**UDHËZIM****Nr. 1, datë 10.4.2026****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN NR. 3606/2, DATË
28.10.2011, “PËR PAJISJEN E
DREJTUESVE TË MJETEVE RRUGORE
TË KATEGORIVE C1, C, C1E, D1, D, D1E
DHE DE, ME CERTIFIKATËN E
AFTËSISË PROFESIONALE (CAP)”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; pikave 8 dhe 9, të nenit 115, dhe të nenit 224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të neneve 294, 295, 296 dhe 297 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

I. Në udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011, “Për pajisjen e drejtuesve të mjeteve rrugore të kategorive C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në fund të nenit 2, shtohet fjalia, si më poshtë: ““Kodi 95”, siç përcaktohet në nenin 292 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shënohet në lejen e drejtimit ose në CAP.”.

2. Neni 8, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. DPSHTRR, përmes strukturave të saj, verifikon nëse autoshkollat plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale sipas licencës dhe, nëse po, i pajis me vendim miratues. Autoshkollat që nuk i plotësojnë këto kriteret nuk regjistrohen në sistemin e DPSHTRR së.

2. DPSHTRR-ja, nëpërmjet strukturave të saj, ushtron kontrolle të vazhdueshme në autoshkollat e licencuara. Kontrollat kryhen në drejtim të plotësimit të bazës së nevojshme mësimore, didaktike, personelit, mjeteve dhe kërkesave të tjera, që përcakton ky udhëzim. Kontrollat ushtrohen në mënyrë periodike çdo vit, si dhe në të gjitha rastet

kur ka dyshime të arsyeshme se autoshkolla nuk plotëson një apo më shumë kërkesa të këtij udhëzimi. Kur strukturat e DPSHTRR-së konstatojnë se gjatë zhvillimit të aktivitetit autoshkolla nuk plotëson një apo më shumë kërkesa të këtij udhëzimi merr masa në përputhje me nenin 121 të ligjit nr. 8378, datë 22.9.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

3. Në shkronjën “b” të nenit 9, fjala “vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “vitet e fundit për kategorinë respektive të lejedrejtimit”.

4. Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kualifikimi dhe trajnimi periodik, realizohet nëpërmjet një programi mësimor, që aplikohet në kurset e trajnimit përkatës në përputhje me shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Kualifikimi fillestar përbëhet nga 60 orë teori, të cilat kryhen në jo më pak se 15 ditë dhe 10 orë praktikë, të cilat kryhen në jo më pak se 5 ditë.

3. Trajnimi periodik përbëhet nga 35 orë teori në jo më pak se 7 ditë.”.

5. Neni 13 ndryshon si më poshtë:

“1. Kandidatët që pajisen për herë të parë me CAP ndjekin kursin e kualifikimit fillestar dhe i nënshtrohen testimit teorik dhe praktik.

2. Kandidatët që rinovojnë CAP ndjekin trajnimin periodik dhe pajisen me CAP pas plotësimit të orëve të detyrueshme.”.

6. Paragrafi i tretë i nenit 18 shfuqizohet.

7. Neni 26 shfuqizohet.

8. Neni 28 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Rinovimi i CAP-së realizohet vetëm pas përfundimit të trajnimit periodik. Autoshkollat përgatisin programet mësimore mbi temat sipas pikës 3 të shtojcës 1. Kur drejtuesi zotëron dy lloje CAP-sh, rinovimi mund të kryhet njëkohësisht.”.

9. Neni 32/1 shfuqizohet.

10. Shtojca I, zëvendësohet me shtojcën 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi



SHTOJCA 1

PROGRAMI I KUALIFIKIMIT FILLESTAR
DHE TRAJNIMIT PERIODIK

Qëllimi i programit

Qëllimi i programit të kualifikimit fillestar dhe të trajnimit periodik është:

- përgatitja profesionale e drejtuesve të mjeteve të kategorive C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E dhe DE;
- rritja e sigurisë së qarkullimit rrugor;
- zotërimi i njohurive teknike e profesionale për përdorimin e mjeteve;
- ulja e aksidenteve dhe rritja e efikasitetit në transport;
- garantimi i standardeve evropiane për marrjen dhe rinovimin e Certifikatës së Aftësisë Profesionale (CAP).

A. PROGRAMI I KUALIFIKIMIT FILLESTAR

Programi teorik që do të aplikohet nga autoshkollat për përgatitjen e kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me Certifikatën e Aftësisë Profesionale do të zhvillohet në 60 orë mësimi, të zhvilluara jo më pak se 15 ditë, respektivisht sipas temave të mëposhtme:

Tema 1 – Kuadri ligjor dhe detyrimet për CAP (4 orë)

Përmbajtja: Kuadri ligjor shqiptar; roli i DPSHTRR; kodi 95; detyrimet e drejtuesit.

Direktiva e BE për CAP-in.

Tema 2 – Njohuri nga Kodi Rrugor (8 orë)

Klasifikimi i mjeteve; normat e sjelljes; sinjalistika; transporti i mallrave e pasagjerëve.

Tema 3 – Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor (5 orë)

Formalitetet e qarkullimit; dokumentacioni; mjetet jashtë norme.

Tema 4 – Ligji për transportet rrugore (5 orë)

Llojet e transporteve; licencimi; detyrimet e operatorëve.

Tema 5 – Koha e punës dhe tahografi (2 orë)

Regjimet e orëve; pushimet; rregullorja 561/2006; tahografi digjital.

Përditësim për tahografin inteligjent Smart Tachograph V2.

Tema 6 – Njohuri teknike të mjeteve (10 orë)

Motorët, transmetimi, frenat, elektronika, diagnostikimi.

Sistemet ADAS (AEB, ESP, LKA, LDW).

Optimizimi i konsumit karburantit

Ngarkesa e mjetit dhe kujdesi

Rehatia dhe siguria e pasagjerit

Tema 7 – Rregullat që menaxhojnë transportin (4 orë)

Dokumentet e transportit; CMR; rregullat ndërkombëtare, pajisjet e sigurisë.

Tema 8 – Shëndeti, siguria dhe emergjencat (8 orë)

Rreziqet e qarkullimit; ndihma e parë; evakuimi i pasagjerëve.

Parandalimi i kriminalitetit dhe trafikimit të paligjshëm.

Menaxhimi i stresit dhe faktorët psikologjikë.

Rëndesa e aftësive fizike dhe mendore, të ushqyerit e balancuar, efektet e alkoolit dhe substancave.

Tema 9 – Njohuri tekniko-profesionale të avancuara për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjetit për të garantuar sigurinë në qarkullim dhe mbrojtjen e mjedisit (14 orë)

Motorët, shasia, frenat, sistemi elektrik, mirëmbajtja.

I. PROGRAMI PRAKTIK – KUALIFIKIM FILLESTAR

10 orë praktikë – të zhvilluara jo më pak se 5 ditë

Tema 1 – Ngarkimi dhe siguria e ngarkesës (5 orë)

Llogaritja e peshave, pajisjet e sigurimit, stabiliteti i mjetit.

Tema 2 – Manovrimi dhe drejtimi i mjetit (5 orë)

Manovra në poligon. Drejtim urban/interurban. Siguria e pasagjerëve (kategoritë D1/D).

Ngarkimi, shpërndarja e peshës, manovrat, kontrolli i mjeteve dhe siguria e pasagjerëve.

II. PROGRAMI I TRAJNIMIT PERIODIK (35 orë)

Shpërndarja: 7 ditë × 5 orë,

Tema 1 – Zhvillimet për sigurinë rrugore (7 orë)

ADAS; rreziqet moderne; strategjitë e shmangies së aksidenteve.

Tema 2 – Rregullat sociale dhe tahografi inteligjent (7 orë)

Orët e drejtimit/pushimit; Smart Tachograph V2; përgjegjësia ligjore.

Tema 3 – Drejtimi ekologjik i mjetit dhe ndikimi mjedisor (7 orë)

Kursimi i karburantit; drejtimi ekologjik; ulja e emetimeve.

Tema 4 – Siguria e ngarkesës/pasagjerëve (7 orë)



Sigurimi i ngarkesës; rreziqet; evakuimi i pasagjerëve.

Tema 5 – Shëndeti dhe sjellja profesionale (7 orë)

Stresi, lodhja, komunikimi profesional, imazhi i kompanisë.

VENDIM

Nr. 34, datë 17.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., përfaqësuar nga avokati Gerhard Velaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Shoqëria “A&B Group” sh.p.k., në mungesë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, në mungesë.

Dega Doganore Vlorë, në mungesë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, në mungesë.

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, në mungesë.

Shoqëria “Heineken Breweries B.V.”, në mungesë.

Bukurie Haxhiraj, përfaqësuar nga avokate Denaida Zanaj, me prokurë.

Administratori i falimentimit Rapo Xhaferaj, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5056, datë 18.12.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, pika 1, 16, pika 2, 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës

Faqe | 8112

Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 31 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.p.k. (*kërkuesja*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar Bukurie Haxhiraj, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, shoqërisë “A&B Group” sh.p.k. (*shoqëria debitore*), Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë (*DPDT*), Degës Doganore, Vlorë, Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë (*DTM*), shoqërisë “Heineken Breweries B.V.”, administratorit të falimentimit Rapo Xhaferaj (*administratori i falimentimit*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është kreditore e shoqërisë debitore me ish-administratore shtetasen Bukurie Haxhiraj, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, seksioni tregtar, me vendimin nr. 1758, datë 6.11.2014, ka vendosur hapjen e procedurës së falimentimit, për shkak të paaftësisë paguese dhe caktimin e administratorit të falimentimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

2. Në vijim të procedurës së falimentimit, në datën 23.3.2016 është zhvilluar mbledhja e raportimit me kreditorët sipas nenit 124 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar (ligji për falimentimin), në fuqi në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit, e cila ka vendosur mbylljen e aktivitetit të shoqërisë debitore dhe kalimin e saj në likuidim, me qëllim shlyerjen e kreditorëve.

3. Pas vendimmarrjes së mbledhjes së kreditorëve për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë debitore dhe kalimin e saj në likuidim, administratori i falimentimit dhe kreditorja, DPDT-ja, Dega Vlorë,



i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, seksioni tregtar, me kërkesë për vazhdimin e procedurave të falimentimit, me pretendimin se vendimmarrja e mbledhjes së kreditorëve e datës 23.3.2016 është në kundërshtim me interesat e përbashkëta të kreditorëve, si dhe kërkesja, në cilësinë e kreditorës së siguruar, nuk ka të drejtë vote për vendimmarrjen për riorganizim ose likuidim të shoqërisë debitoare në falimentim.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, seksioni tregtar, me vendimin e datës 29.9.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesave, me arsyetimin se ka qenë ajo gjykatë që ka caktuar mbledhjen e kreditorëve të shoqërisë debitoare në falimentim, në mënyrë që të diskutohej analiza ekonomiko- financiare e kësaj të fundit, përgatitur nga administratori i falimentimit, si dhe të diskutohej propozimi i tij për të mundësuar përgatitjen e një plani riorganizimi të shoqërisë, por, në përfundim të mbledhjes, plani i riorganizimit është refuzuar nga kreditorët. Sipas asaj gjykate, bazuar në nenin 63 të ligjit për falimentimin, vendimi i marrë nga kreditorët në mbledhjen e datës 23.3.2016 është i vlefshëm për sa kohë shuma e pretendimeve të kreditorëve në favor të vendimit është më e madhe sesa gjysma e shumës së përgjithshme të pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote. Në përfundim, edhe pse nga shoqëria debitoare u kërkuar që të vendosej riorganizimi i saj, bazuar në parashikimet e neneve 180 e vijuese të ligjit për falimentimin, në mungesë të vendimit të kreditorëve për përpunimin nga ana e administratorit të një plani dhe të paraqitjes së një plani riorganizimi nga debitori, pavarësisht kohës së dhënë nga gjykata (nga mbledhja e datës 9.6.2016 deri në mbledhjen e datës 29.9.2016), ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk mund të marrë në shqyrtim një pretendim të pabazë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kreditorja, DPD-T-ja, dhe administratori i falimentimit, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesave.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 185, datë 23.11.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e kërkesës së administratorit të falimentimit, prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016 dhe pranimin e kërkesës për paraqitjen e një plani riorganizimi të shoqërisë debitoare në falimentim, pasi vendimi i ankimuar është rrjedhojë e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të ligjit, si dhe mosvlerësimit të drejtë të provave të administruara.

Sipas gjykatës së apelit, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me dispozitat e ligjit për falimentimin, pasi e ka lejuar kërkesën të marrë pjesë në votimin për riorganizimin, ose likuidimin e shoqërisë debitoare në falimentim, ndërkohë që ajo, në cilësinë e kreditorës së siguruar nuk ka të drejtë vote, referuar nenit 64 të ligjit për falimentimin, për më tepër që pjesëmarrja e saj në votim është kundërshtuar nga administratori i falimentimit dhe kreditorët DPD-T-ja, Dega Vlorë e DTM-ja, Tiranë. Në të tilla kushte, në rast mosmarrëveshjeje të palëve për të drejtën e votës, ligji ka parashikuar se është gjykata e falimentimit ajo që vendos nëse ka të drejtë të votojë ose jo dhe, sipas gjykatës së apelit, nuk ka rezultuar që nga gjykata e zakonshme të jetë marrë vendim për lejimin e kësaj kreditorjeje për të marrë pjesë në votim. Për më tepër, sipas asaj gjykate, edhe nëse do të vlerësohej i vlefshëm votimi i datës 29.9.2016, shuma që pretendojnë kreditorët që kanë votuar pro është më e madhe sesa shuma që pretendon kreditorja e siguruar që votoi kundër, ndërkohë që në të dyja mbledhjet e kreditorëve është votuar në favor të riorganizimit të shoqërisë debitoare dhe jo për likuidimin e saj, pasi, referuar edhe analizave ekonomiko-financiare të shoqërisë debitoare të paraqitura nga administratori i falimentimit, është konfirmuar se shoqëria debitoare ka aktivitet fitimprurës dhe premisa të kënaqshme për vazhdimin e veprimtarisë dhe realizimin e fitimeve. Në përfundim, ajo gjykatë, ndërsa ka konkluduar për pavlefshmëri të vendimit të marrë nga kreditorët në mbledhjen e datës 23.3.2016 për likuidimin e shoqërisë debitoare, ka vlerësuar se duhet të thirret mbledhja e kreditorëve dhe administratori i falimentimit për paraqitjen e një plani riorganizimi, i cili duhet të shqyrtohet nga mbledhja e kreditorëve dhe nga gjykata. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkesja, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5056, datë 18.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkeses, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas njoftimit të subjektit të interesuar Bukurie Haxhiraj, drejtuar Gjykatës së Lartë, kjo e fundit u vu në dijeni se me vendimin nr.



443, datë 7.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë debitoare, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të riorganizimit.

7. Në datën 13.5.2025 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 10.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me largimin nga detyra të një gjyqtari, njëkohësisht edhe relator i çështjes, asaj i është caktuar një gjyqtar tjetër si relator.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtëm të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuara pretendimeve të kërkeses për zbatimin e gabuar të ligjit material, konkretisht dispozitave të ligjit për falimentimin në lidhje me të drejtën e votës të kreditorës së siguruar. Fakti i konstatuar nga Kolegji Civil se rekursi është bërë për shkak të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së, përbën një situatë të ndryshme nga përfundimi i nxjerrë nga Gjykata e Lartë, se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin material, situata të cilat nuk mund të qëndrojnë së bashku, pasi janë kontradiktore. Gjykata e Lartë ka konkluduar se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, ndonëse këto të fundit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta ndaj pretendimeve të kërkeses, duke lënë kështu të kuptohet se gjatë shqyrtimit të rekursit Gjykata e Lartë nuk i ka pasur të qarta vendimet e gjykatave më të ulëta. Kolegji Civil nuk është shprehur konkretisht për pranimin ose jo të pretendimeve të kërkeses, por është mjaftuar vetëm me shprehje standarde.

9. *Subjekti i interesuar, Bukurie Haxhiraj*, ka pretenduar se ushtrimi i kontrollit rishikues të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsistojë në rivlerësimin e provave, pasi bie ndesh me natyrën e gjykimit në atë gjykatë. Lidhur me pretendimin e

kërkeses për keqinterpretim të ligjit për falimentimin nga gjykata e apelit, në nenin 64, paragrafi 1, të tij, është parashikuar se “e drejta e votës përcaktohet në bazë të pretendimeve të paraqitura nga kreditori dhe që nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor me të drejtë vote” dhe, në rastin konkret, pretendimet e kërkeses janë kundërshtuar, duke i hequr në këtë mënyrë të drejtën e votës në vendimmarrjet e mbledhjes së kreditorëve. Gjithashtu, bazuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit për falimentimin, kreditorja e siguruar nuk lejohet të votojë edhe po t’ia japë këtë të drejtë gjykata. Kërkeses nuk i është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë, përkundrazi, ka abuzuar me të, pasi procedura e falimentimit tashmë ka përfunduar. Aktualisht, me vendimin nr. 443, datë 7.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë debitoare, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të riorganizimit, fakt me të cilën është njohur edhe Gjykata e Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I”, dhe 2,



të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se kërkesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor civil në përfundim të të cilit është vendosur mospranimi i rekursit të saj, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, e cila ka pranuar kërkesën e administratorit të falimentimit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016 dhe paraqitjen e një plani riorganizimi të shoqërisë debitore në falimentim. Për rrjedhojë, në aspektin procedural të këtij kriteri legjitimitimi, kërkesja rezulton të ketë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se çdo individ, person fizik ose juridik, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkesja duhet të provojë se është bartëse edhe e së drejtës kushtetuese që pretendohet se i është cenuar nga procesi gjyqësor, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi gjyqësor objekt kërkesë.

13. Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor i dhënë nga Gjykata e Lartë ka të bëjë me kundërshtimin gjyqësisht nga administratori i falimentimit dhe nga kreditorja, DPDT-ja, Dega Vlorë, të vendimmarrjes së mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016, që ka vendosur mbylljen e aktivitetit të shoqërisë debitore dhe kalimin e saj në likuidim, me qëllim shlyerjen e kreditorëve. Ata kanë pretenduar se vendimi i mbledhjes së kreditorëve bie në kundërshtim me interesat e përbashkët të kreditorëve dhe se kërkesja si kreditorë e siguruar nuk ka të drejtë vote për likuidimin ose riorganizimin e shoqërisë debitore në falimentim. Sipas gjykatës së shkallës së parë, që ka rrëzuar kërkesën për riorganizim të shoqërisë debitore, kërkesja, në cilësinë e kreditorës ka të drejtën e votës në të gjitha vendimmarrjet e mbledhjes së kreditorëve, për sa kohë pretendimet e paraqitura nga ajo nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor tjetër me të drejtë vote. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë

është ndryshuar nga gjykata e apelit e cila ka vendosur të pranojë kërkesën e administratorit të falimentimit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016 dhe paraqitjen e një plani riorganizimi të shoqërisë debitore në falimentim, duke vlerësuar se kërkesja, në cilësinë e kreditorës së siguruar nuk ka të drejtë vote, referuar nenit 64 të ligjit për falimentimin. Vendimi i gjykatës së apelit nuk është gjetur i cenueshëm nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkeses.

14. Duke pasur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, Gjykata do të ndalet në verifikimin e së drejtës kushtetuese që vihet në diskutim dhe, më tej, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur kërkeses në atë të drejtë, në kuptim të justifikimit prej saj të statusit të viktimës. Gjykata vëren, se pretendimet e kërkeses janë fokusuar në aspektet procedurale të procesit të përmbyllur me vendimin e kundërshtuar, pa arritur të evidentojë të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojë përmes ushtrimit të së drejtës kushtetuese me natyrë procedurale, asaj për proces të rregullt.

15. Megjithatë, duke pasur parasysh marrëdhënien mes shoqërisë debitore dhe kërkeses, edhe nëse do të konsiderohej se qëllimi i kërkeses është mbyllja e aktivitetit të shoqërisë debitore dhe likuidimi i saj, ky kërkim përfshihet në konceptin e pasurisë, pra mbrohet nga e drejta e pronës private. Gjithsesi, kërkesja nuk e ka argumentuar cenimin e kësaj të drejte për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar, sepse, në vetvete, efektet ligjore të vendimit të kundërshtuar nga kërkesja janë mosmbyllja e aktivitetit të shoqërisë debitore në falimentim dhe riorganizimi i saj, të cilat nuk kanë sjellë dhe as mund të sjellin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës së saj, për sa kohë ajo, në cilësinë e kreditorës së siguruar, si mjet sigurimi për pretendimet e saj ka të drejtë të realizojë shlyerjen e detyrimit nga kolaterali në përputhje me dispozitat e zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit (neni 35 i ligjit për falimentimin). Vendimi i mbledhjes së kreditorëve, i cili është shfuqizuar nga gjykatat, përbën një vendim të ndërmjetëm që nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare procedurës së falimentimit, ndaj duket se nuk ka cenuar ndonjë të drejtë themelore të kërkeses. Në këtë kuptim, mos pajtimi i kërkeses me arsyetimin e gjykatës së apelit nuk mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.



16. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se vlerësimi i këtij kriteri është i ndërlidhur edhe me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, në kuptim të të cilit Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm për vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve (*shih vendimet nr. 12, datë 18.3.2025; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Po kështu, në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se përjashtimisht disa lloj vendimesh gjyqësore mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse plotësohen disa kriterë që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste, kërkuesi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo shkelje dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë procesit gjyqësor në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri legjitimimi, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i përmbyllur nga Gjykata e Lartë, i kundërshtuar nga kërkuësja, nuk ka vendosur përfundimisht për themelin e çështjes. Edhe pse vendimmarrja e mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016, që ka vendosur mbylljen e aktivitetit të shoqërisë debitoare dhe kalimin e saj në likuidim, është bërë objekt ankimi dhe gjykatat më të larta kanë dhënë vendim për të, duke e shfuqizuar, nuk rezulton që kjo vendimmarrje të ketë cenuar të drejtën substanciale të pronës. E drejta e pronës mund të mbrohej përmes procesit gjyqësor të themelit, i cili ishte ende në vijim e sipër në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për shkak se procedura e falimentimit nuk ishte mbyllur ende. Ndërsa siç i është bërë me dije gjykatës nga subjekti i interesuar, aktualisht me vendimin nr. 443, datë 7.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë debitoare, për shkak të

mospërmbushjes së kushteve të riorganizimit, fakt me të cilin është njohur edhe Gjykata e Lartë. Ky fakt nxjerr në pah se e drejta e pronësisë së kërkuësës është duke u trajtuar në procedura gjyqësore që kanë aftësinë juridike ta përcaktojnë dhe ta zgjidhin përfundimisht atë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuësja nuk legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate me ankim kushtetues individual ndaj një vendimmarrjeje që mbante në zhvillim e sipër procedurën e falimentimit dhe nuk përbënte trajtim përfundimtar të të drejtave të kërkuësës.

19. Në përfundim, Gjykata çmon se, mbështetur në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar, për rrjedhojë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.3.2026.

Shpallur më 20.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Asim Vokshi

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuësës, shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a., me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5056, datë 18.12.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoj se kërkesa duhej të ishte pranuar pjesërisht. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe



nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj, në vijim, argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes, rezulton se vendimi gjyqësor i dhënë nga Gjykata e Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual, ka të bëjë me kundërshtimin gjyqësisht nga administratori i falimentimit dhe nga kreditorja, DPDT-ja, Dega Vlorë, të vendimarrjes së mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016, që ka vendosur mbylljen e aktivitetit të shoqërisë debitoare dhe kalimin e saj në likuidim, me qëllim shlyerjen e kreditorëve. Ata kanë pretenduar se vendimi i mbledhjes së kreditorëve bie në kundërshtim me interesat e përbashkët të kreditorëve dhe se kërkesja, si kreditorë e siguruar, nuk ka të drejtë vote për likuidimin ose riorganizimin e shoqërisë debitoare në falimentim. Sipas gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesën për riorganizimin e shoqërisë debitoare, kërkesja, në cilësinë e kreditorës, ka të drejtën e votës në të gjitha vendimarrjet e mbledhjes së kreditorëve, për sa kohë pretendimet e paraqitura prej saj nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor tjetër me të drejtë vote. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka vendosur të pranojë kërkesën e administratorit të falimentimit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve të datës 23.3.2016 dhe paraqitjen e një plani riorganizimi të shoqërisë debitoare në falimentim, duke vlerësuar se kërkesja, në cilësinë e kreditorës së siguruar, nuk ka të drejtë vote referuar nenit 64 të ligjit për falimentimin. Vendimi i gjykatës së apelit nuk është gjetur i cenueshëm nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkesës, ndonëse ka marrë dijeni se me vendimin nr. 443, datë 7.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë debitoare, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të riorganizimit.

3. Në këto kushte, kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur, ndër të tjera, disa pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

4. Konkretisht, sipas shumicës, duke pasur parasysh marrëdhënien mes shoqërisë debitoare dhe kërkeses, edhe nëse do të konsiderohej se qëllimi i kërkeses është mbyllja e aktivitetit të shoqërisë debitoare dhe likuidimi i saj, ky kërkim përfshihet në konceptin e pasurisë, pra mbrohet nga e drejta e pronës private. Gjithsesi, sipas shumicës, kërkesja nuk e ka argumentuar cenimin e kësaj të drejte për shkak të vendimarrjes së kundërshtuar, sepse në vetvete efektet ligjore të vendimit të kundërshtuar janë mosmbyllja e aktivitetit të shoqërisë debitoare në falimentim dhe riorganizimi i saj, të cilat nuk kanë sjellë dhe as mund të sillnin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës së kërkeses, për sa kohë, ajo, në cilësinë e kreditorës së siguruar, si mjet sigurimi për pretendimet e saj, ka të drejtë të realizojë shlyerjen e detyrimit nga kolaterali në përputhje me dispozitat e zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit (*shih paragrafin 15 të vendimit*).

5. Po kështu, sipas shumicës, vendimi i mbledhjes së kreditorëve, i cili është shfuqizuar nga gjykata, përbën një vendim të ndërmjetëm që nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare procedurës së falimentimit, ndaj duket se nuk ka cenuar ndonjë të drejtë themelore të kërkeses, dhe se mospajtimi me arsyetimin e gjykatës së apelit nuk mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues (*shih paragrafin 15 të vendimit*).

6. Duke e parë të ndërlidhur këtë kriter me atë të shterimit të mjeteve juridike efektive, shumica ka konstatuar se procesi gjyqësor i përmbyllur nga Gjykata e Lartë, i kundërshtuar nga kërkesja, nuk ka vendosur përfundimisht për themelin e çështjes, pasi nuk rezulton që kjo vendimarrje të ketë cenuar të drejtën substanciale të pronës. Sipas shumicës, e drejta e pronës mund të mbrohet përmes procesit gjyqësor të themelit, i cili ishte ende në vijim e sipër në gjykata të juridiksionit të zakonshëm, për shkak se procedura e falimentimit nuk ishte mbyllur ende. Fakti se me një vendim të gjykatës së shkallës së parë është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë debitoare, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të riorganizimit, nxjerr në pah se e drejta e pronësisë së kërkeses është duke u trajtuar në procedura gjyqësore që kanë aftësinë juridike ta përcaktojnë dhe ta zgjidhin përfundimisht atë. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se kërkesja nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate me ankim kushtetues individual për një vendimarrje që mbante në



zhvillim e sipër procedurën e falimentimit dhe nuk përbënte trajtim përfundimtar të të drejtave të kërkuases (shih paragrafin 18 të vendimit).

7. Unë, gjyqtarja në pakicë, në këtë vendimarrje, nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës dhe nuk ndaj të njëjtën qasje për rrëzimin e kërkesës, konkretisht me argumentet e shumicës për moslegjitimitimin *ratione personae* të kërkuases, pasi edhe vetë gjykatat, përfshirë Gjykatën e Lartë, nuk kanë evidentuar se kërkuessa nuk legjitimohej në këtë proces. Për këtë shkak, edhe kjo Gjykatë, si gjykatë e të drejtave themelore, duhet ta kishte analizuar në themel kërkesën e jo të mbyllte vlerësimin në një nga kriteret paraprake që është ai i legjitimitimit *ratione personae*. Për më tepër, për themelin e çështjes, edhe pse falimentimi i një shoqërie tregtare nënkupton dy faza, atë të likuidimit e më pas atë të deklarimit të falimentit, për efekt të gjyqimit kushtetues, këto dy procedura nuk mund të konsiderohen të ndara, njëra paraprake (likuidimi) dhe tjetra përfundimtare (falimentimi). Kjo për vetë faktin se Kushtetuta kur përcakton juridiksionin e Gjykatës në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, konsideron përfundimtare ato vendime që kanë vendosur për një çështje të caktuar deri në gjykimin në Gjykatën e Lartë, element i cili përmbushej në rastin konkret. Për këtë argument dëshiroj të evidentoj se vendimi i mbledhjes së kreditorëve në rastin konkret nuk mund të konsiderohet një vendim i ndërmjetëm, në kushtet kur ai ka disponuar për themelin e çështjes, pra për likuidimin e shoqërisë debitoare dhe ndërhyr në të drejtat kushtetuese individuale, si e drejta e pronës, ndaj, për qëllime të kontrollit kushtetues, ai duhej të konsiderohej me natyrë përfundimtare.

8. Nisur nga sa më lart, konstatoj se në rekursin e saj kërkuessa ka ngritur pretendime për sa i përket zbatimit të gabuar nga gjykata e apelit të ligjit për falimentimin lidhur me të drejtën e votës së kreditorit të siguruar në vendimarrjen e mbledhjes së kreditorëve në rastin kur shoqëria debitoare në falimentim duhet të riorganizohet ose të likuidohet, pretendime, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit, ashtu sikundër edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve të kërkuases, që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për falimentimin për të drejtën e votës së kreditorit të siguruar në rastin kur

shoqëria debitoare në falimentim duhet të riorganizohet ose të likuidohet, për më tepër kur ajo është ndodhur përpara dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar të drejtë pjesëmarrjen e kërkuases në të gjitha vendimarrjet e mbledhjes së kreditorëve, për sa kohë pretendimet e paraqitura prej saj nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor tjetër me të drejtë vote, ndërkohë që gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkuessa, në cilësinë e kreditores së siguruar, nuk ka të drejtë vote referuar nenit 64 të ligjit për falimentimin.

9. Edhe pse fakti i pasjes së dy vendimeve diametralisht të kundërta, në vlerësimin tim, nuk sjell apriori cenim të së drejtës për proces të rregullt, mënyra sesi kanë vepruar gjykatat, në rastin konkret, ka sjellë një mënyrë të ndryshme analize dhe vlerësimi ligjor të çështjes nga ana e tyre, çka impononte për Gjykatën e Lartë ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit, për të verifikuar pikërisht mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka disponuar sipas nenit 480 (shkronja “a”) të KPC-së, që përcakton se mospranimi i rekursit bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, por pa treguar se përse shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuases nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit, duke qenë kështu haptazi të pabazuara, ndërkohë që Gjykata e Lartë kishte marrë dijeni për vendimin e datës 7.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me anë të të cilit ishte vendosur fillimi i procedurave të likuidimit të shoqërisë “A&B Group” sh.p.k., për shkak të mospërmbushjes të kushteve të riorganizimit. Po kështu, Gjykata e Lartë në mënyrë formaliste, me arsyetim de plano, pa asnjë analizë, ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, megjithëse ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket zbatimit të ligjit në rastin konkret, duke i mohuar në këtë mënyrë kërkuases të drejtën kushtetuese të aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

10. Në këtë kuptim, nuk rezulton që kërkuessa të ketë marrë përgjigje për pretendimet e saj, pavarësisht se në përputhje me jurisprudencën kushtetuese asaj i lindte e drejta për të pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt



gjykimi, në mënyrë që aksesit në gjykatë të ishte substantiv dhe jo thjesht formal. Po kështu, në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, vlerësoj se vetëm një vendim i arsyetuar i jep mundësinë Gjykatës të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të kërkuësës dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime.

11. Për sa më lart, vlerësoj se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, siç është e drejta e aksesit lidhur me standardin e arsyetimit kur kemi të bëjmë me të drejtën e pronës, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuësve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin de plano se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e aksesit të kërkuësës në drejtim të së drejtës për ankim efektiv në një gjykatë më të lartë. Për pasojë, kemi cenim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

12. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, vlerësoj se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar, prandaj duhej të ishte vendosur pranimi i pjesshëm i kërkesës dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Anëtare: Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 86, datë 27.3.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË “RREGULLOREN E LIDHJEVE TË REJA NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 176, DATË 14.11.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, 16 dhe 17, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 144, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 27, datë 1.3.2013, “Për miratimin e përjashtimit me kushte të TAP AG nga zbatimi i neneve 9, 32 dhe 41, paragrafët 6, 8 dhe 10, të Direktivës 2009/73/KE për projektin Trans Adriatic Pipeline”, i ndryshuar; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 64, datë 13.6.2013, “Për miratimin e Opinionit të Përbashkët të Rregullatorëve mbi aplikimin e TAP AG për përjashtim (*Final Joint Opinion*)”; të vendimit të Komisionit Evropian C(2013) 2949 final, datë 16.5.2013; të “Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror me nr. 403/1 prot., datë 24.3.2026, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘Trans Adriatic Pipeline AG’ (TAP AG) për ndryshimin e ‘Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror’, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Trans Adriatic Pipeline AG” (TAP AG), me shkresën nr. 403 prot., datë 28.1.2026, ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e “Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 176, datë 14.11.2019, me qëllim përfshirjen në këtë akt të një dispozite të posaçme që përjashton TAP AG nga fusha e zbatimit të saj.



- TAP AG operon mbi bazën e një kuadri të posaçëm rregullator, të konsoliduar përmes vendimit të Komisionit Evropian C(2013) 2949 final, datë 16.5.2013, si dhe Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Autoriteteve Rregullatore të Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë, të datës 6 qershor 2013, që parashikon përjashtimin nga disa detyrime të Paketës së Tretë të Energjisë.

- Me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013, ERE ka miratuar përjashtimin me kushte të TAP AG nga zbatimi i kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41, të Direktivës 2009/73/KE, ndërsa me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, është miratuar Opinionin i Përbashkët i Rregullatorëve mbi këtë përjashtim.

- TAP AG është certifikuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit me vendimin nr. 36, datë 31.3.2016 dhe është licencuar në veprimtarinë e Transmetimit të Gazit Natyror me vendimin nr. 15, datë 31.1.2019.

- Regjimi i lidhjes në infrastrukturën e TAP AG nuk ndjek procedurat dhe mekanizmat e parashikuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sektorin e gazit natyror”, pasi lidhjet në këtë infrastrukturë realizohen përmes mekanizmave specifike të “Market Test”, të bazuar në kërkesën e tregut dhe në angazhimin e palëve të treta për mbulimin e kostove.

- Rregullorja në fuqi është hartuar për operatorët e rrjeteve kombëtare të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe nuk reflekton natyrën specifike të operimit të TAP AG, të cilit më herët i është miratuar kërkesa për përjashtimin sipas disa kushteve nga zbatimi i kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41, të Direktivës 2009/73/KE.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019, për miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”, është paraprirë nga procesi i konsultimit me palët e treta, shqyrtimin e argumenteve dhe arsyetimin e vendimmarrjes. Ndër të tjera, në këtë vendim në pjesën konstatime evidentohet korrespondenca e datës 27.10.2019, ku citohet se TAP-i nuk kërkohet të sigurojë lidhje direkte për përdoruesit fundorë, TAP-i lidhet vetëm me OST-të kombëtare. TAP-i nuk kërkohet të sigurojë lidhje direkte për përdoruesit fundorë, TAP-i lidhet vetëm me OST-të kombëtare. Kjo vijon si nga ligji parësor i BE-së, ashtu edhe nga korniza specifike ligjore e TAP-it, e zhvilluar në përputhje me përjashtimin e dhënë TAP-it në vitin 2016.

- Sa i përket kërkesës së TAP AG për heqjen e referencës ndaj korrespondencës së datës 27.10.2019 nga pjesa konstatuese e vendimit nr. 176/2019, kjo kërkesë vlerësohet të mos pranohet, pasi pjesa arsyetuese e aktit administrativ përbën element thelbësor të ligjshmërisë procedurale ku pasqyrimi i komenteve të palëve garanton transparencën dhe dokumenton procesin vendimmarrës, ndërsa heqja e kësaj reference do të cenonte gjurmën dokumentare të procedurës, për më tepër që qëndrimi i TAP AG rezulton i marrë në konsideratë në vendimin nr. 176/2019.

- Me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013, ERE ka miratuar përjashtimin me kushte të TAP AG nga zbatimi i kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41, të Direktivës 2009/73/KE, ndërsa me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, është miratuar Opinionin i Përbashkët i Rregullatorëve mbi këtë përjashtim.

- Në kuadër të rishikimit të këtij vendimi konstatohet referimi i përjashtimit të dhënë TAP AG në vitin 2016. Nga analiza e vendimmarrjeve, në lidhje me operimin e TAP AG, rezulton se ky përjashtim është i lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013, vendimin e Komisionit Evropian C(2013) 2949 final, datë 16.5.2013, si dhe Opinionin e Përbashkët Përfundimtar të Autoriteteve Rregullatore të Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë, të datës 6 qershor 2013. Si të tillë lind e nevojshme të bëhet korrigjimi i vitit referues në këtë paragraf të vendimit, përkatësisht viti 2016, korrigjohet me vitin 2013.

- Në përputhje me nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, me një akt të ri me shkrim, vlerësohet që, në nenin 1, të rregullores nr. 176, datë 14.11.2019, të shtohet një dispozitë e posaçme që përjashton TAP AG nga fusha e zbatimit të saj, me përmbajtje si vijon: “Përjashtimisht kjo rregullore nuk është objekt zbatimi nga TAP AG për gjatë të gjithë kohës së zbatimit të vendimit nr. 27, datë 1.3.2013, ‘Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline’” dhe vendimit nr. 64, datë 13.6.2013, “Për miratimin e dokumentit ‘Opinion Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve



të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përrjashtim”.

- Ky ndryshim vjen si pasojë e regjimit të posaçëm rregullator që i është njohur shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG” (TAP AG), në bazë të përjashtimit të dhënë nga detyrimet e parashikuara për aksesin e palëve të treta në infrastrukturë (*third party access*), sipas nenit 36 të Direktivës 2009/73/EC. Për rrjedhojë, TAP AG operon jashtë kuadrit standard të aksesit të hapur dhe jodiskriminues në rrjet, çka justifikon përjashtimin e saj nga fusha e zbatimit të “Rregullores për lidhjet e reja në sektorin e gazit natyror” sikurse dhe pranuar në vendimin nr. 176/2019.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në “Rregulloren për lidhjet e reja në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 14.11.2019, në nenin 1, shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon: “Përjashtimisht kjo rregullore nuk është objekt zbatimi nga TAP AG për gjatë të gjithë kohës së zbatimit të vendimit nr. 27, datë 1.3.2013, Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10), të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline” dhe vendimit nr. 64, datë 13.6.2013, “Për miratimin e dokumentit ‘Opinion Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përrjashtim”.

2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror të njoftojnë shoqërinë TAP AG dhe palët e interesit për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi me botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 87, datë 27.3.2026

MBI MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË SË PROPOZUAR NGA OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES “OSSH” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikave 1.2 dhe 2, të “Programit të Pajtuëshmërisë së ‘OSSH’ sh.a.”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 257, datë 21.12.2020; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 343, datë 21.12.2022, “Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ‘OSSH’ sh.a.”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 741/1 prot., datë 18.3.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi riemërimin e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ‘OSSH’ sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, vendosi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a.

- Me vendimin nr. 114, datë 27.3.2023, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë emërimin e z. Ervis Hazizi si Zyrtar i Pajtuëshmërisë i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., për një mandat 3-vjeçar (trevjeçar) me afat vlefshmërie deri më 27.3.2026.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 741, datë 26.2.2026, shoqëria “OSSH” sh.a. ka depozituar kërkesën për riemërimin e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë z. Ervis Hazizi.

- Në shtojcën 1, të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a., të miratuar me vendimin nr. 343/2022, janë



listuar kriteret përzgjedhëse që duhet të përmbushë Zyrtari i Pajtueshmërisë.

- Në zbatim të kriterëve të sipërcituara, shoqëria “OSSH” sh.a. ka depozituar vendimin nr. 5, datë 20.2.2026, të Këshillit Mbikëqyrës, *Curriculum Vitae* të z. Hazizi, vetëdeklarimin për pavarësi dhe mungesë konflikti interesi, si dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

- Këto kriterë konsiderohen të ezauruara për sa kohë kandidati është miratuar më parë nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 114, datë 27.3.2023, për emërimin në këtë detyrë, çka nënkupton se ERE është shprehur tashmë mbi përmbushjen e tyre.

- Gjatë kësaj kohe, Zyrtari i Pajtueshmërisë ka raportuar rregullisht mbi zbatimin e përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., duke kryer kështu funksionet e tij.

- Në germën “D” të kontratës së miratuar me vendimin nr. 343/2022, të Bordit të ERE-s është parashikuar që të vendoset dhe vendimi i Bordit të ERE-s me të cilin miratohet Zyrtari dhe se efektet e kësaj kontrate fillojnë me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s për miratimin e Zyrtarit.

- Në pikat 1.2 dhe 2, të Programit të Pajtueshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020, parashikohet se “OSSH” sh.a. përcakton Zyrtarin e Pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.

- Në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, miratuar me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, të Bordit të ERE-s, parashikohet se kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare). Në kushtet kur mandati aktual përfundon më datë 27.3.2026 dhe për të garantuar vijimësinë e ushtrimit të funksionit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë pa ndërprerje, vlerësohet që efektet juridike të kontratës së re të fillojnë në datën e përfundimit të kontratës aktuale në fuqi.

- Referuar praktikës rregullatore të ERE-s dhe detyrimit për dokumentimin e marrëdhënieve kontraktore që lidhen me ushtrimin e funksioneve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, vlerësohet e nevojshme që shoqëria “OSSH” sh.a. të depozitojë në ERE një kopje të kontratës së nënshkruar nga palët, brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi të vendimit, me qëllim ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe

garantimin e zbatimit të saj në përputhje me kuadrin rregullator.

- Në lidhje me sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet për miratimin e riemërimit të z. Ervis Hazizi si Zyrtar i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a., në përputhje me kontratën e miratuar dhe Programin e Pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë riemërimin në detyrë të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a., z. Ervis Hazizi, për një mandat 3-vjeçare (trevjeçar), ofrimi i shërbimeve të të cilit do të rregullohet me kontratën e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022.

2. Efektet juridike të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë fillojnë në datën e përfundimit të kontratës aktuale në fuqi.

3. Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. të depozitojë në ERE një kopje të kontratës së nënshkruar nga palët, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe z. Hazizi për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 98, datë 9.4.2026****MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN MARS 2026, PËR KLIENËTË E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1043/1 prot., datë 7.4.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

- Shoqëria “FSHU” sh.a. me shkresën nr. 2457 prot., datë 1.4.2026, protokolluar në ERE me nr. 1043 prot., datë 1.4.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin mars 2026, shoqëria “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Referuar të dhënave të paraqitura, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përlogaritur nga shoqëria për muajin mars 2026 është 10.23 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 10.23 lekë/kwh, sikurse pasqyruar edhe në përlogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin mars 2026: 10.23 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”: 1.55 lekë/kwh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive të harkut kohor 27.2.2026–30.3.2026.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026, përlogaritet si më poshtë:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2026

		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.23
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.31
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	14.00

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 14.00 lekë/kwh për muajin mars 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026 prej 14.00 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 99, datë 9.4.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY
PESHK” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 990/1 prot., datë 8.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Koka & Ergi Energy Peshk’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të



aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germën “a”, dhe pikën 2.5.

- Në këtë aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “a”: Shoqëria duhet të përfshijë në objektin e veprimtarisë së saj dhe tregtimin e energjisë elektrike dhe të depozitojë ekstraktin historik të regjistrit tregtar të përditësuar.

- germa “b”: duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për një nga administratorët e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të saj për dedikimin e shumës të nevojshme për të mbuluar të paktën e një 1 muaji të aktivitetit të tregtimit;

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 100, datë 9.4.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 mW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 709/6 prot., datë 8.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mW”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mW.

- Në vijim të këtij licencimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikimin e aneksit A të kësaj licence, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra



ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 10 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 76, datë 12.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.3.2026 dhe 14.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 709/3 prot., datë 18.3.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 709/4 prot., datë 18.3.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 709/5 prot., datë 24.3.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 101, datë 9.4.2026

MBI HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 138, DATË 14.4.2023

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 611/1 prot., datë 8.4.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë



së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, “Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 31, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

- Ky vendim u mor për shkak se shoqëria nuk kishte shlyer në afat pagesën rregullatore të vitit 2025 ndaj ERE-s, duke rezultuar debitore për këtë pagesë, si dhe nuk ka përcjellë në ERE sqarime/dokumentacion mbi mosshlyerjen e detyrimit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 611 prot., datë 16.2.2026. Në të njëjtën ditë, një kopje e skanuar e kësaj shkrese i është dërguar shoqërisë dhe me postë elektronike. Këto njoftime konsiderohen të marra nga shoqëria, për sa kohë nuk rezulton kthimi i tyre. Po ashtu, janë kryer disa tentativa kontakti në numrin e telefonit të disponuar nga ERE, por nuk është marrë asnjë përgjigje nga ana e shoqërisë.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 7, germa “b”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të licencuarit kanë të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 31, datë 4.2.2026, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 42, datë 23.2.2025, ndaj dhe llogaritja e afatit 30-ditor vlerësohet të fillojë nga kjo datë.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenin 5, germa “ç”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në pikën 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.”.

- Duke qenë se, në përfundim të afatit 30-ditor (23.3.2026), duke e përllogaritur këtë afat nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, ka rezultuar se

shoqëria nuk ka shlyer pagesën e rregullimit e po ashtu nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës së saj, vlerësohet të vijohet me heqjen e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer debinë përkatëse për vitin 2025, si dhe pagesën rregullatore të vitit 2026 (miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 26.2.2026), detyrim ky që i ka lindur shoqërisë ndërkohë që ishte e licencuar nga ERE. Vjelja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 555, seria T23, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca nr. 555, seria T23, bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k., “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 102, datë 9.4.2026****MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “RENRGY TRADING
GROUP” SHPK PËR KRIJIMIN E
LLOGARISË NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK TË GARANCIVE
TË ORIGINËS**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 774/2 prot., datë 8.4.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k,

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.7.2018, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19/2023, si dhe është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190/2023.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në mbështetje të nenit 5 të rregullores, ku përcaktohet se çdo person fizik ose juridik apo subjekt ka të drejtën të aplikojë për t’u regjistruar në regjistrin e garancive të origjinës të ERE-s, shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. me anë të email-it, protokolluar me nr. 774 prot., datë 2.3.2026, ka

paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës. Sipas kërkesave të nenit 6, pika 4.1, të rregullores, shoqëria ka përcjellë të plotësuar, duke specifikuar të dhënat identifikuese.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjister elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjister si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, për tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., lidhur me vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM
Nr. 12, datë 22.4.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”, në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”;

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga Agjencia Ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e lëvrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 190 lek/litri për gazoilin;
- 164 lek/litri për benzinën;

b) Çmimet tavan (max) për shitjen me pakicë të produkteve:

- 202 lek/litri për gazoilin;
- 176 lek/litri për benzinën;

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lek/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lek/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM: 27101944 me 39.376230 lek/litri, dhe për produktin benzinë sipas kodeve të NKM: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lek/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 22.4.2026, ora 12:30, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Sezar Beqaj, Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Dritan Basha, Ilir Binaj, Besmir Beja, Klaudio Gega, Arlind Fida, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Nimet Veliaj

**KËRKESË**

Shtetasi Frano Matosha kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, shpalljen e zhdukjes së shtetasit Ernest Vlash Matosha, i datëlindjes 13.3.1967, si dhe caktimin e kërkuesit si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUES
Frano Matosha

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë

